



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# MREKULLITË E KUR'ANIT

## LIBRI I PARË

Muhamed Mutevelli esh-Sharavi

Botuar nga: Zëri Ynë

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit dhe përkthyesit Muhamed Jusufi

HYRJA E EDITORIT .....	8
HYRJA E PËRKTHYESIT .....	11
Ç'ËSHTË MREKULLIA .....	12
IBRAHIMI NUK U DOGJ .....	15
MAGJISTARËT U PËRULËN – PSE? .....	17
MUNDËSIA E ALL-LLAHUT .....	20
KUR SHKAQET PENGOHEN .....	22
MREKULLI, POR, E PAKUSHTËZUAR .....	25
KUR'ANI .....	27
MREKULLI E VAZHDOESHME .....	27
SI MUND TË NDRYSHON .....	30
MREKULLIA E KUR'ANIT .....	30
ZOTI I LINDJES DHE PERENDIMIT .....	32
SA E RUAJMË KUR'ANIN DHE .....	35
SA E PRAKTIKOJMË ATË .....	35
KUR'ANI PËRCAKTOI .....	39
PREJARDHJEN E DITURISË NJERZORE .....	39
KUR'ANI PROGRAM JETE .....	41
MREKULLITË GRAMATIKORE TË KUR'ANIT .....	43

I THANË .....	47
MAGJISTARË DHE SHPIFËS.....	47
Ç'KUPTIM KANË SHKRONJAT .....	53
NË KUR'AN .....	53
MJESHTRIA E KRIJUESIT .....	54
RETORIKA .....	57
NË KUR'ANI KERIM .....	57
NDRYSHIMI I DURIMIT .....	59
(SABRIT).....	59
PËRSHKRIMI .....	61
I VETË QENIES NJERËZORE .....	61
AI MË USHQEN.....	63
DHE MË JEP PËR TË PIRË .....	63
PSE NDODHIN NDRYSHIMET .....	66
E DINË E KUPTOJNË.....	67
JU FURNIZOJMË.....	70
DHE I FURNIZOJMË.....	70
TI JE I PLOTFUQISHËM.....	73
DËMTUES I VETES.....	75

DHE KEQBËRËS .....	75
DRITA DHE TERRI .....	77
THËNJET SE KUR'ANI .....	79
KA KUNDËRTHËNIE .....	79
KRIJIMI I QIEJVE DHE TOKËS.....	80
HOLLËSITË E KRIJIMIT.....	84
DASHURIA DHE MIRËSIA.....	85
VEÇOHET NËNA – PSE.....	88
ERDHI URDHËRI I ALL-LLAHUT .....	90
DHE MOS NXITONI .....	90
A E PA MUHAMEDI A.S.....	92
KUSH JANË GËNJESHTARË.....	95
PYETJA E CILA NUK .....	97
ËSHTË PËR T'U DITUR .....	97
KUR'ANI.....	102
DHE LIGJET E NATYRËS.....	102
KUR'ANI DHE.....	104
TEORITË SHKENCORE.....	104
PSE U LA PA SHPJEGIM .....	106

TOKËN . . . E SHTRUAM .....	108
PARAPRINË NATA APO DITA.....	109
RROTULLIMI I TOKËS .....	111
DHE KODRAT .....	111
PSE DUHET TË FLASIM.....	114
PËR EMBRIONIN .....	114
NË VETET TUAJA .....	115
NDIESHMËRIA DHE LËKURA.....	118
FOSHINJA E EPRUVETËS .....	120
KUR'ANI.....	124
SHPALUES I SEKRETEVE.....	124
BETOHEN RREJSHËM .....	128
ZHVESHJA E NJË TË ARDHMEJE .....	131
SFIDOI ARMIQTË E ALL-LLAHUT.....	134
SFIDOI JO ARABËT.....	135
KUR'ANI TREGON .....	138
PËR TË HUMBURIT.....	138
KUR CENOJMË PA ARGUMENTE .....	143
FEMOHUESIT .....	144

VËRTETOJNË KUR'ANIN .....	144
KRIJIMI I NJERIUT .....	146
NJERIU NË BARK.....	149
TË NËNËS.....	149
MREKULLIA - VAZHDON .....	151
SUBHANE ALL-LLAH .....	156
UNË KAM FUQI POR.....	158
EDHE AI KA FUQI .....	158
MUNDËSIA DHE DITURIA .....	160
MBI SHQISAT E NDËGJIMIT.....	163
DHE TË PAMURIT.....	163
MBI MUNDËSINË .....	164
E TË PAMURIT .....	164
DITURIA NJERËZORE.....	166
ÇKA NA OFROI SHKENCA.....	167
AJRI .....	168
UJI.....	169
USHQIMI .....	169

## HYRJA E EDITORIT

Lavdi, i qoftë All-llahut i Cili i shpalli robit të Tij (*keitë*) Libër dhe në të nuk la asnjë shtrembërim. Ai e bëri udhërrëfyes që t'ju japë vërejtje njerëzve rreth ndëshkimit të rëndë të ardhur prej Tij, dhe t'u japë sihariq besimtarëve, të cilët bëjnë vepra të mira, se për ta do të ketë shpërblim të mirë.

Falja dhe *përsbëndetja* të jetë mbi lajmëtarin e sihariqit dhe këshilltarin tonë, Zotëriun e thirrjeve dhe imamin e pejgamberëve.

Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut të vetëm, Sundimi dhe Lavdia i takojnë vetëm Atij, para duarve të Tij është mirësia dhe Ai është i Gjithmundshëm.

Dëshmoj dhe deklaroj se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij besnik dhe premtues i drejtë, i cili informoi për atë që iu është zbuluar dhe i cili e plotësoi premtimin, këshilloi njerëzimin dhe sakrifikoi çdo gjë për hirë të kësaj rrugeje të fesë derisa i erdhi bindja.

I nderuari vëlla musliman!

Libri që keni para jush është bazuar në shkencë, në frymën e Zotit dhe në rregullat e fesë. Mendjet stagnojnë ngase para vetes së tyre kanë argumentet e All-llahut. Këto argumente dalin nga Kur'ani i cili është libër që përmban mrekullitë e Zotit, sfidoi renegatët e kësaj feje duke ju përgjigjur atyre rrjedhshëm duke ja prezentuar shenjtërinë dhe madhësitë e Tij dhe,

Ky libër mund të llogaritet edhe si ndriçues i imanit për këtë kohë. I nderuari dhe shumë i respektuari dijetar dhe mendimtar i thirjes islamike, Hoxhë dhe imam Muhammed Mutevel-li el Sharavi! Me ju u zbardh historia jonë edhe më tepër. Ju jeni një reformator ndër muslimanët që spjeguat me mjeshtëri të rallë çështjen e imanit dhe mënyrën e të besuarit si dhe u përballët me sulmet e armikut të fesë duke qëndruar i pa lëkundur. Kontributet, sinqeriteti juaj, njohuritë tuaja, i ndihmuan muslimanët dhe i ndihmuan thirjes islamike, kundër sulmuesve, supozimeve të ndryshme, trillimeve të orientalistëve dhe perëndimorëve.

Mbase është libri i parë më voluminoz i këtij lloji i cili përfshiu problemet e kohës dhe e dha shkëlqimin e vet shikuar nga këndi islam. Prizmi nga i cili ai vështron, mbështetet në Kur'an dhe sunnete të pejgamberit. El Sharaviu, që nga agimi arriti ta mbushë zemrën e tij me urtësi dhe më pas t'i rrezatojë gjoksi rrymë inspirimi, që çdo problemi t'ia jep hakun e vet të duhur. Dhënia e hakut mbështetet në njohuritë e tij, derisa ai shpalosi dhe zbuloi sekretet e saj duke argumentuar ato. Largoji njollosjet nga realja dhe i mbështolli ato me ndriqes, këto nuk mund të mbështilleshin nga njerëz frikacak dhe dualistë.

Edhe pse ishin probleme të llojllojshme, libri megjithatë, përfshiu tema që kishin qëllime të shumta, të cilat ai arriti t'i përkufizojë ato duke mos u zgjëruar dhe larguar. Kjo pa dyshim është meritë e Imam el Sharaviut me dhuntitë dhe rrezatimet ideore të tij që dalin nga kultura e një dijetari të madh. Ai paraqitej herë në mjeksi, si p.sh. foshjen e epruvetës, ndjenjat, lëkurën, jetën e fetusit në mitër të nënës, dhe herë në gjeografi, si p.sh. forma e tokës, rrotullimi i saj, pastaj malet, ndryshimi i natës me ditën, vërshimet dhe tërmetet etj. Krahas kësaj, ai paraqiti edhe disa çështje të imanit, si vdekjen, ringjalljen, melaiKET dhe sekretet, si dhe realitetet shkencore të cilat ishin sinjalizuar në Kur'anin Kerim.

Saherë që lexohet ky libër, të jep shpresë për pastrimin e mendjes dhe e shikon ekzistencën me një realizëm të plotë. Mësojmë se ç'ka pas botës së pafund si dhe për të pa dukshmen. Zbulon kuptimet të cilat ishin të pa zbuluara për ne, ose vetë ishim të mbyllur para tyre. All-llahu me urtësinë e Tij ndau riskun (furnizimin) nga ezeli (përjetshmëria). El Sharaviu mori flamurin e këtij risku të urtësisë, inspirimit dhe mençurisë të thellë, si dhe mundësinë për zbatimin e tij deri në zemrat dhe mendjet e njerëzve. E gjithë kjo ishte nga mirësitë e All-llahut i cili ia jep kujt të dojë.

Unë jam munduar që këij libri t'ia jap të gjitha meritat që i takojnë. Shembulli im është si shembulli i atij që mundohet të kalojë oqeanin me duar të mbyllura e të prangosura dhe t'ua largojë etjen të tjerëve, duke qenë ai vetë pa dyshim korrektues i mirëfillt fetar prej të cilit përfitojnë specialistët dhe profesionalistët, dijetarët dhe jo dijetarët.

Ky libër të cilin e keni në dorë, është i pari nga seria e librave të cilat do të dalin me emrin e All-llahut nga shtypi. Librat do të jenë me të njejtën përmbajtje përderisa kemi të bëjmë me Kur'ani Kerimin, i përfshirë me mendime, të cilat do të ndriten nga el Sharaviu, njëlloj si në këtë libër të mrekullueshëm.

E lus All-llahun për ndihmë dhe lehtësimin e rrugës për t'i nxjerrë edhe pjesët tjera të cilat janë të të njejtës natyrë, duke kërkuar nga All-llahu i Lartësuar për falje të gabimeve dhe të na përfshijë të gjithë ne nën hijen e Rahmetit të Tij dhe të na bëjë prej shërbëtorëve të Librit të Tij.

Kairo, Ramazan 1408 (Maj 1988)

Abdullah Haxhaxh

## HYRJA E PËRKTHYESIT

Kisha marrë detyrën e Imamit në xhaminë e Brukselit. Pas stabilizimit të plotë fillova menjëherë ta përkthej këtë libër që ia kisha kushtëzuar vetes derisa isha student në Kairo. Fillova ta nxjerr përkthimin në dorëshkrim duke filluar më 20 korrik 1990 dhe e përfundova pjesën e parë më 12 shtator 1990. Menjëherë fillova edhe pjesën e dytë, të po këtij libri, e kështu me radhë. Duke punuar vazhdimisht në punët e imamit dhe njëkohësisht të përkthimit të këtij libri, pas një viti mu dha rasti të filloj punë në Shqipëri.

Jetën time e kam ndërtuar në bazë të përgjegjësisë sime më të madhe, aty ku mund të kontribuoj më tepër. Gjykova se është më e rëndësishme ta ndihmojmë Shqipërinë dhe pa mëdyshje shkova atje. Në Shqipëri qëndrova tetë vjet. Në fillim isha koordinator i katër shoqatave arabe, pas dy vjetëve mora përsipër sektorin e bonjakëve pranë Komitetit të Botës Islamike deri në vitin 1996. Duke parë se situata në Kosovë po keqësohet vazhdimisht, hapa një Fondacion bamirës në Tiranë të cilin e emërova “Kosova”. Ky fondacion e dha kontributin e vet modest gjatë luftës në Kosovë.

Tani mund të them se angazhimi im në Shqipëri dhe problemet më elementare të jetës në Shqipëri, nuk më dhanë as edhe një mundësi të vetme ta rishkruaj këtë përkthim. Vërtetë këtij libri i kam hyrë në hak dhe shfytëzoi rastin të falënderoj All-llahun i Cili më mundësoi që këtu në Kosovë ta rishkruaj në kompjuter dhe ta dorëzoj në shtypshkronjë. Kisha ndërmend të filloj posa erdha këtu, mirëpo, problemet rreth shfrytëzimit të rrjetit të rrymës në Kosovën e pas luftës, më penguan disa herë dhe tani më në fund ia dola ta rishkruaj.

Imam el Sharavi, All-llahu e mëshiroftë, ishte një dijetar i pa shembullt në botën islame. Ai ishte shërbyes i madh i muslimanëve. Ligjeratat e tij ishin për të gjitha shtresat. Atë e kuptonin të gjithë, si dijetarët ashtu edhe njerëzit më të thjeshtë. Ai vazhdimisht ligjëronte nëpër xhamitë e Kairos dhe ishte i afërt me të gjithë. Meqë ishte shumë i kërkuar në mbarë shoqërinë islame ai nuk kishte shumë kohë të merrej me shkrime. Shumë nga librat e tij janë shfrytëzuar për xhirime televizive, sepse stili i tij është shumë komunikativ me të gjithë.

Unë zgjedha ta përkthej këtë libër për të vetmën arsye, sepse ky libër u mundëson muslimanëve të këtushëm që ta kuptojnë Kur'anin më mirë e më lehtë, si dhe t'i japë kurajo intelektuale shqiptare, për ta kuptuar Kur'anin. Ata nuk i kishin njohuritë elementare të fesë dhe veshitëre e kishin ta kuptonin Kur'anin të përkthyer në gjuhën shqipe, ngase, aty ka shumë gabime në përkthim. Jam munduar që t'ia lehtësoj lexuesit tonë edhe më tepër këtë libër duke futur disa fusnota dhe duke e treguar numrin e sureve dhe ajetin e temave për të cilat flet Kur'ani.

Lus All-llahun të më mundësojë që t'i përkthej sa më parë edhe pjesët e mbetura të këtij libri.

Maj 2001 Prishtinë, Muhamed Jusufi-Kajolli

## Ç'ËSHTË MREKULLIA

Kur'ani është fjala e All-llahut e zbritur tek i dërguari i Tij, prijësit tonë Muhammedit a.s. adhurohet me leximin e tij, Ai sfidon mbarë njerëzimin dhe xhindët si dhe çdo gjë që gjendet në botëra.

All-llahu nuk i sfidoi melekët sepse ato nuk janë të lira në vepra, ato veprojnë ashtu siç urdhërohen. Kur'ani sfidon secilin që e ndjen veten të fortë dhe që posedon lirinë e zgjedhjes, përderisa egzistojnë alternativat e mundshme. Këta janë ata që All-llahu i dalloi me fuqi mendore, mençuri dhe mundësi të zgjedhjes.

Para se të flasim për mrekullinë e Kur'anit është e domosdoshme së pari të përcaktojmë se ç'është mrekullia?

Mrekullia është prishje e proceseve natyrore ose ligjeve të gjithësisë të cilën All-llahu i Lartëmadhëruar ia ka dhuruar të dërguarit të Tij si dhe shpalos programin (rrugën) hyjnor. Me të, Ai i përforcon pejgamberët, për t'i bindur njerëzit se ata janë të dërguarit e Tij, të cilët kanë përkrahje nga qielli dhe ndihmohen nga qielli, si dhe t'u tregojë se kur qielli të ndihmon dhe të përkrahë aty stagnojnë të gjitha ligjet njerzore, sepse ato janë të pa afta dhe nuk mund të veprojnë

Nëse ndonjë person deklaron se është i dërguar i All-llahut ai ka ardhur të na informojë për rrugën e Tij. A duhet besuar atij, apo duhet kërkuar nga ai argument për atë çka deklaron. Pra, është e domosdoshme që çdo i dërguar i All-llahut të ketë me vete mrekullinë për të vërtetuar besnikërinë, përcjelljen dhe informacionin e All-llahut të Lartëmadhëruar. Mrekullitë e All-llahut dallohen dukshëm nga ato të tjerat, ato janë të qarta dhe bindëse, sepse ato së pari mposhtin ata të cilët e përgënjeshtrojnë dërgesën e Tij dhe ata që kërkojnë sfidë. Nuk do të quhet sfidë nëse nuk është kërkuar nga populli. Për shembull, nëse marrim kampionin botëror në ngritjen e peshës dhe e fusim në garë me të një njeri të rëndomtë, këtu nuk do të kemi mposhtje sepse nuk jemi prezentuar me kudërshtarë të kalibrit të tij, i cili vërtetë do të mudohej ta mposhtë atë. Nëse

marrim dy peshëngritësit më të mirët në botë dhe i fusim në garë, atëherë këtu do të kemi mposhtje dhe vetëm atëherë do të dallohet fituesi .

Shembulli tjetër, nëse marrim një njeri i cili ka studiuar medicinën dhe e dërgojmë në një vend ku nuk ka mjek dhe e fusim në garë, atëherë vetëvetiu nënkuptohet se nuk do të kemi mposhtje, këtu nuk kemi ndonjë efekt të fortë në thirrjen e njerëzimit për mposhtje. Mposhtja duhet të jetë prezent tek ata popuj të cilët posedojnë dhunti, përndryshe All-llahu nuk do ta mposhtë një popull përderisa nuk posedon dhunti dhe nuk e njohin Atë, e aq më tepër kur ata nuk kanë të paktën ndonjë inspirim. Prandaj, All-llahu i dhuron çdo të dërguari të Tij mrekullinë sipas dhuntive ose talenteve që i ka ai popull.

Mrekullia nuk ka për qëllim vetëm prishjen e ligjeve dhe mposhtjen e popujve, por, rrethanat i sjellin shkaqet e kësaj sfide. Nëse dëshiron All-llahu ta sfidojë një popull, atë mund ta bëjë edhe në mënyra dhe në rethana të tjera. Ai mund edhe t'i pengojë rrethanat dhe të pamundësojë realizimin e asaj vepre. Këtë që u tha më lartë do ta ilustrim me një shembull:

Mosdjegia e Ibrahimit a.s. si dhe shpëtimi i Musait a.s. konsiderohen mrekulli meqë All-llahu xh.sh.sollë shkaqet e pastaj ato i pengoi. Mrekullia e Ibrahimit a.s. ishte me qëllim që t'a mposhtë popullin i cili adhuronte putat (zotërat, idhujt). Ata putet i konsideronin të shenjtë dhe u binin në sexhde (përkuleshin). Vendimi gjyqësor i tyre ishte që t'a dëgjin Ibrahimin a.s. Ata e konsideronin këtë (djegien e Ibrahimit a.s.) si shenjë hakmarrje ndaj zotërave të tyre. Hakmarrje e cila do t'i gëzonte putat (idhujt) e tyre. Ky vendim i tyre konsiderohej se do të shërbejë si shembull (ndëshkim) për mbarë njerëzimin, për të gjithë ata që nuk i respektojnë putat e tyre.

## IBRAHIMI NUK U DOGJ

E sollën Ibrahimin a.s. pranë putave (idhujve) të tyre. Ndezën zjarrin në praninë e tyre. Qëllimi i djegies ishte që ata të shohin dhe të kënaqen vetë në shenjë hakmarrjeje. Ceremoniali i hakmarrjes ishte tejet masiv. Ata grumbulluan drunj si dhe iu drejtuan putave të tyre, pra, pranë fuqisë së tyre dhe e ndezën zjarrin. Çdo gjë që bëheshe kishte për qëllim madhërimin dhe lartësimin e idhujve të tyre, kundrejt All-llahut xh.sh. Shtrohet pyetja, pse lejoi All-llahu që Ibrahimin ta sjellin para turmës dhe ta djegin në prani të idhujve të tyre!? Ishte e mundur që t'i mundësonte Ibrahimit të fshihej diku ose ta mbronte në një apo tjetër mënyrë!? Mirëpo, as e para e as e dyta nuk ndodhi. Po të ndodhte njëra nga këto, atëherë adhuruesit e idhujve do të thonin se po t'a kapnim do ta digjnim dhe kështu ata do të vazhdonin me avazin e vjetër duke i lartësuar prapë idhujt si edhe më parë, po me atë “bindje për dobinë dhe fuqinë e tyre”. Kjo ishte arsyeja kryesore që Ibrahimin u desh të shkojë në vendin e djegies dhe të prezantohet para të gjithë atyre që besonin në putat e tyre të “*fuqishëm dhe që iu sillnin dobi*”, që të dëshmojnë se Allahu është i pamposhtur.

Ishte e mundur që zjarri të shuhej pas një shiu të furishëm, si një nga shkaqet e tjera për të mos ardhë deri te djegia. Kjo ishte e mundur të ndodhte, por, edhe kjo nuk ndodhi, për të njëjtën arsye siç përmendëm më sipër.

Ibrahimi a.s. nuk tentoi të ikë, por, u fut në turmën e drunjve ku zjarri ishte gjithnjë në rritje e sipër. Në një situatë të tillë siç ishte Ibrahimin a.s., All-llahu urdhëroi zjarrin që të bëhet i ftohtë dhe shpëtues për Ibrahimin.

Mrekullia e Ibrahimit nuk qëndron në atë që ai t'i shpëtonte zjarrit, sepse po të ishte dëshira e All-llahut që ai t'i shpëtojë zjarrit, atë nuk do ta kapnin fare, ose do të binte shi. Por, jo, asnjëra nga këto nuk ndodhi. All-llahu dëshiroi që zjarri të jetë përplot prush dhe Ibrahim i a.s. të hidhet në të, në prani të publikut, e që pastaj All-llahu të pengojë procesin e rregullave të diegies.

“Ne thamë: O zjarr, bëhu i ftohët dhe shpëtues për Ibrahimin”.<sup>1</sup>

Vullneti i All-llahut pamundësoi dhe pengoi vetitë djegëse të zjarrit. “Zotët e tyre” të cilët i kishte shkatëruar Ibrahim i a.s qëndronin para zjarrit dhe po “kënaqeshin” në shenjë hakmarrjeje në praninë e publikut. Të gjithë prezentuesit dëshmuan se ata u mposhtën, kurse Ibrahim i a.s doli prej aty pa asnjë dëm.

Në këtë mënyrë ndodhi edhe me Musanë a.s. kur All-llahu xh.sh. e urdhëroi nënën e Musaut që ta hedhë në lumë djalin për ta shpëtuar. Për shpëtimin e një foshnje, me siguri që mendimi i fundit do të ishte që ate ta hedhin në lum. Ky ishte inspirimi i All-llahut që ai të hidhet në lumë. Fëmia i posalindur të hidhet në lumë, do të ketë shumë më shumë rreziqe se në çfarëdo vendi tjetër. Do t'ishte e mundur të përmbysset nga valët sado të vogla dhe të mbytej, ose të sulmohej nga ndonjë shpend grabitqar dhe, ai nuk do të kishte mundësi të mbrohej. Mund t'i kanosej ndonjë rrezik tjetër që mund lehtë fare lehtë të pësonte. Domethënë hedhja në lumë do të ishte një nga vendimet e fundit të prindërve (nënës së tij) për shpëtimin e tij. Kishte mundësi të largohej nga Egjipti dhe të migronte me të. E mundur do të ishte që ta fshihte ate në një vend të sigurt. Por i gjithë ky rrezik ndodhi në saje të inspirimit të All-llahut i Cili e urdhëroi, që Musanë ta hedhë në lumë, ku rreziku i vdekjes ishte më i madh se shpëtimi i tij. Rreziku për mbytjen e Musaut ishte

---

<sup>1</sup> Kur'an, sure 21, el Enbija ajeti 69

shumë i madh, qoftë me fundosje, qoftë me rrëmbim nga shpendët ose erërat e forta. E ëma pranoi të gjitha këto rreziqe, thujase kjo ishte e vetmja rrugë e cila do të ishte rrugë shpëtimi për Musanë a.s. Vërtetë kjo ishte e vetmja rrugë sepse kjo ishte dëshira e All-llahut e kur Ai është veprues, stagnojnë të gjitha arsyet, bëhet ajo e papritura, pra që edhe hedhja në lumë të jetë shpëtim, siguri dhe qetësim.

## **MAGJISTARËT U PËRULËN – PSE?**

Të kthehemi përsëri tek mrekullia. Çdo pejgamber erdhi tek populli i tij me mrekullinë që nuk ishte e panjohur për ata. Populli i Musait ishte i njohur si popull i cili përdorte magjitë. Musai a.s. erdhi po me këtë mrekulli. Në momentin kur u kërkua mposhtja, mrekullia e Musait i mposhti të gjithë ata magjistarë. Magjistarët ishin të parët që i besuan atij, për arsye se ata ishin të vetmit që e njihnin magjinë dhe që e dalluan prej mrekullisë. Pa asnjë dyshim, ata të gjithë u përulën (i bënë sexhde All-llahut) para mrekullisë së Musait. Ata e panë të nevojshme që të pendohen menjëherë pas përfundimit të këtij garimi dhe mposhtjes së tyre nga frika e All-llahut.

“Dhe magjistarët ranë në sexhde. Dhe ata thanë: besuam në Zotin e botëve, Zotin e Musait dhe Harunit”.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Kur'an, sure 7, el Araf, ajeti 120

Ata ishin të parët që besuan, pak kohë më parë ata ishin kundërshtarët më të mëdhenj të mrekullisë, ata ishin që sfiduan mrekullinë e All-llahut. Kur vërejtën se në ç'mënyrë u mposhtën, ranë në sexhde. Shtrohet pyetja, a thua, e vetmja arsye ishte sepse ata kishin një pjesë të njohjes të magjisë në tokë?

“Vërtetë All-llahut i frikësohen nga robërit e tij dijetarët”! Kur e panë mrekullinë, ata u magjepsën dhe u ndjenë krenarë se janë pranë kësaj ndodhie, e cila ishte vetëm vepër e All-llahut të Lartësuar. Në moment ata i harruan të gjitha premtimet e Faraonit, harruan arin dhe argjendin dhe iu drejtuan botës tjetër e cila i priste ata. Harruan se faraoni do t'i dënojë rëndë. Ai ishte një mizor i pa shembullt në botë. Pranuan çdo gjë pasi u vërtetua se ishte mrekulli e All-llahut dhe ranë në sexhde. Këta ishin magjistarët më të mirë që kishte Faraoni i cili ishte zotuar se me ata ai do ta mundte Zotin e Musait dhe Harunit. Por, ndodhi e pa pritura për Faraonin, sepse këta të parët ranë në sexhde.

Kjo është madhështia e mrekullisë. Ata kishin premtimet më të mirat nga Faraoni. Atyre u mjaftonte që ta kundërshtonin në një apo mënyrë tjetër Musanë dhe çdo gjë do të ishte si më parë me Faraonin, sepse këta ishin këshilltarët e tij më të besueshëm dhe faraoni do ta përdorte forcën për momentin dhe do t'i “asgjësonin” rebeluesit. Por, ndodhi ajo që më së paku e priste Faraoni. Fytyrat e tyre ndryshuan dhe ashtu të hutuar para mrekullisë ranë në sexhde. I braktisën të gjitha të “mirat” e Faraonit si dhe haruan dënimet e tij kur panë shenjat e All-llahut.

I njëjtë është rasti edhe me Isanë i cili erdhi tek populli i vet me mrekullinë e njohur për atë popull. Mjekësia, ishte dhuntia dhe fusha në të cilën shquhej ai popull. Ndërsa ky me mrekullinë vet shëronte të verbërit, të lebrsurit e më vonë edhe i ngjallte të vdekurit me emrin e All-llahut

xh.sh.. Pra, Isai sfidoi popullin e vet në atë fushë në të cilën ata ishin më të fuqishëm. I tejkaloi ata me ngjalljen e të vdekurve në emër të All-llahut. Mposhtja ishte nga i njëjti lloj, nga e njejta dhunti. Ata kishin njohuri të mirëfillta në këto lëmi.

Po ashtu ishte edhe me Muhamedin s.a.v.s. Në kohën e tij arabët ishin të njohur si letrarët më të mirë. Retorika e letërsisë së tyre ishte në kulm dhe mrekullia e tij ishte e po atij lloji. Mrekullia e Kur'anit i mposhti ata. I thanë magjistar, injorant, i çmendur etj. Për këtë mrekulli do të flasim më tepër duke e shpjeguar gjërësisht në kapitujt e ardhshëm. Mrekullia e Kur'anit nuk është vetëm në aspektin gjuhësor. Por, kjo mrekulli është sfiduese e mbarë njerëzimit dhe xhindëve deri në shkatërrimin e botës. Kur'ani është rrezatues i zbulimeve të reja ndër gjeneratat. Ai përtërihet dhe sjell risi gjithmonë.

Nuk do të thotë se mrekullia duhet të shikohet si diçka alogjike dhe kundër proceseve natyrore, e cila sfidon të tjerët dhe kushtëzon me mosmposhtjen e tij nga kushtdo qoftë ai. Ndodh që mrekullia t'i prishë traditat edhe atëherë kur nuk është kushtëzuar nga dikush. Me këtë rast, All-llahu xh.sh. nuk kërkon nga ata që të bëjnë një gjë të tillë, por, kjo ndodh për arsye se All-llahu dëshiron t'i tregojë njerëzimit për forcën dhe madhësinë e Tij, ashtu që ata të mos i binden çdo sendi. Ai duhet të besojë dhe të kthehet drejt rrugës së All-llahut të Lartësuar, i cili i pengon dhe i prishë të gjitha shkaqet. All-llahu ka mundësi për çdo gjë, është i Gjithfuqishëm, fuqia e Tij nuk ka për ne rregulla dhe as kufij.

## MUNDËSIA E ALL-LLAHUT

Kur'ani paraqet mrekullinë për t'i demonstruar mundësitë e Fuqisë Absolute. Ai në kaptinën Merjem tregon vargun e thjeshtë të kushteve që lidhen shkak pas shkak për krijimin e njeriut. Këto kushte sigurojnë të qenurit e llojit. Për të vazhduar lloji ose trashëgimia, kushti është që të ketë lidhje direkte ndërmjet gjinive të kundërta, pra ndërmjet mashkullit dhe femrës. Që të arrihet deri te pllenimi, mashkulli duhet të jetë i aftë dhe femra duhet të jetë pa të meta.

Vullneti i All-llahut ishte të na tregojë fuqinë e Tij absolute e cila është pa rregulla dhe pa kufij. Kjo u bë me qëllim që njeriu mos të mendojë se pasardhësit ndërlidhen ngusht shkak pas shkak. Për t'u krijuar njeriu ekzistojnë katër mënyra të cilat na u treguan nga All-llahu xh.sh. Bashkimi i mashkullit dhe femrës nuk është gjithnjë kusht për të bërë trashigimtarë, por, kusht është që aty të jetë dëshira e All-llahut, i Cili mund të krijojë njeriun pa ekzistencën e qenies njerëzore, pra nga hiçi. Ai krijoi njeriun nga mashkulli pa femër, krijoi nga mashkulli dhe nga femra si dhe krijoi nga femra pa mashkull. Kështu, në këtë mënyrë, do të plotësohen katër llojet e krijimit.

Ta thjeshtëzojmë këtë :

All-llahu krijoi Ademin nga hiçi, pra pa mashkull dhe pa femër, ai ishte pa babë dhe pa nënë, ai u krijua nga All-llahu i Lartësuar “I fry nga shpirti i Tij“

Krijoi Havën nga mashkulli pa femër, ky është versioni më i saktë.

Krijoi mbarë njerëzimin nga mashkulli dhe femra .

Krijoi Isanë a.s. nga femra pa mashkull.

Mbarë njerëzimi erdhi nga njeriu mashkull, si dhe u krijua Isai a.s. nga femra e cila nuk kishte kurrfarë kontakti me mashkull. Kështu u plotësuan katër llojet e krijimit. Loza e çdo krijimi është në kompetencat e All-llahut të Lartësuar, nëse dëshiron Ai të krijohet ndokush me shkak, atëherë mundëson bashkimin e mashkullit me femrën. Ai krijoi, pa ekzistencën e tyre, krijoi Ademin nga dëshira e Tij. Krijoi Havën nga Ademi me dëshirën e Tij, pastaj krijoi nga femra pa mashkull Isaun a.s., vetëm e vetëm që të plotësohen katër llojet e krijimit.

Duhet të jemi të vëmendshëm kur themi se All'llahu i Madhëruar krijoi njeriun nga hiçi, se krijoi femrën nga mashkulli, se krijoi mashkullin nga femra pa kontaktuar me mashkullin, se krijoi njerëzinë mbarë nga mashkulli dhe femra, mrekulli këto të cilat i përshkruhen All-llahut shkak pas shkakut sipas dëshirës së Tij, sepse Ai në Kur'an thotë “kënd dëshiron Ai e le impotent”.

Nga kjo nënkuptohet se krijimi i destinohet dëshirës së All-llahut të Lartësuar, e në asnjë mënyrë bashkimit të dy gjinive.

“Vetëm i All-llahut është pushteti i qiejve dhe i tokës. Ai krijon çka të dojë. Ai i falë vetëm femra atij që do dhe i falë vetëm meshkuj atij që do, ose u falë çift, meshkuj e femra. Por, atë që do, Ai e le pa fëmijë. Ai është i Dijshëm dhe i Fuqishëm”.<sup>3</sup>

Poenta nuk është që aty të ekzistojë shkak, por, është dëshira e All-llahut. Për të qenë e suksesshme një gjë, duhet të egzistojë dëshira e All-llahut. Kur Ai nuk dëshiron të veprojë, Ai nuk do të veprojë. E atëherë kur Ai dëshiron të lejë mangut diçka, këtë e bën pa ndojnë rregull ose imponim të veçantë dhe pa ndonjë kufizim. Ai është absolut në fuqinë e Tij hyjnore.

---

<sup>3</sup> Kur'an, sure 42 el Shura, ajeti 50

## KUR SHKAQET PENGOHEN

Esenca e kësaj çështjeje është në vetë gjithësinë. Këtë çështje, All-llahu i Lartësuar ia dhuroi njeriut për të vetmen arsye, që me të t'i shtohet ose t'i hyjë besimi dhe me të ai të qetësohet. Me këtë, All-llahu i sugjeron besimtarit që mos të brengoset, sepse, Ai sikur i thotë: Unë jam Ai që i kam krijuar shkaqet dhe Unë kam fuqi të gjej shkaqe të tjera pa ndonjë rregull dhe inponim, andaj mos u brengos nëse të kaplojnë vështirësitë. Pas këtij momenti, njeriu vjen në një pozicion lehtësimi dhe e ndien veten të qetësuar e të relaksuar. Kështu njeriu largon trembjen dhe frikën nga vetvetja. Atëherë kur mendon se ka humbur çdo gjë, ai nuk duhet të hutohet por duhet të drejtohet drejt të Plotëfuqishmit, sepse besimtari nuk i humb shpresat në All-llahun. Ai nuk e shkatëron veten në momentin kur e sheh se po i mbyllet të gjitha shtigjet.

All-llahu tregon rastin kur Merjemja përshpëriste -“(Përkujto!) Kur gruaja e Imranit pat thënë : “Zoti im, unë këtë që kam në barkun tim vendosa ta përkushtoj thjeshtë vetëm në shërbimin Tënd, pra, pranoje këtë prej meje, vërtetë Ti je Ai që dëgjon e di. E kur ajo e lindi tha: Zoti im unë linda femër...”<sup>4</sup>

Thënjën: Unë linda femër !?, gruaja e Imranit e tha sepse ajo vuante ngase nuk lindi mashkull. Sipas saj, ajo e posalindura nuk do t'ia plotësonte premtimin që ajo ia kishte dhënë All-llahut, duke menduar se meshkujt janë më të privilegjuar tek All-llahu. Me këtë, sikur All-llahu do t'i thotë asaj, se, akoma vallë mendon se mashkulli është më i privilegjuar se femra!? Mjerisht, ky është njëri nga mendimet e njerëzimit në botën dëshpruese.

---

<sup>4</sup> Kur'an, sure Ali Umran, ajeti 35

Allahu në Kur'an i përgjigjet asaj: “E mashkulli nuk është sikur femra”!?

Me këtë, iu bë të kuptojë se femra të cilën e lindi ajo, është më e vlefshme se mashkulli të cilin e mendonte dhe se femra e ka vendin më të lartë në shoqëri se sa e mendonte ajo. Andaj, kursesi mos thuaj se All-llahu më dha femër e nuk më dha mashkull. All-llahu është krijues, Ai e di se kjo femër do të jetë e një veçorie tjetër. Pas vdekjes së babait të Merjemes farefisi kërkoi që njëri nga familjarët e saj të jetë kujdestar i saj. Fjala, dikush të kujdeset për te do të thotë se kujdestari i vërtetë i saj nuk ishte i gjallë. Për vajzën e posalindur do të kujdesej Zekerija. Me fjalën, se për të do të kujdeset Zekerija, nënkuptojmë se ai ishte lajmëtar (pejgamber) i All-llahut dhe ai do t'ia plotësonte asaj të gjitha konditat e jetesës. Sa herë që Zekerija hynte në faltore (ku edhe jetonte ajo), ai aty gjente ushqim. Nga fjala, se sa herë që hynte Zekerija në faltore, ose më saktë në vendin ku ajo binte në sexhde, ai gjente ushqim, kuptojmë se ai kujdesej për të. Por, ushqimin ai e kthente prap, sepse aty gjente gjithmonë ushqim. Ushqimi i vinte nga All-llahu i Lartëmadhëruar. Këtë e argumentojmë me pyetjet që Zekerija ia shtronte asaj:

“ ... prej nga ty ky ushqim? I thoshte: ky është nga All-llahu ...”<sup>5</sup>

Që nga fëmijëria e saj, ajo filloi të kuptojë se rregullat e All-llahut të Lartësuar nuk janë si tonat. Ai të ushqen andej nga nuk ta merr mendja.

Këtu duhet të ndalemi pak. All-llahu i Lartësuar i kishte premtuar Merjemes se ajo do të jetë një femër e rëndësishme dhe se do të jetë e këshilluar nga All-llahu, e pastaj e la në mbikqyrje të Zekerijasë. Gjatë kohës që pasoi, e ushtroi ate duke e bindur se secila gjë e ka shkakun e vet, me

---

<sup>5</sup> Kur'an, sure 3 Ali Umran, ajeti 37

përrjashtim të disa ndodhive të cilat nuk kanë shkak, ose nëse Ai do që t'i pengojë shkaqet. Allahu filloi ta përgatisë Merjemen, duke i dërguar asaj ushqimin i cili nuk ishte i njohur më parë në ruzullin tokësor. Perimet asaj i vinin kohë pas kohe. E gjithë kjo ishte parapërgatitje për një të ardhme të afërt, e cila sinjalizonte se All-llahu bën atë çka Ai dëshiron. Parapërgatitje tjetër për Merjemen ishte atëherë kur Zekerija e luti All-llahun që t'i falë djalë, mu në atë vend ku i vinte ushqimi Merjemes. All-llahu i dha sihariqin Zekerijasë për lindjen e djalit. Në ato momente kur atij iu aprovua lutja, ju kujtua se është plak dhe i vjetër, kurse gruan e kishte sterile. Duket se edhe ky nuk e dëgjoi mirë aprovimin e lutjes së tij, andaj iu drejtua All-llahut duke i thënë se si mund të ketë fëmijë kur nuk i plotëson rregullat njerëzore. Atëherë All-llahu i thotë :

“Kështu thotë Zoti yt, ajo për mua është e lehtë, Unë të krijova ty më parë atëherë kur ti nuk ishe fare”.

Nëse Ai e krijoi Zekerijanë duke mos qenë fare, Ai është në gjendje t'i japë fëmijë, duke mos i përfillur rregullat njerëzore. Kjo ishte një nga shembujt e tjerë për Merjemen, se kur All-llahu dëshiron diçka, e bën këtë pa ndonjë shkak. Fjala, aty e luti Zekerija, pra në vendin e sexhdes ku biente Merjemja, është vërtetim tjetër i cili do të përforcojë zemrën e saj, atëherë kur do të vijë dita e premtuar. Ajo ishte dëshmitare se lutjet plotësohen pa ndonjë shkak të njohur të rregullave të krijimit. Zekerija ishte i moshuar, e po ashtu edhe gruaja e tij ishte e moshuar bile edhe sterile. Ajo edhe aty u bind se All-llahu ka të gjitha mundësitë që t'i falë djalë. E gjithë kjo ishte parapërgatitje për Merjemen e cila do të lindte mashkull pa patur kontakt seksual. Edhe pse të gjitha këto përgatitje ia servoi All-llahu asaj, kur i erdhi lajmi ose më mirë të themi kur i erdhi Xhebraili dhe e lajmëroi, ajo u frikësua dhe pësoi tronditje andaj tha :

“Si do të kemë unë djalë, kur mua nuk më është afruar njeri (për martesë) dhe nuk isha amoralë“.

Edhe pse ajo kishte përjetuar të gjitha ato parapërgatitje, siç ishin ushqimi dhe fëmija e Zekerijasë, ajo prapëseprap u trondit kur e pa Xhebrailin. Për ta qetësuar Merjemen, Xhebraili i tha : Kështu ka thënë Zoti yt, kjo për mua është e lehtë , dhe për ta bërë atë (Isanë) argument për njerëzinë ...”

All-llahu sikur donte t’i thotë Merjemes, se pas të gjitha këtyre parapërgatitjeve që t’i servova, ti pa ndonjë shkak po befasoresh me atë se ç’po ngjet me ty. E Unë të kisha thënë “e Ushqej atë të cilin dua, prej andej nga nuk ia merr mendja” Ishe pra dëshmitare, se All-llahu çka dëshiron ta bëjë nuk mund ta pengojë askush dhe se kur All`llahu dëshiron të pengojë diçka do ta pengojë. Andaj, edhe pas të gjitha këtyre dëshmimeve po befasoresh në Zotin tënd !?

## **MREKULLI, POR, E PAKUSHTËZUAR**

Mrekullia e Isait a.s. nuk kishte qëllim provokim për mposhtjeje. All-llahu i Lartësuar, me këtë mrekulli nuk sfidoi askënd. Qëllimi i kësaj mrekullie ishte demonstrimi i mundësisë dhe vullnetit të Tij dhe plotësimin e llojit të katërt të krijimit të njeriut, pra, krijimin nga femra pa mashkull.

Mrekulli tjetër me të cilën All-llahu nuk kushtëzoi askënd, është mrekullia e Musait a.s. Ai e çau detin dhe u hap rruga për të kaluar matanë bregut. Populli çifut ishte frikësuar nga ushtria e

faraonit dhe nuk kishte nga të shkonte, para tyre ishte ushtria e cila do t'i masakronte kurse mbrapa tyre ishte deti. Ky ishte një vlerësim që e jepte logjika e njeriut. Në këtë situatë, Musai ngrii duart dhe çështjen ia la All-llahut të Lartësuar. Populli i tmerruar buçiste, nuk kishte shpresë të vepronte ose të bënte diçka, të ikte, nuk kishte se ku të shkonte. I vetmi zë që dëgjohej pas hutisë që e kishte kapluar atë popull ishte thënia- u masakruam. Në atë moment Musai a.s. tha:

“Jo, kurrsesi. Me të vërtetë me mua është Zoti im dhe Ai do të më udhëzojë “<sup>6</sup>

Kështu që çështja u transferua nga logjika njerëzore në mundësinë e All-llahut xh.sh. Pra, nga regullat dhe mundësitë njerëzore, të cilat janë të kufizuara, në ato të All-llahut që janë të pa kufizuara. Kur çështja kalon në mundësinë e All-llahut aty nuk thuhet se si ndodhi, por, mjafton të shprehet dëshira e All-llahut e ajo të bëhet. Ai është i pa krahasueshëm. Ai nuk i ngjason askujt. Prandaj, nuk duhet të habitemi në ndryshimet që i shohim, përderisa nuk kemi shembull me se ta krahasojmë, por duhet ti nënshtrohemi Atij. Kur All-llahu i tha Musait:

“Godite detin me shkopin tënd! – e ai u nda ...”

Sipas regullave tona, nëse e godasim detin ai nuk do të ndahet, por, këtu kemi të bëjmë me një veprim tjetër i cili nuk është i bazuar në ligjet tona.

Mrekullia është dy llojesh :

---

<sup>6</sup> Kur'an, sure 26 el Shura, ajeti 62

Ajo që dhurohet për t'i sfiduar popujt e tjerë dhe për t'i bindur njerëzit duke i përfituar zemrat e tyre. Kjo është një udhëzim nga i Plotëfuqishmi, i cili i dërgoi peygamberët për ta shpjeguar programin e Tij të paraparë për njerëzimin.

Ajo e cila dhurohet tek të dërguarit e Tij për të demonstruar forcën, duke mos patur për qëllim sfidën. Kjo bëhet për arsye të ndryshme të momentit, mjafton që Ai të urdhërojë dhe ajo bëhet. Urdhëri vjen nga i Gjithëfuqishmi, kurse mënyra e veprimit të Tij është e pakrahasuar.

## **KUR'ANI MREKULLI E VAZHDUESHME**

Mrekullia e Kur'anit ndryshon dukshëm nga mrekullitë e peygamberëve të mëparshëm. Mrekullitë e peygamberëve të mëparshëm, ishin mrekulli që shfaqeshin në moment. Ato shfaqeshin në prezencën e popullit, për të bindur popullin se ata janë të dërguarit e All-llahut. Ai që i shikonte ato mrekulli, do t'i besonte, kurse ai i cili nuk i dëshmonte ato, do të varej prej tij pasi të informohej për mënyrën e ndodhisë. Sikur edhe ne të mos i dëgjoni nga Kur'ani, do të kishim thënë se ato mund të mos kishin ndodhur ose janë gjeputura.

Mrekullitë të cilat shfaqeshin në prezencën e popullit ishin bindëse. Por, ata të cilët nuk i kishin parë, mund t'i besonin si të atilla, sepse ato nuk reprimoheshin herën tjetër. Ka zëra që thonë se me zhvillimin e shkencës ato mund edhe të zbulohen. Këto thënie janë të pa sakta, sepse mrekullia mbetet mrekulli, deri në ditën e kijametit. Mbase dikush, dikur mund të thotë se unë e

hap detin, por, edhe sikur të ndodhte kjo, nuk do ta kishte efektin e mrekullisë, sepse mrekullia mbetet mrekulli. Por, në një gjë jam i bindur. Asnjë njeri nuk mundet që me një goditje ta ndajë detin. Dikush mund të thotë se Isai a.s. i shëronte të lebrosurit, të zgjebosurit etj. Edhe tani ne i shërojmë këto sëmundje. Mirëpo, mrekullia mbetet mrekulli, në vet faktin se nuk do të mundet askush t'i shërojë këto sëmundje vetëm me një të prekur ose duke shenjëzuar, përveç Isait a.s. Dikush mund të konstatojë, se sot brenda një dite mund të shkohet disa herë nga Mekka në Jerusalem. Por, edhe këtyre u themi se nuk mund të shkohet në mënyrën siç shkoi Muhammedi s.a.v.s. pa aeroplan, duke mos e llogaritur shkuarjen e tij në qiellin e shtatë. Sado të ndryshojnë format e jetës, mrekullia mbetet mrekulli në mënyrën e vet. Ajo do të konsiderohet mrekulli në vetë llojin e shfaqjes së saj. Nuk ka dituri njerëzore, dhe as që do ketë, që ta zbulojë këtë lloj të mrekullisë, ajo do të mbetet mrekulli.

Nga ajo që kemi dëgjuar për mrekullitë e mëparme, konstatojmë se vërtetë janë vepra të All-llahut, ngase veprat e All-llahut mbarojnë menjëherë pasi që ato të shfaqen, p.sh. hapja e detit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, pasi të shfrytëzohet ajo kohë. Zjarri ndryshoi cilësinë e vet për një moment, për Ibrahimin a.s. dhe, më pas u kthye në gjendjen e mëparshme. Kurse mrekullia e Muhammedit s.a.v.s. është një nga cilësitë e All-llahut, e ajo është të folurit e Tij dhe kjo do të mbetet gjithmonë, kjo cilësi do të vazhdojë së ekzistuari deri në pafundësi .

Të dërguarit e All-llahut dallohen sipas përkrahjes së tyre me mrekulli ose veçoheshin me ndonjë shenjë. Ato dallohen nga mrekullitë e njerëzve, ngase All-llahu iu mundësoi që vepra e tyre t'i gjasojë mrekullisë së kohës së vet. All-llahu bën që i dobëti të bëhet i fortë, të pa mposhturin e

bën të mposhtet, ate që është i pa aftë e aftëson, p.sh. mrekullia e betejës me elefantë<sup>7</sup>.– All-llahu bëri që shpendët e quajtur Ebabil, të sulmojnë ushtrinë dhe elefantët me guralecë dhe t'i shkatërrojnë. Një krijesë kaq e vogël të jetë vdekjeprurëse kundrejt elefantëve, ishte e pa besueshme. Por, ja që kjo ishte një mrekulli e All-llahut, që i tronditi edhe ata njerëz të cilët nuk e kishin parë këtë mrekulli, por vetëm e kishin dëgjuar. Tani kemi disa shkencëtarë që thonë se ato shpezë kishin me vete disa mikrobe që ishin vdekjeprurëse për ushtrinë dhe elefantët. Kjo thënie e këtyre dijetarëve nuk ka bazë shkencore dhe kohore. Ata dëshirojnë të krijojnë amulli në popull, me qëllim që të ulet madhështia e mrekullisë. Një gjë është e qartë, mrekullia mbetet mrekulli. Mrekullia nuk i nënshtrohet rregullave të logjikës së njeriut. Ajo, duhet të tregohet ashtu siç ishte dhe siç u përcoll nga Kur'ani. Kjo ngjarje ndodhi në vitin e lindjes së Muhammedit s.a.v.s. Kur'ani na e përshkruan ngjarjen pas 40 viteve. Sikur të mos ishte ashtu siç e përshkruan Kur'ani, atëherë do ta përgënjeshtrojnë jobesimtarët e kohës, të cilët e kishin përjetuar ngjarjen dhe ishin dëshmitarë të gjallë. Ata e vërtetuan atë ndodhi. Kjo ngjarje na vërteton madhështinë e mrekullisë, së bashku me forcën dhe dëshirën e All-llahut. Atij që Ai dëshiron t'ia japë mrekullinë, i jep fuqi dhe mundësi. U jep forcë zogjve për t'i mundur elafantat edhe pse kjo gjë është në kundërshtim të plotë me logjikën njerëzore. I mundësoi Musait që t'i mundë magjistarët, si dhe t'i jep forcë për t'a ndarë detin. Poashtu, i mundësoi edhe Isait t'i shërojë të sëmurit, si dhe t'i ngjallë të vdekurit. Të gjitha këto ishin me emrin e All-llahut. Mrekullia e Zotit ndryshon dukshëm nga mrekullitë (magjitë) e njerëzve. Nëse një njeriu të dobët i thuhet që të bartë një peshë të cilën nuk mund ta bartë, tjetri nuk mund t'ia japë fuqinë e vet atij, por, do ta bartë peshën në vend të tij.

---

<sup>7</sup> Beteja e zhvilluar në mes ushtrisë së perandorit Ebrehe dhe shtëpisë së All-llahut në tokë (Qabes). Kjo betejë ndodhi në vitin e lindjes së Muhammedit s.a.v.s.

Sado që të ecë përpara shkenca, njeriu nuk mund t'i japë fuqi të jashtëzakonshme tjetrit, por, ai mundet vetëm ta ndihmojë nga jashtë. I vetmi që mundet të bëjë këtë, është All-llahu i Lartësuar. Të dobëtin Ai e bën të fortë, sepse Ai është absolut. Gjithmonë kur e vëren se një i dobët e mund te fortin, dije se kjo është dhuratë e All-llahut. Në rastin kur Ibrahim i a.s. kërkoi nga All-llahu që ta bindë se si i ngjallë të vdekurit, All-llahu i tha: “A nuk më beson !?”. “Jo por të më qetësohet zemra”, ia ktheu Ibrahim i a.s. Atëherë, All-llahu i tha merre një shpend dhe copëtoje atë dhe pjesët e tyre shpërndaji nëpër skajet e qytetit. Atëherë kur para tij erdhi çdo pjesë e trupit të shpendit dhe të njëjtat u ngjitën, shpendi u kthye në gjendjen e mëparme. Pra, Ibrahim i a.s. u lut për këtë, pra, All-llahu dëshiroi dhe urdhëroi dhe ajo u bë në çast. Mrekullia e All-llahut dallon shumë nga mrekullitë e njerëzimit dhe ate do ta shohim në temat tjera të ardhshme.

## **SI MUND TË NDRYSHON MREKULLIA E KUR'ANIT**

Mrekullia e Kur'anit dallon nga mrekullitë e peygamberëve të mëparshëm nga shumë këndvështrime. Mrekullia e Kur'anit shpeshherë është e padukshme, ajo do të zbulohet atëherë kur të ndodhin zbulimet shkencore, ose jep udhëzime për një të ardhshme e cila do të zbulohet më vonë nga njerëzimi. Ndodh që mrekullia e Kur'anit të jetë në një shkronjë, pra, kjo shkronjë të jetë zbuluese e një mrekullie të mahnitshme. Kur'ani është ushqyes ose frymëzues i çdo gjenerate, i jep një gjenerate ate që nuk ia ka dhënë gjeneratës së kaluar, sepse Kur'ani është libër universal.

Ky libër nuk ndryshon, ky është burimi kryesorë i fesë për të gjitha gjeneratat. Nga kjo kuptohet se Kur'ani është furnizues i mbarë njerëzimit. Në të kundërtën, Kur'ani do të humbë efektin e vet po të ishte ushqyes vetëm për një gjenerate. Ai është i pa shterrur dhe prodhon gjithmonë. Ai do t'i jep një gjenerate atë çka nuk i ka dhënë tjetrës dhe çudia ndodhë të jetë në të njejtin ajet<sup>8</sup>. Për shembull, një gjeneratë zbulon se një ajet ka domethënie të cilën nuk e kishte zbuluar kush më parë, e më pastaj vjen një gjeneratë tjetër e cila e kupton më ndryshe dhe më hollësisht po atë ajet.

Për të qenë edhe më të saktë në atë që e themi, duhet që Kur'anin ta ndajmë në dy drejtime.

Ajetet që kanë të bëjnë me adhurimin dhe ajetet që i përkasin të drejtës islame.

Këto ajete nuk ndryshojnë. Për shembull, aty ku All-llahu urdhëron të veprohet ose të mos veprohet, ose se një gjë është hallall e një tjetër është haram, kjo nuk mund të ndryshohet ndër të gjitha gjeneratat që pasojnë. Ato mbeten ashtu siç na ka mësuar Muhammedi s.a.v.s. Shembull për këtë janë pesë kohët e namazit, për të cilat nuk diskutohet për ndryshim. Pastaj, nuk ndryshojnë: Dëshmia që nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut, zekati, hallalli dhe harami, kurorëzimi, çkurorëzimi, si dhe të gjitha rregullat legjislative të qarta nga Kur'ani dhe të shpjeguara nga Muhammedi s.a.v.s. Nuk mund të thotë dikush se namazet janë katër e jo pesë. Sado që të mundohen të argumentojë këtë, kjo do të jetë e papranuar dhe as që do të pranohet që të diskutohet për këtë, me ata që mundohen të argumentojnë një gjë të tillë. Vepro ose mos vepro, janë çështje që nuk ndryshojnë. Këto janë vepra të cilat zbatohen me urdhër. Nëse e kryen urdhërin, shpëton, e nëse nuk e kryen atë vepër dënohesh. Këto janë rregulla të cilat i ka

---

<sup>8</sup> Varg i Kur'anit, që do të thotë: argument ose shenjë.

përcaktuar vetë All-llahu, se si duhet ta adhurojmë Ate. Vetë Ai na ka treguar rrugën se si të veprojmë.

Ajete që kanë të bëjnë me krijimin dhe shkencën

Këto janë ajete të cilat në kohën e zbritjes së Kur'anit, njerëzit nuk ishin në gjendje t'i kuptonin plotësisht. Për shembull, thënia se globi tokësor është në forme elipsoide. Kjo ishte një nga vërtetësitë e Kur'anit që e kishte theksuar në fillim të revelatës. Një nga thëniet e Kur'anit rreth sferave ajrore të tokës. Pastaj, thëniet rreth shkencës së embriologjisë, rotacionit dhe revolucionit të tokës. Rreth kohës, si dhe shumë e shumë thënie të tjera nga të vërtetat e gjithësisë, të cilat u shkruajtën në Kur'an. Ajetet e tilla Muhammedi s.a.v.s. nuk i shpjegoi me qëllim, këto i la të kuptohen me kalimin e kohës. Vërejmë se Kur'ani është vetë mrekullia, që i ofron njeriut aq sa të mund të kuptojë prej tij.

Kjo ishte një nga mrekullitë e Kur'anit. Ai paraprin dhe paralajmëron çdo gjë që ka kuptim. Kur All-llahu do që t'ia zbulojë njeriut ndonjë nga sekretet e gjithësisë, do të shohim se ai zbulim është i po të njejtit kuptim në ajetin Kur'anor.

## **ZOTI I LINDJES DHE PERENDIMIT**

I Lartëmadhëruari në Kur'an thotë :

“ (Unë jam) Zot i lindjes dhe perëndimit...”, “(Unë jam) Zot i dy lindjeve dhe Zot i dy perëndimeve...”, “(Unë jam) Zot i shumë lindjeve dhe shumë perëndimeve...”

Të fillojmë nga ajeti parë. Do të shohim se ky ajet në kohën e zbritjes së tij, është kuptuar si ana e lindjes dhe ana e perëndimit të diellit. Në kohën kur All-llahu ishte i lindjes dhe i perëndimit, nuk kishte kurfarë kundërshtimi. Të shohim tani versetin e dytë. “I dy lindjeve dhe dy perëndimeve”. Nëse thamë se lindja presupozon anën e lindjes së diellit, atëherë thënia “e dy lindjeve” nënkuptonte Lindjen si tërësi që është ana e lindjes dhe vendi i lindjes së diellit. Është e njëjtë sikur të thuash kjo është ana e lindjes e kjo ana e perëndimit dhe shenjëzon me dorë, por, nëse ke për qëllim të thuash lindjen dhe perëndimin e diellit, do ta përcaktosh saktësisht lindjen dhe perëndimin e diellit. Kurse ajeti, “I shumë lindjeve dhe shumë perëndimeve”, është kuptuar se çdo shtet e ka lindjen dhe perëndimin e vet. Kështu ishte spjeguar në kohën e zbritjes së Kuranit, All-llahu është Zot i të gjitha lindjeve dhe perëndimeve.

Sot shohim se këto komentime kanë ndryshuar. “Zoti i lindjes dhe perëndimit” kuptohet si një tërësi. Allahu i Lartësuar e ka bashkangjitur fjalën lindje me fjalën perëndim, që do të thotë se aty ku është lindja është edhe perëndimi. Kështu prejjudikon kuptimi i tokës së rumbullakët. Ai tha : “...Zot i lindjes dhe perëndimit”, e nuk tha se Unë jam Zot i lindjes dhe Zot i perëndimit, ose të All-llahut janë lindja dhe perëndimi. Në kohën e zbritjes së Kur’anit këto ishin dy anë të kundërta mes veti, të pranuar në parim sipas shikimit të syrit. Por, thënia: “Zot i lindjes dhe perëndimit”, sot nënkupton se lindja dhe perëndimi janë të një kohe, të një momenti. Në kohën kur në një qytet lind dielli, në të njëjtën kohë ai perëndon në një qytet tjetër.

Të shohim tani ajetin tjetër :

“(Unë jam) Zot i dy lindjeve dhe Zot i dy perëndimeve “

Pse Ai tani këtu veçoi lindjen dhe perëndimin. Nëse shikojmë rruzullin tokësor, do të shohim se gjysma e saj është e ndritur dhe gjysma tjetër e errët. Pra, pjesa e ndritur ka lindjen dhe perëndimin, kurse pjesa tjetër është në errësi të plotë. Pasi të rrotullohet toka, do të shohim se pjesa e ndritur është errësuar e pjesa e errët është ndritur. Konstatojmë se rruzulli tokësor, në tërësinë e vetë, ka dy lindje dhe dy perëndime. Pra, ajeti “Zot i dy lindjeve dhe Zot i dy perëndimeve”, na e përkujton gjysmën e tokës së ndritur, që ka lindje dhe perëndim, dhe gjysmën tjetër të errët, që nuk ka as lindje e as perëndim. Pasi të rrotullohet toka, kemi edhe një lindje dhe një perëndim të gjysmës së saj, që nuk kishte lindje dhe perëndim. Kështu, bëhen dy lindje dhe dy perëndime.

Ajeti: “(Unë jam) Zot i shumë lindjeve dhe shumë perëndimeve”

Sikur të mos përparonte shkenca, ne nuk do të ndryshonim kuptimin e këtij ajeti. Por, një rast, u befasova kur në një nga arkivat e vjetra lexova thënjen e një poeti ku thoshte: *“Oj kohë në ty janë të gjitha kohërat”*, që na bën të kuptojmë se koha i bashkangjitet vendit ku ajo edhe ndodhet. Për shëmbull, në kohën kur unë fali namazin e drekës, në një vend tjetër ka njerëz që falin ikindinë, në një vend të tretë falin akshamin, në të katërtin falin jacinë, e në të pestin falin sabahun, që do të thotë se në të njejtën kohë, thirret ezani i drekës, ikindisë, akshamit, jacisë dhe sabahut. Allahu përmendet në çdo kohë, në çdo moment dhe në të gjitha namazet e kohës.

Me përparimin e njerëzimit, u bë e mundur që më saktësisht të spjegohet ky ajet. I njëjti ishte frymëzues edhe në kohën e zbritjes, e sot shohim se si po na inspiron edhe neve. Mbase, ky ajet do t'i inspirojë edhe pasardhësit tanë, në një mënyrë tjetër pas zbulimeve të reja.

Kjo pra është mrekullia e Kur'anit, i cili është inspirues i të gjitha gjeneratave. I jep secilit aq sa mund ta kuptojë, duke mos qenë në kundërshtim me realitetin në të cilin ai jeton. All-llahu nuk ndeshet me realitetin e gjithësisë, Ai është frymëzues i përhershëm. Shkenca nuk do të përplasë me Kur'anin kurrë, sepse All-llahu është veprues. Ai është edhe krijues edhe protagonist i fjalës.

Kjo ishte një nga veçoritë e Kur'anit i cili dallon nga librat tjera qiellore (të shenjta). Kjo do të jetë tema të cilën do të shpjegojmë më hollësisht në të ardhmen.

## **SA E RUAJMË KUR'ANIN DHE SA E PRAKTIKOJMË ATË**

Thamë se Kur'ani, në shumë aspekte, dallon dukshëm nga mrekullitë e pejgamberëve të tjerë. Secili pejgamber kishte mrekullinë dhe programin e vet. Musai a.s. si mrekulli kishte shkopin, kurse për program kishte Tevratin. Mrekullia e Isait a.s. ishte mjeksia, kurse programi i tij ishte Inxhili. Kurse, mrekullia e Muhammedit s.a.v.s. ishte edhe vetë programi i tij. Kjo bëri që mrekullia ta ruaj programin dhe programi ta ruaj mrekullinë. Më parë, besimtarët ishin të ngarkuar që librat e shenjta t'i mësonin përmendësh.

Çka ndodhi me ata që u ngarkuan nga All-llahu për t'i mësuar ato libra përmendësh? Me kalimin e kohës, gjeneratat e mëparshme, i kryenin me neglizhencë obligimet me të cilat ishin të ngarkuar nga i Lartësuari. Kjo bënte që ato thënie të All-llahut të harrohen, ose ato që nuk ishin haruar, të pësonin devijime. Disa nga thëniet ata i citonin, e disa tjera nuk i citonin fare. Pra, kështu ata

ndryshonin thëniet, duke i shtuar nga vetëvetja, dhe thonin se këto ishin fjalët e All-llahut. Këto ndryshime, ata i bënin për shkak të përfitimeve të tyre të çastit. Përderisa ata ishin të obliguar që t'i mësojnë përmendësh ato libra, ata nuk e mbajtën fjalën. Ata futën në këto libra thënie nga vetvetja, kështuqë tradhëtuan veten dhe pësoi devijimi i tyre.

Por, kur All-llahu zbriti Kur'anin, në një nga ajetet e Tij tha :

“Vërtetë ne e zbritëm Kur'anin dhe ne do ta ruajmë atë (nga ndryshimet që mund të pësojë ky libër)”.

Kështu tha, sepse vetë Kur'ani është mrekulli, dhe përderisa është mrekulli, pa tjetër kjo përbamajtje duhet të qëndrojë e pandryshuar, përndryshe do të humbë të qenurit e tij mrekulli.

Së dyti, sepse All-llahu i kishte provuar më parë njerëzit me të mësuarit e tyre përmendësh në librat e mëparshme. Nuk qenë në gjendje ta ruajnë dhe pësoi devijimi.

Këtu vërejmë një gjë shumë të rëndësishme, na qartësohet neve se mrekullia e Kur'anit është edhe në vetë përkuajdesin e drejtëpërdrejtë dhe nën mbrojtjen e All-llahut të Lartësuar. Ruajtja e Kur'anit bazohet në dy drejtime:

Mënyra e praktikimit të Kur'anit dhe shkrimit të tij,

Mënyra e mësimin përmendësh

Mësojmë se praktika dhe shkrimi i tij gjatë shekujve ishte i dobët, kurse sa i përket të nxënimit përmendësh në çdo shekull sa vinte e rritej në mënyrë të furishme numri i atyre që mësonin përmendësh. Sot Kur'anin e kemi në çdo zyrë, nëpër shtëpi, nëpër vetura, me një fjalë, e kemi në

çdo vend. Shumë nga ata që nuk e besojnë, atë e shkruajnë me lloj lloj zbukurime, p.sh. gjermani e ka shtypur Kur'anin në një fletë të vetme dhe e ka zbukuruar atë, edhe pse ky person nuk e ka lexuar fare Kur'anin në jetën e tij. Shohim japonezin i cili bën vepra arti në të, poqëse e pyet pse nuk e bën këtë me librat e tjera ai do të përgjigjet se nuk e di. Do t'i përgjigjemi ne, ata janë të magjepsur me të. Sepse tani All-llahu është mbrojtësi i Kuranit, e jo si në librat tjera të shenjta. I gjithë ky kujdes rrjedhë nga All-llahu e jo vepra e njeriut. Ti kur e sheh këtë Kur'an nëpër shtëpi nëpër vetura ose gjetkë dhe e pyet zotin e shtëpisë ose veturës se a e studion ose e lexon këtë Kur'an? A e kryen namazin sipas regullit? Do të përgjigjet, jo. Atëherë po e pyete pse e ruan Kur'anin në shtëpi ose veturë? Nuk di të përgjigjet ose do të thotë e ruaj për bereqet.

Neglizhenca jonë ndaj mësimi përmendësh të Kur'anit është bërë karakteristikë e kohës sonë dhe duke mos patur shumë nga ata që e nxënë Kur'anin përmendësh bën që të shtohet tirazhi i tij ndër njerëz qofshin ata edhe jo muslimanë. Nga kjo konstatojmë se All-llahu do të na e bëjë të qartë se Ai është mbrojtësi i Kur'anit, Ai e bën këtë që të mos pësojë ndryshime. Si dhe konstatimi tjetër është se sado të zvogëlohet numri i hafizave<sup>9</sup> do të rritet tirazhi i Kur'anit në botë sepse njerëzit janë ngarkuar në praktikimin e tij kurse All-llahu në ruajtjen e tij.

Tani të shohim pikën e dytë të rëndësisë së Kur'anit të qenurit e tij mëshirë për njerëzinë. Kjo është një nga mrekullitë e tij. All-llahu i Lartësuar dërgonte peygamberë nëpër vende dhe shoqëri të ndryshme. Ajo bëhej për ti plotësuar nevojat e tyre si dhe për ti udhëzuar në rrugën e Tij. Secili popull paraqiste nevojat sipas karakteristikave të jetës së tyre. Kjo e bënte të nevojshme dërgimin e peygamberëve për të plotësuar kërkesat e tyre, por, ka ndodhur që All-llahu të dërgojë

---

<sup>9</sup> Personat që e dine Kur'anin përmendësh

nganjëherë në të njëjtën kohë më tepër se një, ose dy të dërguar (pejgamber) për ti plotësuar nevojat e shumta të tyre. psh Ibrahimin a.s dhe Lutin a.s. i ka dërguar në të njëjtën kohë për të vetmen arsye se popujt në atë kohë ishin të shkëputur dhe nuk e njihnin njëri tjetrin. Ka ndodhur që një popull të jetojë dhe të zhduket pa patur njohuri populli tjetër i të njëjtës kohë por në vend tjetër. Atëherë nuk ishte përparimi i kohës sonë dhe lidhjet ndërmjet tyre kanë qenë të rralla. Ashtu siç ishin të ndarë edhe problemet i kishin të ndryshme. Kishte nga ata që nuk ishin besnikë, kishte nga ata që besonin idhujt si dhe kishte nga ata që ishin shkatërrimtarë. Me përparimin e shkencës bota u bë një shoqëri. Nëse ndodhë diçka në Amerikë do ta ndëgjosh atë për disa sekonda në Egjipt. Po ashtu nëse ndodhë diçka në Japoni do ta dëgjosh për disa minuta në Evropë. Pra, ndërlihdja bëri që të njihemi më mirë, më shpejtë dhe më lehtë. Kjo bëri që të jemi më të afërt ndërmjet vete. Duke qenë se ndërlihdja u shpeshtua dhe u lehtësua edhe nevojat u bënë të njëjta. U arrit që nëse një vend (shtet) ankohet do të vërehet se ankesa ka arritur shumë shpejt në shtetet e tjera. Kjo të detyron të kërkohet dhe të gjendet një shëruar. psh. thirrja në mosbesim dhe në komunizëm lëshoi farë në mbarë botën, nuk la vend pa u shtrirë. Sistemi monetar dhe kamata është shtrirë në mbarë botën. Ngrënja e pasurisë pa të drejtë dhe vjedhja janë në shumë shtete të botës. Nga kjo konstatojmë se nevojat janë bërë të njëjta dhe këto nevoja kërkojnë ilaçin e njëjtë. Islami është fe universale, sëmundja e njëjtë kërkon ilaçin e njëjtë, pra, edhe kjo është një nga mrekullitë e Kur'ani Kerimit. All-llahu i Lartëmadhëruar ia ofroi njerëzimit ilaçin unikal para se të paraqitet nevoja (sëmundja) e përbashkët dhe me këtë All-llahu i parapriu shkencës njerëzore.

## **KUR'ANI PËRCAKTOI PREJARDHJEN E DITURISË NJERZORE**

Kemi edhe një dallim të dukshën në mes mrekullisë së Kur'anit dhe mrekullirave të tjera. Ai përcaktoi bazën e diturisë së njerëzimit dhe na transmetoi se si mësoi njeriu. Kështu që All-llahu në Kur'an thotë :

“Dhe ia mësoi Ademit të gjitha emrat”

Me këtë na tregon se baza e diturisë së njeriut fillon që prej këtu. Kur dëshironi ta mësoni fëmijën tuaj do të filloni t'ia mësoni në fillim emrat. Gjuha është mjet i të kuptuarit ndërmjet njerëzve. Këtij njeriu të cilin e krijoi All-llahu dhe i mundësoi të jetojë në këtë ruzull tokësor dhe i cili ngriti tërë këtë qytetërim dhe kulturë të cilën po e dëshmojmë ne, do të duhej të kishte një ndërlidhës në mënyrë që të kuptohej ndërmjet vete tani duhej të ket një ndërlidhës derisa të kuptoheshin ndërmjet vete. Sikur mos të ishte kjo ndërlidhje e të kuptuarit ndërmjet vete nuk do të ekzistonte ky qytetërim dhe kjo jetë reale. Ose së paku të bartej dituria e një gjenerate në gjeneratën tjetër për të vazhduar dhe përparuar, duke e plotësuar me njohuri të reja gjeneratat e tjera. Ky lidhësor ishte gjuha dhe fjala të cilën e dëgjojnë veshët dhe pastaj e flet gjuha nga goja. Nëse lind njeriu pa shqisën e të dëgjuarit, ai nuk di të flasë. Gjuha pra nuk është e trashëguar prej gjakut e as prej rrethit shoqërorë, ajo nuk është as organ e as nuk trashigohet. Ajo nuk mbështetet në ndonjë njeri të veçantë. Atë që e ndëgjon njeriu ate edhe e shqipton. Nëse do ta kisha marrë ndonjë foshnje nga Franca ose Holanda ose Afrika, ai do të fliste gjuhën e rrethit ku do të jetonte

edhe pse është shtetas tjetër. Po ashtu sikur të kisha dërguar një arab në një vend ku nuk ka arab ai më vonë nuk do të dinte të fliste arabishten.

Pra, njeriu ate çka dëgjon ate do ta flasë. Nuk ka dobi nga shprehja e fjalës përderisa ajo nuk ka kuptim dhe shpjegohet. Njeriu nuk e emërton një send që s'ekziston. Psh. Ti nuk do të ishe në gjendje ta emërtoje gotën nëse ajo nuk do të ekzistonte më parë, se përndryshe fjala e shqiptuar nuk do të kishte kuptim.

Të kthehem tani tek mrekullia e Kur'anit. Kur'ani është fjalë e All-llahut, kurse fjala është baza e civilizimit, kurse baza e diturisë është reveluar nga All-llahu tek njeriu. All-llahu në Kur'ani Kerim thotë: “Dhe ia mësovi Ademit të gjithë emrat”

Thamë që kur duam ta mësojmë foshnjen të flasë, fillojmë t'ia mësojmë emrat e nuk fillojmë t'ia mësojmë ndodhitë, por, fillojmë duke i thënë ky është laps, kjo është fletore, ky është luani, kjo është gotë, kjo është rrugë, kjo është dritë, kjo është errësirë etj.

Pra, fëmijës së pari ia mësojmë emrat, e kur fillon t'i mësojë, ai është në gjendje edhe të flasë. Bile, ne ato ia mësojmë nga natyrshmeria. Fëmija nuk mëson vetëm në shkollë. Si fëmija i shkolluar, si ai i pa shkolluar do t'i mësojë emrat. Nëna e mëson fëminë të cilin nuk e dërgon në shkollë kurse mësuesi e mëson fëminë i cili shkon në shkollë, por, që të dy për të kuptuar duhet t'i mësojnë së pari emrat, e pastaj do të shohim se i shkolluari dhe ai i pa shkolluari e shprehin një fjalë që ka të njëjtin kuptim. Që të dy do ta kuptojnë fjalën rrugë ose gotë. Këtu nuk kemi dallim në mes të shkolluarit dhe të pa shkolluarit sepse këta janë fillestarë. Kjo është baza e parë që All-llahu ia mësoi Ademit a.s. e kjo pastaj u bë shtyllë e mbarë njerëzimit. Që atëherë dhe tani shohim se baza e diturisë si në shtetet e zhvilluara ashtu edhe në shtetet e pazhvilluara, janë emrat. Në

veçanti, shtetet e zhvilluara mundohen që sa më parë t'ua mësojnë fëmijëve emrtimet duke menduar se kjo është baza themelore e kuptimit të jetesës. Ata vizatojnë figura në mënyrë që fëmijët të aftësohen të kuptojnë emrat para se të mësojnë shkronjat, dhe më pas të jenë në gjendje të kuptojnë çdo gjë.

## **KUR'ANI PROGRAM JETE**

Mrekullia e Kur'anit dallon nga mrekullitë e pejgamberëve të tjerë. Nuk mund të ekzistojë ndonjë çështje që ndërlihet me njeriun e mos të jetë në programin e All-llahut të Lartësuar për ta shëruar atë. Ne themi shëron ose zgjidhë problemet, sepse ligjet bëhen për të shëruar plagët ekzistuese në një shoqëri e cila përhap ngatërresa. Kështu që edhe Kur'ani ka paraqitur shërimet e të gjitha çështjeve që ekzistojnë tek njerëzit. Ai e ka gjetur shërimin edhe pse dëgjojmë zëra, të cilët thonë se Kur'ani nuk është shërues i problemeve të reja bashkëkohore. Ky është një argument se ata nuk e kanë mësuar programin e Zotit ose nuk e kanë studjuar atë. Ne themi se nuk ka problem që ekziston në shoqëri, e Kur'ani të mos jetë shërues i tij. Ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë që Kur'anin ta njollosin me të pa qena duke thënë se Kur'ani nuk shëron çështjen e prodhimit të tepricës tokësore ose shpikjet bashkëkohore etj. Të gjithë duhet ta kenë të qartë se Kur'ani pikë së pari është program adhurimi, dhe kur ai përdoret si shërues, (udhëzues) ai nuk flet për gjëra të veçanta, por ai flet për burimin e problemit dhe atëherë ai kërkon nga ne që të hulumtojmë rreth ajeteve të All-llahut dhe të mësojmë nga kjo botë duke punuar, prodhuar, ndërtuar etj, pra, kjo është ajo e cila kërkohet nga ne. Sikur ta ndjekim këtë program, ne do të

arrinim në një përparim shumë të madh dhe të vërtetë. Pra, ajo që kërkohet nga ne është të hulumtohet, pastaj edhe të studiohet. Ai që është i tillë, është besimtar dhe e ndien Madhërinë e All-llahut, do të arrijë shumë. E para është të mbjellim, pastaj të ndërtojmë, pastaj të zbulojmë shenjat e All-llahut. Nëse nuk i përmbushim të gjitha këto dhe nuk punojmë, atëherë nuk duhet të habitemi që popujt e tjerë do të na e kalojnë në përparim. Nëse ne nuk e zbatojmë programin e All-llahut, do të na mundin të tjerët. Ky është ligj ose proces jete i programuar nga All-llahu për të gjithë. Nuk është e barabartë sikur ai që punon dhe sikur ai që nuk punon. Nuk do të ekzistonte e bukura dhe e shëmtuara, nëse nuk dallohen dhe trajtohen sipas punës së atij që është i zellshëm dhe së atij që është përtac. Ai që nuk e punon arën, nuk do të ketë sa ai i cili e lëvron ate, pastaj e mbjell, pastaj e ujit, pastaj e prashit e në fund e mbledh. Nuk do të trajtohen të barabartë personat që dallohen në punë, njëri punon në ndërtimin e qytetit e tjetri vështron anash, dhe nuk përpiqet të punojë, këta nuk do ta kenë të njejtin rezultat si dhe të njejtën ëndërr. E bukura është rezultat i punës dhe kjo është ajo që potencohet në Kur'an për këtë botë dhe botën tjetër.

Tani mund të themi se sollëm disa nga mrekullitë e Kur'anit të cilat dallohen nga ato të pejgamberëve të tjerë. Kur'ani gjithnjë është ushqyes, ai i jep një gjenerate atë që nuk ia ka dhënë gjeneratës tjetër. Kur'ani është universal, ai nuk është i kufizuar dhe nuk favorizon ndonjë popull. Ai afron zgjidhje për problemet esenciale të gjithësisë. Ai është i qartë dhe përplot përputhshmëri dhe harmoni të plotë me trurin e njeriut si në kohën kur ai zbriti ashtu edhe me të gjitha gjeneratat të tjera që e pasuan. Kur'ani i jep njohuri çdo gjenerate aq sa është e gatshme ta pranojë ajo.

Kur'ani dallon nga mrekullitë tjera sepse ky Kur'an është nën mbrojtjen e All-llahut kurse librat të tjerë nuk ishin nën mbrojtjen e Tij. Ato ishin lënë në vet kujdesin e njeriut, të cilët i ndryshuan si

dhe i devijuan ato. Kurse, Kur'ani është në kujdesin e All-llahut i cili nuk lejon të zëvendësohet ndonjë shkronjë, e lëre më të ndryshohet ndonjë fjali. Kur'ani është fjalë e All-llahut i cili shpalljen e filloi me Ademin a.s. e ai është dituria bazë për mbarë njerëzimin.

## MREKULLITË GRAMATIKORE TË KUR'ANIT

Kur'ani është fjalë e All-llahut. Përderisa është fjalë e Tij, do të jetë mrekulli, sepse Ai është ligjërues dhe ai thotë, se Atij nuk i ngjason askush. Kur'ani ishte mahnitës me retorikën e tij në kohën e zbritjes. Në atë kohë arabët ishin të dalluar në këtë shkencë. Ata nuk besonin se mund të ketë një retorikë të tillë në shkrim, ishte mrekulli e vërtetë dhe mahnitëse për ta, por, megjithatë disa nga arabët besonin se do të arrijnë edhe ata të shkruajnë me një stil të tillë. Ata u orvatën, por u penguan nga All-llahu i Lartësuar. Nga kjo nënkuptohet se Kur'ani është një nga veprat e All-llahut. Sikur të mos ishte ashtu, atëherë nuk do të pengoheshin nga All-llahu. Orvajtja e tyre bëri që Kur'ani të kuptohet se është libër i All-llahut. Por, për të mos e pranuar atë, ata thanë se forca e All-llahut po na pengon ta bëjmë një të tillë. Qëllimi i tyre ishte që të mohojnë retorikën e vet Kur'anit. Duke e mohuar atë, ata ia shtuan edhe një mrekulli Kur'anit, e kjo mrekulli ishte mrekullia e forces.

Që është mrekulli, vërehet që në fillim, sepse duhet shikuar se kush është ai që po e pranon atë. Nga vet logjika do të kuptohet, përderisa Kur'ani është fjalë e All-llahut, ai do të jetë me një

alegori dhe retorikë të pashembullt, dhe do të mbetet mrekulli. Retorika e Kur'anit do të ketë cilësi të cilat do të plotësohen me të. Retorika është të përshkruhet gjendja ose ndodhia me fjalë, vet ndodhia është protagoniste. Në këtë lloj përshkrimi Kur'ani është i mahnitshëm, në të janë mrekullitë të shumta. Problemet e njerëzve janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Kur të vendosë njeriu të përshkruaj një njeri që nuk e njeh, ai me siguri nuk do të dijë ta përshkruaj mirë. Nuk do të jetë përshkrimi i njejtë, kur një njeri do ta përshkruaj kryetarin e shtetit ose te bëj përshkrimin e një komandanti, me përshkrimin e ndonjë punëtori ose të ndonjë shërbëtori të tij. Stili i tij do të jetë i ndryshëm, sikur të përshkruajë gruan e tij dhe fëmijët të tij, do të ndryshojë për secilin që shkruan, bile do të ndryshojë sikur të shkruan edhe për të njejtin person. Ndryshimet janë aty, kur gjatë përshkrimit të personit, ndodh të jetë i nervozuar, dhe po për të njejtin, nëse shkruan më vonë, do të shohim se ka dallime të mëdha në përshkrim, sepse herën e dytë ka shkruar kur ishte i qetë. Përshkrimi i njeriut në gjendje të nervozuar ka mënyrën e vetë të përshkrimit si dhe përshkrimi i njeriut në gjendje të gëzuar ka mënyrën e vetë të përshkrimit. Kur'ani kur përshkruan një gjë është i njejtë për të gjithë, si për të pasurin ashtu edhe për të varfërin, si për të mërziturin ashtu edhe për të gëzuarin. Ai i përshkruan të gjitha gjendjet e tyre. Njeriu i mërzitur, kur dëgjon Kur'anin do të ç'mallet, do të bindet se është si për të pasurin ashtu edhe për të varfërin, si për të mërziturin ashtu edhe për të gëzueshmin. Ai është përshkruar i të gjithave dhe i përshkruan të gjitha gjendjet e tyre. Njeriu i mërzitur kur të dëgjojë Kur'anin do të çlodhet, i qetësuar kur të ndëgjon Kur'anin hyn në breditë e tij dhe i shtohet gëzimi. Nëse në të njejtën kohë e dëgjon Kur'anin kryetari i shtetit, komandantët, intelektualët, të civilizuarit ose shërbëtorët, të gjithë këta, të cilët nuk janë të një klase dhe nuk janë të barabartë në të kuptuar edhe pse është një ligjërues për ta, të gjithë këta do ta kuptojnë atë. I sheh ata në namaz,

bashkohen në xhami, ulen së bashku gjatë leximit të Kur'anit, rrënoqethen zemrat e tyre edhe pse ndryshojnë për nga mentaliteti, pozita e tyre sociale,shëndetësia etj.

Nga kjo konstatojmë se mrekullia e parë është retorika e Kur'anit. Ai është i kuptueshëm për të gjithë, edhe pse njerëzit janë të ndryshëm dhe të shumëllojshëm, rrjedhin nga shumë kombe dhe shumë kultura, nga shumë gjuhë dhe rrethe të ndryshme. Ata kur e dëgjojnë apo lexojnë, rrënoqethen. E tërë kjo ndikon në ndërgjegjen dhe shpirtin e tyre. Sikur ta pyesim dikë se çfarë është e pazakonshme në Kur'an, në të shumtën e rastit nuk do të dijnë të japin ndonjë përgjigje të shëndoshë. Secili do të japë përgjigje të ndryshme, gjë që vërteton se mrekullia e Kur'anit ka arritur në zemrat e tyre. Ata do të hamenden, sepse nuk do të jenë në gjendje të përshkruajnë cilësitë e të Përsosurit. Shihet qartë se Kur'ani i ka prekur thellë ndjenjat e njerëzve, andaj, nga kjo mund të konkludohet se kjo vepër nuk mund të bëhen nga ai i cili nuk i njeh në thelb ndjenjat e njerëzve. Sikur të jemi ata të cilët do ta kuptojmë këtë, do ta kuptonim edhe stilin e Kur'anit. Mirëpo, ne vazhdojmë të hulumtojmë rreth ajeteve të Kur'anit, të cilat kanë një retorikë të tillë. Pra, nuk do të mund të gjejmë përgjigje të shëndoshë. All-llahu është Ai që i ligjëron qenies njerëzore. Ai është Krijuesi i tyre. Të gjitha këto krijesa do të ndikohen nga fjala e All-llahut dhe do të rrënoqethen nga e njëjta fjalë, pa ndonjë dallim nga dallimet e botës ose nga dallimet të cilat kanë lindur nga vetë njeriu. Kjo, për ata që mohonin All-llahun ishte frikë, për shkak se kur dëgjonin Kur'anin, edhe pse ishin mohues, ata rrënoqetheshin si dhe besimtarët. Me kalimin e kohës, kjo ndikoi aq shumë tek ata, saqë një ditë Velid ibn Mugire, kur dëgjoji Kur'anin tha: “Në të ka kënaqësi dhe melodi, ata që e lartësojnë ndikohen kurse ata të cilët e nënçmojnë janë të rrëmbyer. Ai është fitues e nuk është asnjëherë humbës.

Kur'ani ndikonte edhe tek jobesimtarët. Kështu ndodhi edhe me Omerin r.a. kur ai hyri në shtëpinë e dhëndrit të tij, pasi u njoftua se motra dhe dhëndri kishin pranuar islamin, filloi të bëjë sherr. Kur Omeri r.a. dëgjoi disa nga ajetet e Kur'anit, filloi të qetësohet dhe u përgatit për ta pranuar islamin. Mund të shtrohet pyetja: A thua çka e shtyri atë të bëjë këtë? Ajo që e shtyri ishte vet fjala e All-llahut e cila përshkruajti gjendjen shpirtërore. Ai ishte në ate gjendje të rëndë dhe jo i vetëdijshëm, saqë filloi të bëjë sherr. Kur ju përshkruajt gjendja tjetër, pra gjendja e besimtarëve që janë në kënaqësi të plotë dhe të afërt me All-llahun, ai filloi të qetësohet dhe të pranojë të dëgjojë edhe më tepër nga jeta e besimtarëve. Këtu filloi t'i hapet gjoksi, dhe zemra t'i mbushet me besim. Ishin fjalë nga njëri, aty ishin dy gjendje shumë të kundërta mes veti, ajo që po dëgjonin ishin fjalët e All-llahut, Ai është i Gjithëdijshëm për secilin sepse është Krijuesi i tyre. Ishin fjalët e Tij që i përshtateshin të dy gjendjeve, i përshkruari sadoqë ta ndryshonte këtë gjendje, ajo do të ishte i njëjti fjalim.

Kështu pra kemi në vet qenien e njeriut disa të fshehura, të cilat nuk i di kush tjetër përpos All-llahut. Ai e përshkruan njeriun sipas gjendjes që e ka. Këto fshehtësi që gjenden në brendinë e njeriut do të ngacmohen me rënqethje ose me harmoni, ose me të dyja së bashku, duke mos e kuptuar ai atë fshehtësi.

## I THANË MAGJISTARË DHE SHPIFËS

Arritëm që deri tani të flasim vetëm për kushtin e parë të retorikës, përshkrimi me fjalë i vet situatës ose gjendjes. Kur’ani shkruan në të gjitha dispozitat ose kushtet e retorikës, sepse ai i paranjeh të gjitha pozitat ose stilet e njeriut duke i patur parasysh gjendjet e tyre. Me përfshirjen e të gjitha pozicionimeve të njeriut, fjala kishte ndikim edhe tek mohuesit e All-llahut. Ky ndikim, tek të gjithë ata që e dëgjonin dhe e kuptonin, është mrekulli. Megjithatë i thonin magjistar, po i bën magji popullit me të folur. Çfarëdo njeriu të ishte, nuk do të kishte mundur t’i përshkruante ashtu të gjitha gjendjet e ndodhive me përpikmëri të plotë. Është njëlloj sikur ta marrim shkrimtarin më të mirë të retorikës, dhe të kërkojmë nga ai të shkruajnë një kaside, pastaj, t’ia prezentojë masës atë përshkrim të gjendjes dhe ndodhinë, dhe ajo t’i kënaqë të gjithë, dijetarët, mbretërit, punëtorët, shërbëtorët etj. Ose ndonjë kaside që do ta lavdëronte mbretin, e të njejtën kaside t’ia citojë shërbëtorit të tij, ku citimi i tij do të kënaqte si mbretin ashtu edhe shërbëtorin. Në Kur’an gjenden citate të cilat përshkruajnë dijetarin dhe jodijetarin, padronin dhe punëtorin, qeveritarin dhe jo qeveritarin. Kjo ndodhë në Kur’an sepse është mrekulli, por ja që njerëzit i thonin magjistar. U themi, le të na sjellin një magji të tillë e ta shohim atë që ka ndikuar magjia, se si do të reagojë me magjistarin. Nëse supozojmë se Muhammedi s.a.v.s. ishte magjistar, ai ndikoi në një numër të personave, atëherë si nuk ndikoi tek të tjerët, por vetëm në një grup si dhe pse e luftonin ate më pas. Mohimi i tyre i vazhdueshëm dhe sulmi ndaj besimtarëve ishte argument i mjaftueshëm për ta, se ai nuk ishte magjistar. Po sikur të ishte magjistar, do të ndikonte tek të gjithë. Ai nuk do të ishte i suksesshëm në një grup e do të mos kishte sukses tek të tjerët.

Kur vërejtën se nuk kanë argumente të forta kundër kësaj thënie, e ndërruan mendimin dhe i thanë se është trillues, shpifës. U themi në momentin kur e kuptuan se ishte trillues ose shpifës pse nuk e përdornin të njejtën armë kundër tij, duke qenë se ju or mohues jeni më të shkathët për intriga dhe shpifje. Muhammedi s.a.v.s. nuk kishte dhunti në oratori sepse ai nuk dinte shkrim dhe lexim e as nuk e njihje letërsinë fare, ai ishte analfabet dhe si të shkruante poezi, kurse ata ishin mjeshtrë të letërsisë dhe retorikës. Ata ishin në dijeni të plotë se Muhammedi më parë nuk kishte shkruar ose cituar donjë poezi kurse në anën tjetër shumë nga ata ishin shumë të njohur në poezi, ata kishin dituri që nuk e kishte Muhammedi s.a.v.s. atëherë si mund ai t’ju bëjë shpifje duke qenë se ai u bë letrari më i mirë!? Pra, shpifni edhe ju si ai, përdorni të gjitha forcat së bashku dhe bëjeni që ai të heshtë. Por dëshira e All-llahut ishte që atyre t’ua mbyllë gojën me këtë mrekulli duke ju thënë:

“Dhe nuk është fjalë e ndonjë poeti, mirëpo pak janë ata që e besojnë. Dhe nuk është fjalë e ndonjë fallxhiu mirëpo pak nga ju do të përkujtoni“

Citimi i Kur’anit është shumë i qartë në krahasim me poezitë, secili njeri e kupton atë, por, duke qenë ju se i thoni atij poezi vërtetoni mohimin tuaj ndaj All-llahut. Ju jeni ata që e njihni shumë mirë poezinë dhe jeni të bindur se Kur’ani nuk është poezi dhe kur ju e injoroni Kur’anin nuk e injoroni nga injoranca juaj, por atë e bëni ngase doni ta mohoni ekzistencën e All-llahut, dhe nuk doni ta besoni ate. Pastaj, thënia e All-llahut:“...dhe nuk është fjalë e ndonjë fallxhiu”, këtu All-llahu e ka përdorur shprehjen përkujtoni. Thënja e tyre, “ai është fallxhi”, nënkupton se ai përdorë fjalë me rimë. Ai edhe do të ishte ngatëruar, sepse fallxhiu nuk do të ishte në gjendje t’i përshkruajë të gjitha detajet me një precizitet kaq të lartë, si dhe nuk do të kishte mrekulli. Sikur të ishte i tillë, Kur’ani do të humbte vlerën e tij gjatë kohës dhe do të harronte ate që e kishte

thënë dikur para disa vitesh, dhe do të citonte fjalë të kundërta me ato të mëhershmet. Për këtë shkak, All-llahu iu përgjigj atyre me thënjën: “përkujtuni” që është edhe dallim në mes gojtarit dhe poezisë. E para presupozon mrekullinë në vet brendinë e qenies njerëore, kurse e dyta presupozon, se koha e gjatë, bën që edhe fallxhiu të harrojë atë që ka thënë. Njëkohësisht, vetë qenia njerëzore është krijesë që harron pas një kohe, prandaj është përdorur thënja – *përkujtuni*, e nuk e ka përdorur thënjën po mohoni ose pabesimtarë. Është përdorur në gjendjen e parë, e ajo ishte thënia poezi, sepse poezia i ka regullat e veta të njohura.

Të shohim tani një nga mrekullitë tjera. Kur të citohet ndonjë nga fjalitë e një gojtari, pastaj dëgjojmë ndonjë shkrimtar i cili paraqet strofa nga poezitë e tij, do t’u ndiesh veten nganjëherë se shkrimtari ose cituesi po kalon nga gojtaria në poezi. Ti do të kalosh nga natyra e vet fjalës në fjalë të tjera kështu që e lë poezinë dhe kthehesh në gojtari, gjithashtu do ta kuptosh se ke kaluar nga një fjalë në tjetrën. Të shohim tani thënien e ibn Zejdunit, i cili konsiderohej nga më të mirët e asaj kohe.

Që me ditën e nesërme, çdo përfundim ka librin e vet, lavdia është për All-llahun për shumë mundësitë e shumta të Tij, nga i Cili nuk jep llogari për veprat e Tij.

Nëse çdo vepër quhet një

Veprat e Tija dalëngadalë do të bëhen njëmijë .

Këtu do të gjejmë se gjatë fjalimit është kaluar nga gojtaria në poezi me një harmoni të rrallë por megjithatë shifet dallimi. Le të shohim tani një citim të fjalëve të All-llahut:

“Vërtetë, besimtarët e devotshëm do të janë nëpër xhennete me (përplot) fontana. (Do t’u thuhet) hyni në to paqësisht duke qenë të sigurt. Dhe, Ne e eliminuam nga zemrat e tyre çfarëdo keqbërje e (kështu ata do të bëhen) vëllezër, (të gëzueshëm do të rrinë) ballë për pallë njëri– tjetrit nëpër fronet e xhennetit. Aty nuk do t’i prekë lodhja dhe kurrë nuk do të dalin prej aty (xhennetit).(O pejgamber) njoftoi robërit e Mi se vërtetë Unë jam mëkatëfalës dhe Mëshirues. Dhe vërtetë (njoftoi) se edhe ndëshkimi Im është i dhembshëm. Dhe njoftoi rreth musafirëve të Ibrahimit. Kur ata hynë tek ai e i thanë: Selam (e përshëndetën), iu tha: (Ibrahimi), ne nga ju kemi frikë”.<sup>10</sup>

Gjatë citimit të këtyrë ajeteve nuk e ndjen veten se ke kaluar nga gojëtaria në poezi si dhe anasjelltas pa e ditur atë, por ti kalove nga gojtaria në një gjë të sistemuar, pastaj nga ajo e sistemuara në gojtari (Sikur të lexohet Kur’ani në arabishtet do ta ndiesh këtë vërejtje, kjo nuk mund të hetohet në përkthim, shënim i përkthysit). Por pa asnjë dyshim, këtë nuk do të mund askush ta thotë kur të citohet fjalia: Njoftoi robërit e Mi se vërtetë Unë jam mëkatëfalës dhe Mëshirues, dhe vërtetë (*njoftoi*) se ndëshkimi Im është i dhembshëm.

Shohim veprime të cilat kërkojnë të jenë subjekte te veprave. Disa vargje nga poezia, dhe pas gjithë kësaj unë nuk e ndjeva të kisha kaluar nga gojëtaria në poezi, kurse unë kalova pastaj nga fjala e sistemuar në ate fjalë të gojëtarisë.

(Jusufit) Ajo i tha: dil para tyre (grave)! Dhe kur ato e panë, e madhëruan atë (bukuria e tij i mahnit). Ato i prenë duart dhe thanë: “All-llahut i qofshim falë” çfarë njeriu qenka! Vërtetë ky

---

<sup>10</sup> Kur’an, sure el Hixhr 45 - 52

nuk është tjetër, veçse një engjell fisnik. Ajo u tha: Ja pra, ky është ai për të cilin më qortuat mua. Unë veç e detyrova atë (për ta shfrytëzuar në marrëdhënie seksuale) por ai u ruajt dhe nuk gaboi. Po sikur të mos e bën ate që unë do ta urdhëroi ...”<sup>11</sup>

Thënia e All-llahut xh.sh. Ja pra, ky është ai për të cilin më qortuat (në gramatikën arabe) është vepër e kërkuar për subjekt, A mos e ndjeve veten që kalove në oratori? Po ashtu edhe thënia e All-llahut xh.sh. “Dhe kush dëshiron le të besojë si dhe kush dëshiron le të mos besojë” janë subjekte, si dhe thënia e All-llahut xh.sh. “Dhe All-llahu cilin të dëshirojë e udhëzon në rrugë të vërtetë”. Në të gjitha këto ajete nuk e ndien veten se ke kaluar nga poezia në oratori, sepse këtu nuk kemi fjali të cilat na befasojnë. Kur’ani pra, është një regull i veçantë më vehte, i cili rrjedhë nga All-llahu i Lartësuar, nuk mund t’i thuash oratori, as poezi, e as rimë. Retorika e Kur’anit bazohet në vet ngjarjen e cila përshkruhet nga të gjitha pozicionet. Retorika e tij është në transformimin e fjalisë, nga poezia në oratori, dhe anasjelltas, duke mos e ndier atë transformim. Retorika e tij është pikërisht aty në lëvizjen e njerëzimit. Rretorika e tij është pikërisht aty, sepse All-llahu ftoi dhe i sfidoi të gjithë maestrot e retorikës, dhe jo vetëm maestrot e qenies njerzore, por edhe të atyre të qenies së xhinëve duke ju thënë që ta përshkruajnë si të Tijën qoftë edhe një sure (kaptinë) të vetme. Pasi që u munduan një kohë shumë të gjatë dhe nuk ia arritën ta bëjnë, kjo nuk i ndaloi që të mos jenë kundërshtarë edhe më tutje. Ata nuk ia dolën sepse ftesa dhe sfida e All-llahut ishte shumë larg tyre, dhe ata nuk qenë në gjendje ta bëjnë atë. Nuk ju ngeli gjë tjetër por vetëm ta fyejnë, dhe ta përbuzin ate. Kur’ani na tregon se si i thonin atij (Muhammedit s.a.v.s.).

---

<sup>11</sup> Kur’an,sure Jusuf ajeti 31,32

“E thanë: Përse nuk i zbriti ky Kur’an një njeriu të madh prej dy qyteteve të mëdha?”

Këtu aludonin për Persinë. Xhelozia dhe mllefë që mbizotëronin tek ata i bënte që mos të përballen me Kur’anin dhe tërthorazi thonin, si është e mundur që këto vargje kaq të bukura t’i zbresin Muhammedit s.a.v.s. Për shkak të xhelozisë dhe mllefës ndaj tij, ata mohonin të vërtetën, dhe vazhdonin të qëndronin në idhujtari.

Na është e qartë se ata që jetojnë në idhujtari, dëshirojnë që sa më gjatë të vazhdojnë drejtimin e tyre, sepse jeta e tillë i bënte të fortë, dhe i bënte të kënaqur. Prandaj preferonin këtë lloj jete, dhe luteshin që sa më shumë të zgjasë për të mos e prishur qetësinë edhe pse e dinin se rruga e tij, ishte rruga e vërtetë. Por ja që mbrendia e tyre bënte pyetje që dilnin nga ata. Kështu thotë All-llahu për ta “...O All-llah, nëse ky (Kur’ani) është i vërtetë, dhe është prej Teje, atëherë lësho nga qielli gurë mbi ne...”

Pra, irealiteti ishte ajo që i bënte ata krenar. Sikur të ndodhte që instiktet ta orientonin kah e vërteta, ai nuk do të preferonte, nuk do të kënaqej me këtë. Ai kërkon nga All-llahu që t’iu lëshojë gurë nga qielli. Pra, edhe nëse bindet me realitetin, ai nuk do ta përqafojë atë, ai do të vazhdojë ta urrejë atë Kur’an. Nëse do të ndryshojë në mentalitet, ai mendon se do ta humbase famën ose forcën. Kjo e shtyn dhe e detyron atë që të vazhdojë si më parë, i kënaqur me irealen, sepse irealja i mundëson atij të jetë zotëri. Vazhdon All-llahu të na tregojë se ç’thonë mohuesit:

“Dhe ata thonë: Vërtetë, nëse e ndjekim këtë të vërtetën së bashku me ty, ne do të rrëmbehemi nga vendi ynë ...”

Ajo çka u intereson atyre, nuk është ajo se ata e mohojnë të vërtetën dhe realen, por brengosëse për ta është fama të cilën e kishin fituar nga idhujtaria (jo e vërteta). Po e pranuar, atëherë do të pasojnë migrimet dhe rrëmbimet nga vendi ynë. Dështimi i tyre nga ftesa, dhe sfida që ua bëri Kur'ani atyre, bëri që mos ta pranojnë atë nga inati.

## **Ç'KUPTIM KANË SHKRONJAT NË KUR'AN**

Sfida që iu është bërë, si dhe pozicionimi i tyre si kundërshtarë, vërtetoi se ata në brenditë e tyre besonin se Kur'ani është i vërtetë. Ata nuk kërkuan që ta sfidojnë mrekullinë e Kur'anit. Së pari lajmërimi se Muhammedi s.a.v.s. është i dërguar i All-llahut ishte mrekulli Kur'anore dhe së dyti përdorimi i shkronjave të njëjta ashtu siç i përdornin edhe ata. Diçka më gjërësisht do të them rreth këtyre dy pikave të rëndësishme.

Mrekullia në vet Muhammedin s.a.v.s.. Ai nuk dinte shkrim dhe lexim gjatë gjithë jetës së tij. Kurrë nuk mësoi letërsinë, poezinë, oratorinë as filozofinë etj. Pas gjithë kësaj, ky njeri shqipton fjalë të mrekullueshme, fjalë të cilat nuk ishin në gjendje t'i thurnin të tjerët që kishin studiuar retorikën. Formuan bindjen se nuk janë të aftë ta bëjnë një gjë të tillë dhe u dorëzuan. Mrekullia do të ndriçonte edhe më shumë atëherë kur All-llahu i Lartësuar do t'i bindë ata se këto nuk janë fjalët e Muhammedit s.a.v.s. Ato nuk mund të jenë fjalë të një analfabeti, që të mund të dijë të thurë vargje, poezi me rimë të mrekullueshme etj. Ai nuk ishte në gjendje të shkruajë edhe një

fjalë të vetme sepse nuk i dinte shkronjat. Nëse një analfabet e pyesim se çështë kjo, do të thotë se është gotë, por kur t'i kërkohet atij të shkruajë fjalën gotë, ai nuk do të jetë në gjendje ta bëjë atë sepse është analfabet. Ja pra shohim se një nga sfidat që All-llahu ua bën mohuesve, është se që ky person po shqipton fjalë të cilat i këndon në Kur'an dhe thotë :

*“Elif, Lam, mim, kaf, ha, ja, ajn, sad, (shkronja të alfabetit arab sikur të thuash a, l, m, k, h, j, s,)”*

Paraqitje e mrekullueshme nga Muhammedi, profet i cili është analfabet, nuk i njeh emërtimet e këtyre shkronjave, por, ja që sjell emra me këto shkronja duke ju treguar se këto nuk janë fjalët e tij. Ai thoshte të vërtetën, ai që nuk dinte shkrim dhe lexim gjatë tërë jetës së tij, do ta kishte të pamundur të shkruaj në këtë stil. Shqiptimi i fjalëve të tilla, duhej të kish patur autorë të cilët njihnin shkrimin dhe leximin. Pika e dytë pason në vazhdim.

## **MJESHTRIA E KRIJUESIT**

Pika e dytë, ka të bëjë me përdorimin e shkronjave që sillnin mrekullitë, ishin shkronja të njëjta si dhe të atyre që ata i përdornin. Kur'ani solli mrekullitë dhe i sfidonte. Kjo ndodhi përshkak se duhej të tregohej Mjeshtëria e Krijuesit. Ajo nuk duhej të paraqitej me ndonjë materie tjetër, aty nuk do të kishte krahasim. Nëse të intereson të dish se kush është më i miri në robaqepsi – tekstil, mos i provo ata duke ju dhënë atyre materiale të ndryshme, njërit t'i japësh stofin e mëndafshtë, tjetrit stofin e pambuktë, të tretit stofin e leshit. Kështu nuk do ta dish se cili nga këta është më i

miri, sepse rrobaqepësi që qepë mëndafsh të duket më i mirë, sepse, vetë materiali e bën atë më të dukshëm.

Mjeshtria do të tregohet në përdorimin e materialit të njëjtë. Le t'ua japin secilit stofin e mëndafshit, të pambukut ose të leshit, ashtuqë elementet e prodhimit t'i kenë nga materiali i njëjtë. Të jenë të barabartë dhe të mos ketë ndërhyrje tjetër, që të provohet mjeshtria e tyre. Dëshira e All-llahut të lartësuar ishte që mrekullia dhe retorika e Kur'anit mos të jetë në atë që nuk ishte e njohur për njerëzimin. All-llahu përdori shkronjat e njëjta, të cilat i përdornin edhe njerëzit, ato ishin nga i njëjti lloj i shkronjave që i përdornin njerëzit. Shkronjat janë shkronja, fjalët që po shqiptohen janë fjalë të njëjta të cilat edhe ju i përdorni. Fjalët të cilat janë në gjendje t'i shqiptojnë alfabetarët dhe analfabetarët, kurse ato që dëgjoheshin ishin në gjendje t'i citojnë vetëm alfabetarët. Pas gjithë kësaj All-llahu i sfidoi ata, iu tha shkronjat janë po këto shkronja, fjalitë janë po të njëjtat fjali. Por, ajo që i detyroi të heshtnin ishte vet All-llahu i Lartësuar. Nuk qenë në gjendje të sjellin një Kur'an të ngjashëm. Këtu u vërtetua se krijuesi i këtyre fjalëve nuk qenka i llojit njeri.

Kjo ishte një sfidë e madhe, ishte një dallim shumë i madh në mes fuqisë së All-llahut me atë të njeriut.

Kur flitet për retorikën, dihet se arabët janë të njohur në letërsi, retorikë dhe fonetikë. Retorika është të përmbliidhen fjalët që i përshtaten ndodhisë, për të cilën flitet, duke i respektuar rregullat dhe duke mos ndryshuar ndodhinë. Këtu rregullat kanë për qëllim të mos teprohen shkronjat në radhitje. P.sh. kur të thuash bari (që ka për qëllim barin) ose bari (që ka për qëllim bariun), fjalët duhet të lidhen ashtu sa mos të humbet theksi. Nuk duhet të kundërshtohen me rregullat e gjuhës

si dhe nuk duhet të tingëllojnë keq. Kur të plotësohen këto kondita, formulohet fjalia e cila do të jetë në harmoni të plotë me fjalët e tjera. Të gjitha këto u janë nënshtruar rregullave të gjuhës, aty nuk pranohen supozimet. Kur është shkruar rreth definicionit të retorikës, është thënë se ajo e përshkruan ndodhinë ashtu siç është, me një përshkrim të saktë dhe me një gramatikë të përsosur, me fjali të kuptueshme, të kapshme për njeriun, përshkrim që e pranon logjika e njeriut. Shihet se retorika tek njerëzimi ka vlerën e vet dhe është ekuivalente me diturinë e atij që përshkruan. Nga kjo mësojmë se ai që merret me retorikë duhet të jetë shumë i ditur. Dituria jonë është e kufizuar për ta përshkruar ndodhinë, ndërsa dituria e All-llahut është e pa kufi, dhe se retorika e Kur'anit është mrekulli e cila e përshkruan gjendjen njerëzore në tërësi. Mrekulli e cila përshkruan njerëzimin duke ia ngacmuar edhe ato instikte të cilat janë të pa njohura për ne deri më tani. Të thurrura nga shkronjat e njëjta dhe fjalitë që i përdorin analfabetarët dhe alfabetarët. All-llahu bëri ftesë dhe sfidoi njerëzimin ta bëjë një sure(kaptinë) të vetme, të ngjashme. Pastaj, bëri ftesë dhe sfidoi njerëzit dhe xhinët, sepse edhe xhinët e kanë lirinë e të menduarit sikurse edhe vetë njerëzit që të garonin me mrekullinë e Tij, në shkronja dhe emra, sepse reveluesi ishte Muhammedi s.a.v.s. i pa arsimuar, analfabet. Mrekullia e Kur'anit nuk përfundon me kaq, por ajo shtrihet edhe në përmbajtjet e fjalisë e cila është shumë precize, dhe nga kjo mrekulli, njerëzit mbesin të fascionuar.

## RETORIKA NË KUR'ANI KERIM

Nëse duam të hulumtojmë mrekullinë e Kur'anit dhe retorikën e tij, ne duhet t'i përcjellim fjalët, përmbajtjet më precize të Kur'anit. Kur Kur'ani përshkruan diçka, përshkrimi i tij është shumë preciz dhe shumë i saktë. Aty nuk do të gjesh shkronja të tepërta e as fjalë sinonime. Të pasakta janë thëniet dhe njollosjet që ia mveshin Kur'anit të shenjtë. Çështje e vërteta, mrekullitë e Kur'anit mund të gjenden në një shkronjë. Thotë All-llahu i Lartësuar: *“Thuaj: eci nëpër tokë...”*

Të ndalemi te ky ajet dhe të pyesim, pse All-llahu nuk tha *“Thuaj eci mbi tokë”* Vërtetë unë eci nëpër tokë ose mbi tokë duke llogaritur në atë për të cilën mendojnë të gjithë, ç'është e vërteta, unë eci mbi tokë, por ja që All-llahu këtu e ka përdorur fjalën nëpër e nuk e ka përdorur fjalën mbi. Por, Ai tha eci nëpër tokë. Fjala nëpër paraqet ndajfoljen që nënkupton se kuptimi shkon drejt zgjerimit. Shikuar sipërfaqësisht, përmbajtja është e mundur. Por, Kur'ani nuk mbështetet në atë. Kuptimi dhe përmbajtja e fjalisë është e plotë. Një shkronjë e ndryshon kuptimin, dhe këtu me siguri ka qëllim. Këtë ndryshim e bëri Urtësia e Tij. Ku qëndron Urtësia në këtë përdorim të fjalës nëpër në vend të fjalës mbi?

Me përparimin e shkencës, dhe kur All-llahu dëshiroi të zbulojë disa nga sekretet e gjithësisë, u vërejt se toka, pas kërkimeve dhe zbulimeve të shumta nuk qenka vetëm dhe, nuk qenka vetëm ujë, ose vetëm një rruzull tokësor. Por, toka na qenka edhe me një mbështjellës atmosferik. Tani është konstatuar se ky mbështjellës atmosferik qenka pjesë e tokës që rrotullohet me të, është i pa ndashëm dhe i domosdoshëm për të plotësuar jetën. Pa këtë, jeta do të ishte e pamundur. Këtë

mbështjellës atmosferik, Zoti ia mbështolli tokës, dhe banorët e kësaj toke i përdorën veçoritë e këtij mbështjellsi në mënyrë që tani kemi zbulime shkencore. Vërtetë, nëse hyjmë në aeroplan, ai do të ngritet lartë, së bashku me ty rreth 10 mijë metra mbi sipërfaqen e tokës. Edhe pse t'i qëndron kaq sipër mbi sipërfaqe, ti nuk thua se jam jashtë tokës. Por, do të thuash se po fluturoj nëpër tokë. Shtrohet pyetja: kur njeriu realisht dhe nga pikëpamja shkencore, largohet nga toka, dhe vërtetë del nga ky mbështjellës atmosferik i tokës? Nëse je brenda këtij mbështjellsi ti e konsideron veten në tokë e jo jashtë tokës. Mirëpo, nëse e kalon këtë mbështjellës, do të llogaritesh se je jashtë tokës. Mbështjellësi i tokës, është një pjesë përbërëse e tokës, me të plotësohet, dhe së bashku bëjnë rrotullimin.

Të kthehemi te ajeti i All-llahut. Pse pra All-llahu nuk e përdori shprehjen mbi por nëpër? Sepse, ti realisht ecën nëpër tokë e jo mbi tokë. Këtë realitet në kohën e zbritjes së Kur'anit nuk e kanë ditur. Por ja, ai që na tregoi këtë është All-llahu i cili i di të gjitha sekretet e kozmosit. Ai e di se njeriu ecën nëpër tokë, ai ecë sipër saj por, ai nuk ecën mbi tokë. Ai ecën në mes tokës dhe mbështjellsit të saj që është pjesë përbërëse e saj, në mes pjesës së gaztë dhe të ngurtë. Kështu pra, është thënie shumë precize, dhe ajo thënie varet vetëm në një shkronjë të Kur'anit. Kjo është një nga mrekullitë e Kur'anit, vetëm në një shkronjë.

## **NDRYSHIMI I DURIMIT (SABRIT)**

Se sa është e theksuar retorika në Kur'an, shihet në një shembull tjetër. Është zgjedhur fjala e cila i përgjigjet plotësisht. Aty nuk ka kurfar shtese e as sinonimi. Thotë i Lartësuari me gjuhën e Llukmanit në Kur'an, kur po e këshillonte djalin e vet:

“Dhe përballo me durim çdo fatkeqësi që del para teje. Me të vërtetë, ky (durimi) është virtyt i lartë”(Inne dhalike min azmil umur)<sup>12</sup>

Pastaj shohim ajetin tjetër ku thotë:

“Dhe kush e shprehu durimin dhe fali (fajtorin), ky gjest i tij është virtyt i lartë “<sup>13</sup>(Inne dhalike lemin azmil umur)

Njeriu mendon se kemi një lam (shkronjë e gjuhës arabe) të shtuar, ai mendon se lami këtu është përforcues, është fjalë sinonime. Kështu, me këtë mendim, ai nuk është përqëndruar shumë, por muslimani duhet të jetë preciz gjatë leximit për ta kuptuar Kur'anin. Thamë më lartë se çdo shkronjë në Kur'an është thënë me një urtësi të lartë. Në Kur'an nuk ka sinonime, sepse çdo thënie në Kur'an ka kuptimin e vet, edhe pse ato i përngjajnë njëra tjetrës nganjëherë. Sikur të thellohemi më mirë, do të shohim si më poshtë:

---

<sup>12</sup> Kur'an, sure 31 el Lukman ajeti 17

<sup>13</sup> Kur'an, sure 42 el Shura ajeti 43

Në ajetin e parë i Lartësuarit thotë: “Dhe përballo me durim çdo fatkeqësi që del para teje”. Ajo që mund ta godasë njeriun, ndodhë të dënohet ose të mos dënohet. Nëse sëmurem kjo nuk konsiderohet dënim, nëse më ndodhë ndonjë aksident duke qenë në rrugë e sipër, edhe kjo nuk konsiderohet dënim. E sikur gjatë ecjes sime nëpër rrugë, dikush më godet qëllimisht, atëherë konsiderojmë se këtu ka dënim.

Durimi (Sabri) pra na qenka dy llojesh:

Durimi shpirtëror, në të cilën nuk ka dënim, llogaritet i lehtë sepse nuk ka kush të hidhërohet tjetër. Nuk kam asgjë në dorë për tu hakmarë ndaj goditjes që pësova. Ajo që më ndodhi ishte kada (caktim) i All-llahut, para meje nuk ka gjë tjetër veçse të duroj. Ky lloj durimi nuk do shumë forcë për ta përballuar njeriu, sepse nuk ka kurfarë dënimi që të mund të hakmerret për atë që i ndodhi.

Durimi i dytë ka nevojë për një lëkurë pak sa më të trashë. Ka nevojë për një dëshirë më të fuqishme. Ky lloj durimi konsiderohet të ketë dënim dhe mund të hakmerrem. Në këtë rast është në dorën time të jam hakmarrës ose falës.

Kur All-llahu flet për një nga llojet e durimit, Ai ia jep atë që e meriton vetë ai lloj i qenies njerëzore. Kur Ai flet për durimin, në të cilën nuk ka dënim, thotë :

“Dhe përballo me durim çdo fatkeqësi që del para teje, Me të vërtetë, (durimi) është një vepër prej veprave më të zgjedhura.

Kur Ai flet për durimin në të cilën ka dënim, mund të hakmerrem dhe bëhem nervoz. Nëse nuk hakmerrem, i Lartësuarit thotë:

“Ky gjesti i tij është virtyt i lartë”

Shkronja lam është përforcues i llojit të durimit. Për atë që ka nevojë për një lëkurë të trashë ose vendosmëri më të madhe në vete. Në rastin e parë kur nuk kishte nevojë të hakmerret nga ajo që u godit, është durimi nga veprat e zgjedhura. Kurse në rastin e dytë kur ai ka mundësi të hakmerret dhe ta dënojë, i preferon atij të jetë durimtar, sepse ky lloj durimi është gjest i tij, dhe është virtyt i lartë.

Këtu nënkuptohet falja, ai që falë, sepse këtu është bërë një vepër që edhe mund të hakmerret. Aty kishte mundësi dënimi, por ja që njeriu ia fali. Kështu që Lami ishte i domosdoshëm për ta përforcuar kuptimin, dhe në të njëjtën kohë të bëjë dallimin në mes durimit të ajetit të parë dhe durimit të ajetit të dytë. Kështuqë bindemi se një shkronjë në Kur'an bën mrekullinë.

## **PËRSHKRIMI I VETË QENIES NJERËZORE**

Mrekullia nuk paraqitet vetëm në një shkronjë të vetme, por ajo paraqet mënyrën e përshkrimit të Kur'anit edhe për pasionet e vazhdueshme njerëzore. Ajo paralajmëron për një shkencë të përsosur e cila është përplot enigma. Në të ka pasione të njohura, dhe të panjohura. Psh. dëshira e All-llahut ishte që politeistat të pengohen të futen në Qabe, vendim i cili u mirëprit nga muslimanët. Shtrohet pyetja, çfarë e shtyri muslimanin që të rrënoqethet në momentin kur e dëgjoji këtë vendim, ose cili ishte motivi i rrënoqethjes. Mos vallë motivacioni i përfitimeve ekonomike!

Politeistat vinin nga të gjitha anët në Mekë, sepse ajo sillte përfitime. Në kohën kur politeistat u ndaluan të futen në Qabe, muslimanët ishin pakicë në krahasim me botën. Ndalimi i futjes në Qabe dhe prezentimi i tyre në Mekë do të kishte humbje materiale. Instinkti ekonomik në mbrendinë e njeriut po dridhej, i rënqethej trupi, por, mos të harojmë se All-llahu është Ai i cili krijoi qenien njerëzore, Ai e di këtë. Në momentin kur zbriti ky ajet, le të mos i cungojmë në këtë përshkrim edhe thënjet vepra ose mos vepra ose llojet e urdhëresave ose rrugën e programit për jetën, por madhështia e gjithë kësaj është në mëshirën e All-llahut. Ajeti përshkruan pasionet dhe instinktet njerëzore të cilat ngacmojnë dhe ndikojnë në sferën e ekonomisë, dhe kur i Lartësuarit thotë :

“Vërtetë, politeistat janë të ndyrë (në mendje). Dhe mos të afrohen në Qabe pas këtij viti ”<sup>14</sup>

Më pas, në të njëjtin ajet i drejtohet instinktit ekonomik. I flet këtij instinkti para se të bëhej pyetja nga cilido qoftë që e vlerësonte këtë si dëm të madh ekonomik, dhe me këtë vështirësohej jeta, duke thënë:

“Dhe nëse i frikësoheni skamjes, All-llahu në dashtë, do t’ju pasurojë nga mirësitë e Tij”

I njëjti ajet i jep një përkujdesje ndaj instinktit ekonomik, ngase ai do të frikohet dhe do të ngushtohet pas urdhërit, të veprojnë e të mos frikësohen nga varfëria sepse i Lartësuarit është më i pasuri dhe më dorëgjërë dhe Ai do t’i pasurojë nga mirësitë e Tij.

---

<sup>14</sup> Kur’an, sure 9 el Toube ajeti 28

Ky instinkt ekonomik që jeton në brendinë njerëzore sikur po tërbohohet edhe sot. Në shumë sfera të jetës së përditshme ai frikësohet. Kur All-llahu të thotë bëje këtë, ose mos u merr me atë, ai spontanisht do të pyes vetveten, e përfitimet që i kam nga kjo?! Nga do ta kompenzoj atë ? Këtu All-llahu të thotë: “Kupto se Unë do ta kompenzoj atë sipas mënyrës Sime. Përderisa risku është në Mbretërinë Time, atëherë Unë do t’ua lehtësoj atë nëse dëshiroj. Ti mos u frikëso nga varfëria, se riskun tënd nuk do ta merr kush tjetër përpos teje.

## **AI MË USHQEN DHE MË JEP PËR TË PIRË**

All-llahu xh.sh. në Kur’ani Kerim gjithnjë është në vigjilje të instikteve njerëzore, është shumë preciz kur përgjigjet me retorikën e Tij. Jep më shumë se një kuptim, shpeshherë e shohim të ndryshojë fjala në fjali. Përderisa këto fjalë janë prezente në fjali, ato ndryshojnë në kuptim ose nënkuptojnë diçka të re, ky është një precizitet i paramenduar. Në Kur’an të tilla raste kemi shumë p.sh. Ibrahim i a.s. thotë :

“Dhe të gjithë ata janë armiq të e mi përveç Zotit të botrave, i cili më krijoi mua dhe Ai do të më përuddhë”<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Kur’an, sure 26 el Shu’ara, ajeti 77

Të ndalemi pak këtu, pse Ibrahim i a.s nuk tha, se Ai i cili më krijoi mua dhe Ai do të më përdhë; por tha: “I cili më krijoi mua dhe Ai do të më përdhë” sepse, krijimi nuk ka nevojë për vërtetësi, përforçues (në gramatikë – përkth.). Njeriu sado të rritet, qoftë edhe sundues i botës, ai nuk do të thotë se është në gjendje të krijojë njeri. Nëse gjendet një i tillë, atëherë do të kërkohet që ta bëjë atë, e ai me siguri nuk do të jetë i aftë t’i përgjigjet kërkesës. Pra, Krijuesi nuk ka rival dhe për Atë nuk ka nevojë për përforçues në fjali. Kurse, përdhës janë me mijëra në botë të cilët ftojnë njerëzimin në përdhje. Kemi nga ata që programet e tyre ia bashkangjesin fesë, disa të tjerë paraqesin programe kundër fesë. Sido që të jetë, të gjithë ftojnë njerëzimin me programet e tyre në përdhje. Secili program i tyre ka mënyrën e trajtimit të tij, dhe thotë, se kjo është përdhje. Nga gjithë kjo ishte e domosdoshme që të saktësohet përdhja. Këtu Ibrahim i a.s. e saktëson përdhjen me këtë përforçues duke u shprehur, se Ai është All-llahu, dhe e vërteta është në këtë rrugë. Ky përemër vetor i cili përforçoi përdhjen, ishte i domosdoshëm. Në fjalinë e parë, nuk kishte nevojë për këtë përemër vetor, sepse krijimi është një nga cilësitë e All-llahut. Ai nuk ka rival në të, kurse, tek të tjetrat ka nevojë dhe ishte i domosdoshëm përemri vetor Ai, pastaj kemi thënjen:

“Dhe Ai i cili më ushqen mua dhe më jep për të pirë”<sup>16</sup>

Njeriu duhet të fitojë për t’u ushqyer dhe për të pirë. Ka shumë thënie për riskun (furnizim). Për arsye të këtyre shumë thënieve, All-llahu xh.sh. tha, ***dhe Ai i cili më ushqen dhe më jep për të pirë***. Në një ajet tjetër thotë :

---

<sup>16</sup> Kur’an, sure 26 el Shu’ara, ajeti 79

“Dhe kur të sëmurem unë, Ai më shëron”<sup>17</sup>

Kur ne jemi nën përkujdesjen dhe kurimin e mjekut, harrojmë plotësisht dëshirën e All-llahut. Tani kemi rastin të shohim fjalinë që nuk është futur përemri vetor Ai. Thotë i Lartësuar: “Dhe i Cili më bën të vdes pastaj më ringjall”<sup>18</sup>

Këtu nuk është përemri, Ai më bën të vdes pastaj Ai më ringjallë. Kjo është ngase All-llahu nuk ka rival në marrje dhe dhënie të shpirtit. Kështu që për Vetën e Tij, përemri vetorë është i pa bazë, nuk i përshtatet fjalisë.

Shohim, se si All-llahu i Lartësuar, dikund e përdorë e dikund tjetër nuk e përdorë përemrin vetorë. Kjo tregon se Kur’ani është shumë preciz dhe ka përskrim të shkurtër dhe të qartë, ngase vendi e kërkon ashtu. Të përdoshin ose jo këta përemra vetorë, nuk do të kishin ndonjë rëndësi të veçantë ndër njerëz. Nuk do të ishin gabime të cilat do të vëreheshin, por ja që këto janë fjalë të All-llahut e Ai nuk lejon t’i gjendet edhe një gabim i vetëm.

---

<sup>17</sup> Kur’an, sure 26 el Shu’ara, ajeti 80

<sup>18</sup> Kur’an, sure 26 el Shu’ara, ajeti 81

## PSE NDODHIN NDRYSHIMET

Ngase kemi të bëjmë me një përshkrim shumë preciz, ndodhin ndryshime në shkronjë e cila pëson ndryshime në çdo fjalë, dhe ndodhë që edhe në vetë fjalinë p.sh. Iu dhamë për të pirë, do t'iu japim për të pirë, janë në shumë vende të përsëritura.

“...Dhe Zoti i tyre do t'iu japë të pijnë pije të pastërta.”

Kurse ajeti tjetër thotë :

“ (O Pejgamber) Sikur t'i përmbaheshin (banorët e Mekkes) rrugës së drejtë, Ne do t'iu lëshonim ujë me bollëk.”

Pse nuk ka thënë: Sikur t'i përmbaheshin rrugës së drejtë , Ne do t'ju lëshonim ujë me bollëk. Fjala në arabishten seka është e të njejtit kuptim eska, që të dyja shprehje janë të një veprimtarie, por ku është dallimi në mes tyre. A mund të jenë vetëm sinonime ose kanë një ndryshim derisa të mos përsëritet kuptimi. Kemi thënë se çdo ndryshim shkronje ka Urtësinë e vet, çdo ndryshim përkufizon ndryshimin e kuptimit dhe shohim se fjala seka përdoret gjithnjë në mënyrën urdhërore e cila nuk ka ngarkesë e as ndihmesë, kurse eska është në urdhërore, por me vete e ka ngarkesën dhe ndihmesën. Kështu është në këtë botë.

“ ...Ne do t'iu lëshojmë ujë me bollëk “

Ky lloj urdhëri ka ngarkesë dhe mund. Ne gjetëm për ta ujë, dhe e bëmë të bollshëm pa ndonjë mund dhe lodhje, ai është nëpër puse. Për ta hequr etjen, patjetër do të shkojë ta nxjerë ujin nga

pusi, ose t'ia sjellë ndonjë njeri tjetër. Këtë kuptim e ka eska, edhe pse uji është nga All-llahu, është i bollshëm nga mundësitë e All-llahut të Lartësuar. Fjala e All-llahut Seka

“Dhe Zoti i tyre do t’u japë të pijnë pije të pastërta”

Kjo është në xhennet. Aty nuk ka kurrëfarë ngarkese. Nëse ndjen etje, ujin e ke para gojës tënde. Në xhennet nuk ka ngatërresa, ngarkesa, kurrëfarë mundimi e as kurrëfarë pune. Në xhennet ajo që nevojitet dhe i kujtohet do ta ketë para vetes.

All-llahu i Lartësuar, e ka dalluar me një shkronjë fjalinë e cila e ka të njejtin kuptim, dhe është nga e njehta materje, por fjala e parë ka të bëjë me xhennetin, kurse e dyta me këtë botë.

## **E DINË E KUPTOJNË**

Gjatë leximit të Kur’anit shohim, se i Lartësuari ka përdorur shprehje identike, nuk e ka përdorur të njejtën shprehje. Gjatë leximit ose dëgjimit të ajetit, mendon se do të pasojë ajo shprehje dhe vazhdon të jesh në pritje të asaj shprehje, por jo, ajo nuk ndodh. All-llahu thotë :

“... Po sikur edhe të parët e tyre të ishin nga ata që nuk dinin asgjë dhe as që ishin të përudhur”

Si dhe thënia e All-llahut xh.sh. :

“... Po sikur edhe të parët e tyre të ishin nga ata që nuk kuptonin asgjë dhe as që ishin të përudhur”

Pse të ndryshojë në fjalë, duke qenë, se të diturit dhe kuptimi kanë një kuptim. Themi se këtu kemi një dallim shumë të madh, në përdorimin e fjalës, të dini dhe të kuptoni. Ti shohim këto dy ajete se si fillojnë fjalinë dhe si ato plotësohet.

“Dhe kur u thuhet atyre, ndiqni atë që All-llahu e ka zbritur (Kur’anin), ata thanë, Jo, ne do ta ndjekim atë rrugë të cilën e ndiqnin të parët tanë. Po sikur edhe ata të parët e tyre të ishin nga ata që nuk kuptonin asgjë dhe as që ishin të përudhur. Shembulli i mosbesimtarëve është si shembulli i atij që thëret atë që nuk dëgjon gjë pos thirrjes e britmës. Ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër, prandaj nuk kuptojnë”<sup>19</sup>

“Dhe kur u thuhet atyre, ejani tek ajo që e zbriti All-llahu dhe tek peygamberi, ata thanë: Na mjafton neve ajo që e kemi gjetur tek të parët tanë. Po sikur edhe të parët e tyre të ishin nga ata që nuk dinin asgjë dhe as që ishin të përudhur. O ju besimtarë! Keni kujdes ndaj vetëvetes. Nuk do t’ju dëmtojë juve askush prej të humburve nëse përudheni. Tek All-llahu do të ktheheni ju të gjithë, atëherë Ai do t’ju informojë rreth asaj që bëni ju”<sup>20</sup>

Orientalistët thonë se këtu kemi të bëjmë vetëm me sinonim e asgjë tjetër. Dija, kuptimi, kuptimi dhe dija janë një. I ditur është ai i cili mëson ose mund ta dijë dijen, thonë sinonim! Ç’tu themi këtyre orientalistëve? Do të thosha se nuk e kuptojnë retorikën e Kur’anit. All-llahu nuk i përdorë dy fjalë për të njejtën gjë ose kuptim. Çdo fjalë e ka kuptimin e vet dhe është përkthyer me një precizitet të madh. Kur All-llahu xh .sh. thotë (*la Jaekilun – nuk kuptojnë*) ka kuptim se ata nuk

---

<sup>19</sup> Kur’an, sure 2 el Bekare, ajeti 170-171

<sup>20</sup> Kur’an, sure 5 el Maide ajeti 104-105

kuptojnë asgjë, ata nuk kanë mendje (kokë)për ta kuptuar, ata nuk paramendojnë çështjet e kësaj gjithësie. Ata nuk i përdorin mendjet e tyre. Sikur t'i përdorin do të kuptonin dhe do të shpresonin se kanë arritur tek njohja se All-llahu është krijues. Ky precizitet kaq i madh i kësaj gjithësie nuk do të ishte rastësisht por krijues i kësaj është All-llahu, kaq për sa i përket fjalës kuptojnë. Nga kjo nënkuptohet se ishin mohuar çështjet e fesë dhe të vasionit.

Por kur All-llahu xh.sh. thotë (La Jealemune-nuk dinë) thujase iu ka ndaluar atyre të menduarit ose diturinë. Kjo kuptohet kështu, sikur të isha një hulumtues i këtij kozmosi do të shpresoja në të, me një mençuri për të ditur çështje përreth meje dhe do të mendoja në kokë derisa të arrija në një rezultat. Ky është njeri i cili mendon kurse thënja e All-llahut (*la jealemune – nuk dinë*) Ai do të thotë: Ata janë pranë mos përceptimit të drejtë të kozmosit, ata nuk po i kuptojnë shenjat të cilat i kanë dhe, ata nuk po kuptojnë se ka dije jashta dijes së tyre. Pra ai i cili nuk di nuk ka se si të përceptojë ai nuk ka koncept dhe, nuk do të mendojë në shenjat e gjithësisë. Kurse, ai i cili nuk di nuk mund të mendojë me mendjen e vet. Nuk do të dijë ate çka dinë të tjerët, ai nuk ka njohuri. Nuk ka dituri nga rezultatet e diturisë së tjetrit. Dija është më përfshirëse se dituria. Dituria mund të jetë dituri e tjetrit e shkruar ose xhiruar. Unë do të jam në cilësinë e marrësit të asaj diturie, e lexoj ate pastaj mësoj çka dinin të tjerët. Kjo na ngjet ne çdo ditë. Kur ne lexojmë një libër marrim dije nga mendimi i tjetrit. Kur ne shkojmë në universitet mësojmë ate që e kanë mësuar profesorët dhe dijetarët e mëdhenj. Unë nuk e di gravitacionin ose regullat e astronomisë, sepse nuk kam punuar me dijen time në to. Por e mësova nga dijetarët e astronomisë po ashtu edhe gravitacionin e mësova nga ata mendimtarë që kanë menduar për të, e unë e morra të gatshme nga ata. Kur All-llahu thotë – ata nuk kuptojnë , në ajetin e parë dmth.ata nuk kuptojnë duke përdorur mendjet e tyre sepse ata thanë “Ne do të ndjekim atë rrugë të cilën e ndoqën të parët

tanë” Prandaj All-llahu i ktheu përgjigjen atyre, “Po sikur edhe të parët e tyre të ishin nga ata që nuk kuptonin asgjë dhe as që ishin të përudhur”.

Të tillët i cilësoi Zoti: Ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër, prandaj nuk kuptojnë. “

Ata nuk dëgjojnë, nuk shohin dhe nuk flasin me shenjat e All-llahut ky është shkaku pse ata nuk kuptojnë.

Shkaku se ata nuk dinë është përgjigje ndaj mohuesve të fesë, të cilët thanë ata: Na mjafton neve kështu si i kemi gjetur të parët tanë.

Këta kështu duan të tregojnë se ne nuk duam asgjë dhe as dituri, neve na mjafton ajo dituri e të parëve tanë, e All-llahu u përgjigjet atyre: “Po sikur edhe të parët e tyre ishin nga ata që nuk dinin asgjë dhe as që ishin të përudhur”.

Sepse ata nuk e mësuan dijen me kokën e tyre si dhe e refuzuan dijen e cila ju vinte nga të tjerët. Ky pra , është dallimi në mes fjalës nuk dijnë dhe nuk kuptojnë.

## **JU FURNIZOJMË DHE I FURNIZOJMË**

Retorikën e Kur’anit të madhëruar e dëshmojnë edhe ajete të tjera, në të cilat i Lartësuarit me një precizitet të lartë vërteton atë se është mrekulli e vazhdueshme dhe e pa shterur. Një mendje e

cila nuk thellohet aspak do të mendojë se ajetet edhe pse kanë një ndryshim të vogël ato janë të ngjajshme dhe kanë një kuptim. Kemi të bëjmë me fjali të një radhitjeje, e një kuptimi por ndryshimi qëndron në të shprehurit, dallimi gjendet në një fjalë e cila vërteton mrekullinë e Kur'anit. Kur'ani është shumë preciz dhe nuk ka rastësi në te por, shprehjet janë të zgjedhura.

Të shohim kuptimin e tyre që shumë nga njerëzit nuk i analizojnë ndryshimet. Varrimi i vajzave për së gjalli ishte një realitet i natyrshëm në kohën e injorancës. Me ardhjen e Islamit filloi të ndryshojë mentaliteti njerëzorë në përgjithësi. All-llahu i Lartësuar thotë:

“...dhe mos i mbytni fëmijët tuaj (nga frika) prej varfërisë – Jemi Ne që ju ushqejmë juve dhe ata ...”<sup>21</sup>

Ky ishte një ajet për varfërinë dhe mbytjen e fëmijëve, tani të shohim ajetin tjetër :

“Dhe mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë . Jemi Ne që i ushqejmë ata dhe juve ...”<sup>22</sup>

Ajeti i parë ishte Jemi Ne që ju ushqejmë juve dhe ata, kurse ajeti dytë është Jemi Ne që i ushqejmë ata dhe juve .

Do të pyesim ku është dallimi? Ajeti i parë thotë: mos i mbytni fëmijët tuaj nga varfëria. Varfëria vërtetë ekzistonte. Fjala *el imlak* në arabishte nënkupton varfërinë ekzistuese prandaj All-llahu i Lartësuar tha jemi Ne ata që ju furnizojmë juve dhe ata, sepse varfëria ishte prezente. Në këso kohërash njeriu është shumë i preokupuar me gjetjen e furnizimit. Logjikisht gjendja e tillë të çon

---

<sup>21</sup> Kur'an, sure 6 el Nisa, ajeti 151

<sup>22</sup> Kur'an, sure 17 el Isra, ajeti 31

të mendosh, se njeriu, së pari do të mendojë të gjejë ushqim për vete, e pastaj për fëmijët. Prioritet për mashkullin është që të kujdeset për vete dhe gruan e tij. Prandaj, All-llahu prioritet i dha fjalës juve kundrejt fjalës ata, : Jemi Ne që ju furnizojmë juve dhe ata, All-llahu së pari i siguroi prindërit, sepse ishin të preokupuar në të, e pastaj i siguron edhe për fëmijët e tyre, duke ju thënë, se ti je i varfër dhe i preokupuar për riskun tënd dhe frikohesh, se mos po lindin fëmijë, e ti nuk ke se me çka të kujdesesh për ta, kurse, Unë të them ty se, Unë Jam Ai që furnizoj, ti ke riskun tënd e ata të vetin, nuk mirret asgjë nga risku yt. Ajeti i dytë është:

“Dhe mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë. Jemi Ne që i ushqejmë ata dhe juve.”

Në këtë rast, njeriu nuk është i preokupuar me gjetjen e riskut, ai nuk frikësohet nga risku, ai ka pasuri të mjaftueshme, por frika e tij është nëse i lindë fëmija, mos po varfërohet. Ky njeri e paramendon këtë fëmijë se po ndikon në pjesën e riskut të tij. Logjika e tij e detyron atë të mendojë, se risku i tij, do të pakësohet, kurse për fëmijën do të mjaftonte. Kjo e detyron këtë njeri të mos ketë fëmijë. Pra, risku qenka shkak, që ky të vepron ashtu. Mendon se fëmija po merr pjesën e tij, dhe kështu do të keqësohet gjendja e tij materiale, prandaj, All-llahu i Lartësuar thotë: “Jemi Ne që i furnizojmë ata dhe juve”. Ajeti i parë kishte të bëjë me frikën e riskut që nuk i mjaftonte një çifti, kurse, çifti tjetër kishte jetë të mirë, por kishte frikë në varfërinë me ardhjen e fëmijëve në atë familje. Ky ndryshim i fjalëve në të dy ajetet ishte i domosdoshëm, sepse kemi të bëjmë me përshkruesin e fjalive më të përsosura.

Pse All-llahu tha Jemi Ne që ju ushqejmë juve dhe ata si dhe Jemi Ne që i ushqejmë ata dhe juve, e pse nuk tha: Ne ju ushqejmë juve të gjithëve. Qëllimi është, sepse All-llahu dëshiroi të na tregojë, se secili njeri e ka ushqimin e vet të pa mvarur nga tjetri. Këtë risk, të cilin e ka veçuar

All-llahu për një njeri, nuk mund t'ia merr tjetri. Pra, fëmija nuk ia merr riskun babait si dhe as babai nuk merr riskun e fëmijës. Le të jetë e qartë, se rrisku nuk ndahet në mes prindërve dhe fëmijëve, dhe me mbytjen e fëmijës nuk shtohet risku asnjëherë.

## TI JE I PLOTFUQISHËM

Të shohim ajetin Kur'anor:

“... O Isa, biri i Merjemes, a ti u the njerëzve: Më merrni mua dhe nënën time si dy zotra, pos All-llahut?! (Isau) tha: Lartëmadhëri, nuk kisha pse t'a them një gjë që s'kam të drejtë. Po ta kisha thënë këtë, Ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, mirëpo unë nuk e di ç'ka në Ty. Pa dyshim, Vetëm Ti i di fshehtësitë (e së padukshmes)”<sup>23</sup>

Më pas thotë Isau i biri Merjemes :

“Nëse i dënon Ti, ata janë robërit e Tu; po nëse i falë ata, Ti me të vërtetë, je i Plotëfuqishëm dhe i Urtë.”

Pra Isau i biri i Merjemes po i thotë: Nëse i dënon Ti, ata janë robërit e Tu.

Kjo është një theks i veçantë, ne të gjithë jemi robërit e All-llahut të bindur dëshirës dhe caktimit të Tij. Pastaj vazhdon Isau a.s. t'i thotë: Po nëse i falë ata, kjo është ajo që secili njeri e ëndërron

---

<sup>23</sup> Kur'an, sure 6 el Enam, ajeti 116

mëshirën dhe faljen e All-llahut të Lartësuar. Por këtu thotë edhe: Po nëse i falë ata, Ti me të vërtetë je i Plotëfuqishëm dhe i Urtë. Pse nuk i tha Ti je Falës dhe Mëshirues, këtu është për tu falur. Pse t'i thuhet i Plotëfuqishëm në vend se ti thuhet Ti je Falës. Disa edhe mund të thonë se përmbajtja nuk i përshtatet. Do të ishte përmbajtje e përshtatshme sikur të ishte Ti, je Falës dhe Mëshirues. Sikur të ishte kështu, mund të themi se nuk do të kuptohej mrekullia e Kur'anit. Thënia e të birit të Merjemes: Po nëse i fal ata, përmban në vete të njejtin kuptim Ti je Falës, se sikur të mos ishte Falës si do të Falte. Kurse tek shprehja. Po nëse i fal ata, Ti, me të vërtetë, je i Plotëfuqishëm dhe i Urtë, pse u përdorën: i Plotëfuqishëm dhe i Urtë. A është përfunduar fjalia duke mos e patur të qartë mendja e njeriut?

Fjalia është përfunduar në mënyrë më të përsosur, duke u kërkuar Falja. Ai e lut All-llahun për t'i falur ata duke i thënë, “ Po nëse i fal ata” Ti me të vërtetë je i Plotëfuqishëm. Pra, All-llahu është Ai i cili nuk merret në pyetje nga askush për t'i dhënë llogari askujt. Askush nuk do t'i thotë All-llahut pse këta i fale përderisa kanë gabuar, për arsye se, Ai është i Plotëfuqishëm, nuk i jep askujt llogari, nuk ka asgjë mbi forcën e Tij. O Zoti ynë, nëse dëshira Jote është për t'i falur, atë e bën nga mëshira Jote, dhe Ti je i Plotëfuqishëm dhe mëshirues. Ai mundet, sepse është i Plotëfuqishëm dhe mund ta bëjë atë pa pyetur askënd. Urtësia e Tij rrjedh nga plotësimi i përkryer i cilësisë së Tij të Urtë.

Nga kjo shohim se fjala është vënë me një Urtësi të madhe në të kërkuarit falje. Kërkesë e tepërt e faljes. O Zot, fali ata, sepse Ti je i Plotëfuqishëm, nuk të merr në pyetje askush dhe askush nuk të dënon. Kështu, ne përqëndrohemi në dy çështje: sepse, Ti je Falës dhe Mëshirues sikurse që Je i Plotëfuqishëm dhe i Urtë. Falës që falë njerëzit që bëjnë gabime. Je i Plotëfuqishëm ngase mund

të falësh atë që dëshiron, pa ndonjë kusht dhe pa i dhënë llogari askujt, askush nuk të pengon dhe askush nuk të pyet. Ti ke mundësi të falë sado dhe sidoqofshin ata.

## **DËMTUES I VETES DHE KEQBËRËS**

Të shohim një nga ajetet tjera:

“Dhe ata, të cilët kur bëjnë ndonjë vepër të shëmtuar ose i bëjnë dëm vetes së tyre”.<sup>24</sup> dhe thënia e Tij:

“Dhe kush bën ndonjë të keqe apo e dëmton veten”<sup>25</sup>

Dikush edhe mund të pyesë, a nuk është shprehja vepër e keqe ose e shëmtuar, e njejtë me atë, dëmtuesin. Ai i cili dëmton veten, i obligohet dënimi. Si dhe ai i cili bën vepra të shëmtuara, i obligohet dënimi i njejtë, disa edhe thonë, se lidhori është i pa rëndësishëm.

Jo, ajo është një precizitet i lartë. Fjali precize, nga thënësi preciz, All-llahu i Lartësuar na jep një mrekulli tjetër në Kur’an, duke na bërë të qartë se ka dallim të madh mes fjalës vepër e shëmtuar nga dëmtuesi i vetvetes. Ku është dallimi ?

---

<sup>24</sup> Kur’an sure 3 Ali Umran, ajeti 135

<sup>25</sup> Kur’an, sure 4 el Nisa , ajeti 110

Ai i cili bën vepër të keqe ose të shëmtuar e, bën atë për një moment të shpejtë sa për të realizuar qëllimin. Qenie e dobët, i vlon gjaku dhe i nëntshrohet momentit të paraqitur. Njeriu që pi alkool, plotësoi dëshirën për ta shijuar atë. Njeriu zinaqarë<sup>26</sup> realizon një dëshirë të momentit, për ta shuar epshin. Njeriu hajdut, realizoi dëshirën e tij të momentit për tu kënaqur me një pasuri. Ky është njeriu i cili bën vepër të keqe ose të shëmtuar. Njeriu i cili dëmton veten është njeri krejtësisht tjetër. Ai e bën gabimin dhe nuk merr mësim nga ai gabim. Ate nuk e ngacmoi momenti, sepse ai është duke vazhduar të dëmtojë veten e nuk ka se si t'i shpëtojë ahiretit (dënimin në botën tjetër).

Dikush edhe e ndjek fenë për këtë botë, dikush edhe e ndjek për të tjerët. Ai që e ndjek fenë në këtë botë, ai kërkon kënaqësitë e momentit. Kurse ai që ndjek fenë për të tretin, ai nuk kënaqet në këtë dhe atë botë. Ky është ai që e dëmton veten. Si është e mundur që njeriu ta dëmtojë veten. Njeriu i cili dëshmon rrejshëm për t'i kënaqur të tjerët, nuk përfiton për vete asgjë, bile e dëmton veten. Dëshmia e rreme është ta bësh një mëkat me të cilën nuk ke kurrëfarë dobie në këtë botë, por nëse fiton nga ajo dëshmi e rreme, atëherë realizon diçka nga dobitë e kësaj bote. Ai që dëmton veten është ai i cili i kënaq të tjerët. Nga ky lloj njerëzish kemi shumë në botë.

Ai i cili e akuzon tjetrin me një akuzë të pa bazë, ai nuk përfiton asgjë vetëm se ka bërë një mëkat, e me këtë, ai e dëmton veten. Ndodh që njeriu bën deklaratë të rreme me shkrim ose me gojë, ose pa kërkuar kush nga ai, flet me hamendje, gjë që ate e dëmton shumë. Mund që edhe të dënohet pas deklaratës së tij me burgim, ose persekutim, ose spiunon dhe akuzon me një të pa qenë nga hakmarja ndaj tjetrit etj. Të gjithë këta kanë dëmtuar veten, sespse ata kanë bërë mëkat në këtë

---

<sup>26</sup> Zinaqarë, mardhënie seksuale në mes femrës dhe mashkullit në mënyrë të pa ligjshme.

botë, dëmtues të vetes të cilët nuk prosperojnë këtu, në këtë botë, e lëre më në ahiret<sup>27</sup>. Mbase kjo vepër e tyre që i dëmtoi ata, do të bëjë që të dënohen në xhehennem sepse ajo e shtyri të bëjnë mëkat dhe në të njëjtën kohë, nuk përfituan absolutisht asgjë në këtë botë dhe botën tjetër. Ky është dallimi në mes të dy fjalive. Nuk janë sinonime por precizitet i rrallë në përshkrim.

## **DRITA DHE TERRI**

Kur’ani është i tëri me përmbajtje fjalish të sakta dhe precize. All-llahu i Lartësuar kur e përdor fjalën dritë dhe terr, në Kur’an thotë dritë dhe thotë terr dhe thotë errësira, por, asnjëherë nuk thotë dritat. Kemi dritë dhe terr, kemi dritë dhe errësira, por, nuk kemi hasur të ketë thënë (dritat). Ai i nxjerrë njerëzit “Nga errësitat në dritë”

Pra, i nxjerr në dritë, e jo në drita, a thua pse? Do të ishte e logjikshme dhe gjuhësisht në regull sikur të thoshte i nxjerrë njerëzit nga terret në drita. Ju themi atyre se duhet logjikuar mirë dhe saktë. Në këtë botë kemi errësira të shumta, por nuk kemi shumë drita. Është një dritë e ajo dritë është drita e All-llahut të Lartësuar, Dritë e Vërtetë. Për këtë arsye All-llahu nuk e përdor ndryshe fjalën dritë, sepse është një dritë e vërtetë dhe nuk ka dritë tjetër.

Secili njeri ka vizionin e vet. Secili vizion është erresirë. Terri i dikujt nuk është i njëjtë me terrin e tjetrit. Shpesh ndodhë, që njeriu të jetë rob i këtyre vizioneve. Vizionet janë relative, ato

---

<sup>27</sup> Ahiret, bota tjetër e amshimit

shkaktojnë përplasje. Ndodhë të ketë vrasje, vjedhje ose paragjykime të ndryshme si dhe shumë shkaqe të cilat shkaktojnë përplasjet në çdo vend.

Nga këto errësira, secili terr ndryshon nga tjetri. Njëri presupozon diçka, kurse tjetri e refuzon. Njëri ka ambicje për të realizuar diçka, kurse tjetri paraqet ambicjet e veta. Secili njeri dëshiron të marrë atë që nuk e meriton. Secili njeri flet atë që mendon se është e vërtetë dhe e drejtë sipas tij. Dikush thotë, se komunizmi është rruga e vetme, tjetri mendon kapitalizmin, një tjetër thotë, socializmi e kështu me radhë. Të gjitha këto thënie, prapa vetes mbajnë ambicjet njerëzore, me të cilën njerëzit mendojnë se do t'ia arrijnë qëllimit. Të bëhen të dallueshëm, disi të veçantë në këtë rruzull toksor. Lejojnë të kenë pasuri të pa ligjshme, kurse të tjerëve ua ndalojnë gjërat, të cilat All-llahu ua ka dhënë atyre si: pasuria, pozita në shoqëri, ose qeverisje etj.

Kështu pra, paskemi shumë errësira, secili njeri ka të menduarit e vet. Pa dyshim, All-llahu ekziston dhe Ky është i vetmi që e dha dritën për të mundur njeriu të jetojë një jetë të qetë dhe të pëlqyeshme. Këtë program të jetës e ka skicuar i Lartësuar i Kur'an. Nëse largohemi nga ky program i All-llahut, atëherë do të hasim në errësira. Pra është All-llahu, Ai i cili na nxjerrë nga errësira në një dritë, ajo dritë është drita e All-llahut, ajo është rruga e vetme dhe e vërtetë.

Kur All-llahu e përdorë fjalën errësira, ka për qëllim pasionet e mendjeve të njerëzve e ato janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Kur Ai thotë dritë, Ai ka për qëllim programin e Tij, rrugën ose fenë e Tij. Nëse na parapëlqen, nuk kundërshtojmë, aty nuk kemi çka të kritikojmë sepse është një e mirë e përbashkët, dëshira e secilit është e bukura dhe punët do të jenë të mira për secilin. Aty nuk mund të ketë kritikë, kritikën i përkasin ideologjive njerëzore. Kjo ishte diçka rreth mospërdorimit të fjalës: dritat nga ana e All-llahut, dhe përdorimi i fjalës errësirat nga ana e Tij.

Këto janë disa nga shembujt shumë të thjeshtë. Kur’ani është përplot mrekullira dhe përshkrime precize të përkryera. Nëse shohim ndonjë ndryshim në ajet, nuk do të thotë se janë përdorur sinonimet. Aty nuk ka shprehje që nuk aludon në një precizitet të lartë. Nuk ka fjalë të kotë e cila do t’ia ndryshojë temën, por, një thënie e qëllimtë dhe çuditërisht precize në përshkrim. Precizitet në retorikë, edhe pse, orientalistat ia mveshin pa të drejtë Kur’anit, kinse ka shumë mospajtime në të. Derisa mendojnë ashtu, i arsyetojnë thënjiet e tyre, duke thënë se është e natyrshme të ketë gabime në të, pasi “Kur’ani është libër i Muhammedit s.a.v.s”. Me kalimin e kohës ata edhe e ndërrojnë mendimin e tyre, dhe e lavdërojnë atë. Kjo është natyra e njeriut, herë lavdëron e herë kritikon duke thënë, se Kur’ani ka shumë kundërthënie. Kjo do të jetë tema ime në kapitullin tjetër të këtij libri, do të përqëndrohem në këto “kundërthënie”.

## **THËNJET SE KUR’ANI KA KUNDËRTHËNIE**

Kjo pyetje e cila gjithmonë i ka preokupuar orientalistët, si dhe ata të cilët e luftojnë këtë fe. Gjithmonë e sulmojnë atë duke thënë, se Kur’ani ka “shumë kundërthënie”. Ata harxhojnë kohën e tyre për ta njollosur Kur’anin. Sikur ta shpenzojnë të njejtën kohë të kësaj njollosjeje të Kur’anit në studim dhe njohjen të njëmendtë të Kur’anit, do të ishte shumë më e përparuar kjo shoqëri dhe do të bindeshin në madhësinë e Kur’anit. Qëllimi i tyre starton që në fillim në zhveshjen e mrekullive të Kur’anit. Ajo që është më madhore në Kur’an, ajo edhe sulmohet. Por, më e rëndë-

sishmja është se Kur'ani është fjalë e All-llahut. Etiketimi dhe njollosja e tij nga orientalistët, se aty ka kundërthënie ose gjëra që kundërshtohen njëra me tjetrën, janë të pa baza. All-llahu i Lartësuar është i pagabueshëm. Ai nuk harron, në të nuk ka kundërthënie ashtu siç kanë njerëzit. Nëse dikush e etiketon Kur'anin me ndonjë kundërthënie, qëllimi tij është që të mohoj madhësitinë e Tij dhe mrekullinë e tij, duke filluar me etiketimin e parë, se Kur'ani është libër i “Muhammedit s.a.v.s.” e jo i Zotit xh.sh.

Është për t'u habitur, është shumë interesante se mrekullia e Kur'anit ju del përpara atyre që duan ta njollosin atë. Ata nesër do të jenë dëshmitarë të saj, duke u munduar t'a luftojnë atë. Ata e qartësojnë edhe më tepër mrekullinë, paraqesin një gjë që ishte e fshehur dhe e pa njohur për ne. Ata në të vërtetë kanë dhanë një kontribut me ato supozime, sepse janë paraqitur të tjerë për t'iu kundërvënë thënieve të tyre. Ka ndodhë që gjatë studimit të tyre, ta kuptojnë, se vërtetë Kur'ani është libër mrekulli, i zbritur Muhammdi s.a.v.s.

Të fillojmë nga fillimi. Orientalistët thonë, se Kur'ani është fjalë njeriu. A është e vërtetë kjo? Do të fillojmë të polemizojmë temë pas teme, mbase do të ishte më mirë të ishte një libër i veçantë.

## **KRIJIMI I QIEJVE DHE TOKËS**

Që nga fillimi, të krijuarit e qiejve dhe tokës është vepër e All-llahut të Lartësuar. Kur flitet për këto në Kur'an, flitet për gjërat të cilat nuk i dinë të tjerët përpos All-llahut. Kur dikush pretendon të thotë diçka rreth kësaj, në shënjestër e ka fenë, mënyrën se si ta sulmojë. Ç'thonë

orientalistët për këtë. Ata orvaten të tallen me Kur'anin, duke thënë se në shumë kaptina është përmendur që toka dhe qiejt janë bërë për gjashtë ditë, kurse në kaptinën *Fusilet*, ditët e krijimit janë tetë. Kjo është nga harresa dhe mjegullitë e njeriut ( thonë ata).

Me thëniet si më lartë, ata sikur duan të konstatojnë, se Muhamedi s.a.v.s.është autor i Kur'anit. Ky pra është qëllimi i tyre.

Të shohim tani se çfarë thotë Kur'ani në kaptirën *el Earaf*:

“Vërtetë Zoti juaj është All-llahu i cili krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë”. Në kaptirën Junus thotë: “Vërtetë Zoti juaj është All-llahu i cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë”. Kurse në kaptirën el-Furkan thotë: “Ai i cili krijoi qiejt dhe tokën dhe gjithë atë çka ka në mes tyre për gjashtë ditë.”

Të gjitha këto ajete, thonë se qiejt dhe toka janë krijuar për gjashtë ditë. Shihet qartë se këtu nuk ka asnjë kundërshtim, andaj nuk ka se pse të debatojmë lidhur me këtë. Nëse kthehemi prap në kaptinën *Fusilet*, ku All-llahu xh.sh. e shkoqiti krijimin e qiejve dhe tokës, dhe thotë:

“Thuaj: A e mohoni Atë Zot, i cili e krijoi tokën për dy ditë, e ju i përshkruani Atij shokë, kurse Ai është Zot i botërave. Ai ka vendosur në të (tokë) male të forta dhe e bëri të bekuar, dhe banorët e saj i furnizoi me risk të caktuar – kjo gjithçka u bë për katër ditë. Ky (fakt) mjafton për pyetësit. Mandej Ai iu drejtua qiellit kur ai ishte vetëm një tymtajë (mjegullirë) dhe i tha atij (qiellit) dhe tokës: Ejani të bindur, me dëshirë ose pa te. Ata thanë: Po vimë të bindura dhe me dëshirë. Mandej, krijoi shtatë qiejt në dy ditë dhe secilit qiell i dha pastaj detyrat e veta”.

Nëse i numrojmë ditët në ajetet, shohim se All-llahu i Lartësuar krijoi tokën për dy ditë. Pastaj, për katër ditë, sipër saj vendosi ma let dhe caktoi furnizimin dhe rëzkun për banorët e saj në përgjithësi, për të vazhduar pastaj në qiell. Për këtë, i Lartësuari thotë:

“Mandej krijoi shtatë qiejt në dy ditë dhe secilit qiell i dha pastaj detyrat e veta”

Ditët e krijimit në kaptinën *Fusilet* janë tetë. Kështu, dy ditë janë për krijimin e tokës, katër ditë për caktimin e riskut dhe bekimin e vendit. Pra, ditët e krijimit janë gjashtë, e më pastaj kemi edhe dy ditë tjera, të cilat ia ka kushtuar qiejve, që do të thotë së gjithsejt janë tetë ditë.

Orientalistët thonë se Kur’ani në vete ka kundërthënie. Në Kur’an, hasim se diku thuhet që ditët e krijimit të tokës dhe qiejve janë gjashtë, e diku, ditët e krijimit janë tetë. Orientalistët e përmbyllin rastin, duke thënë se këtu kemi të bëjmë me njeri i cili harron si të gjithë njerëzit tjerë.

Nëse tregohemi më të vëmendshëm gjatë leximit të ajeteve të përmendura, do të shohim se fillimi ndryshon prej ajeteve të më parme. All-llahu xh.sh. thotë: “Thuaj: A e mohoni Atë Zot, i cili e krijoi tokën për dy ditë, e ju i përshkruani Atij shokë, kurse Ai është Zot i botrave”.

Ajeti fillon duke na e përshkruar, se si mohuesit i bëjnë All-llahut shok (partner), dhe shfrytëzojnë rastin që të debatojnë. Që në fillim shohim se ky ajet paralajmëron mrekullinë, sepse iu ka dhënë rast mohuesve të gjejnë diçka që mendojnë se është gabim në Kur’an. Këta, si entuziastë që janë, shfrytëzojnë nga rasti që të propagandojnë kundër fesë së All-llahut, dhe të bindur se do të jenë të suksesshëm, citojnë ajetet e lartpërmendura. Ata, sikur që janë debatues, janë edhe luftues të fesë. Ata, e kanë mohuar All-llahun xh.sh., e tani përpiqen që edhe të tjerët t’i bindin kundër fesë,

ngase All-llahu ju thotë: “e ju e bëni Atë me partnerë”, si dhe thënia: “A e mohoni Atë Zot, i cili e krijoi tokën për dy ditë”.

All-llahu iu përgjigjet atyre sikur te kenë debatuar që atëherë. Edhe pse ky debat filloi pas shumë shekujve, dëshira e tyre ishte që të mbjellin dyshim në mesin e besimtarëve, andaj edhe zgjodhën pikërisht këto ajete.

Ne u themi atyre: Ai i cili i kundërvihet këtyre ajeteve, ose është i detyruar, ose është injorant ndaj argumenteve të All-llahut. All-llahu i Lartësuar thotë: “A e mohoni Atë Zot, i cili e krijoi tokën për dy ditë, e ju e bëni Atë me Partnerë “. Pastaj thotë: “Ai ka vendosur në të (*tokë*) male të forta dhe e bëri të bekuar dhe banorët e saj i furnizoi me risk të caktuar”. Këtu All-llahu flet rreth plotësimit gjatë krijimit të tokës. Ai na jep mënyrën më të hollësishme të krijimit, duke thënë se vëndosi malet e forta në tokë. Caktoi riskun në tokë dhe e begatoi atë për katër ditë. Përderisa fjala ishte për plotësimin e të njejtës gjë që e filloi, pra për tokën, All-llahu nuk e kapërceu vazhdimin e fjalisë edhe për qiejt. Ai na shpjegon se si u krijua toka. Pra, All-llahu thotë: “Unë krijova tokën për dy ditë pastaj e mbarova ate, pasi i plotësova të gjitha për katër ditë”, që nënkupton se koha për krijimin e tokës është katër e jo gjashtë ditë.

Të marrim një shembull për të qenë më të kuptueshëm. Të supozojmë se do të udhëtoni me tren nga Prishtina për në Prizren. Gjatë kësaj rruge, treni do të ndalet edhe në qytetin e Gjakovës. Të paramendojmë se treni pas një ore do të ndalojë në Gjakovë dhe do të përfundojë në Prizren pas dy orë e gjysëm. A nënkupton kjo se largësia e Prishtinës nga Prizreni është tre orë e gjysëm? Jo, kurrësi. Largësia në mes këtyre dy qyteteve është ashtu siç thashë në fillim, kurse ora e cila u

paramendua tek unë ishte ora e cila është brenda dy orëve e gjysëm. Kjo është ashtu, sepse Gjakova është në mes Prishtinës dhe Prizrenit.

All-llahu kur na flet për krijimin e tokës, Ai na thotë se krijova tokën për dy ditë dhe ate e plotësova me vëndosjen e maleve të forta, e begatova atë dhe e caktova furnizimin, të gjitha këto për katër ditë. Fjala, të gjitha këto për katër ditë, është koha për të cilën All-llahu e ka krijuar dhe e ka plotësuar tokën. Pra, dy ditë për krijimin e tokës dhe dy ditë për plotësimin e krijimit të tokës.

## HOLLËSITË E KRIJIMIT

All-llahu i Lartësuar, nuk ka dhënë hollësi të tjera mbi fazat e krijimit, përpos atyre në kaptirën *Fusilet*, e cila tregon se Ai së pari krijoi tokën për dy ditë, pastaj ate e plotësoi duke ia dhënë gjallërinë me vendosjen e maleve dhe caktimin e furnizimit, dhe e begatoi atë edhe për dy ditë tjera. Kjo ishte periudha e krijimit të tokës, pra për katër ditë. Pas përfundimit të krijimit të tokës, Ai krijoi qiellin.

“Mandej Ai iu drejtua qiellit kur ajo ishte vetëm një tymtajë (mjegullirë- pluhur)”

Ishte etapë e re pasi plotësoi tokën për katër ditë. Krijimi i qiellit i mori edhe dy ditë, kështu që krijimi në tërësi, u bë për gjashtë ditë nga ditët e All-llahut:

“Dhe vërtetë një ditë te Zoti yt është sa njëmijë vjet sipas llogarisë suaj”<sup>28</sup>

Kështu, shohim se kudërthëniet në Kur’an, janë vetëm një iluzion. Orientalistët donin të shfrytëzonin rastin, që me hollësitë rreth krijimit të tokës ta destabilizojnë botën islame, duke u munduar të fusin iluzionet dhe shpifjet e tyre. All’lahu ishte i ditur për sjelljet dhe iluzionet e tyre, andaj, i parapriu ajeteve duke ju thënë:

“A ju doni ta mohoni Atë Zot, i cili e krijoi tokën për dy ditë, e ju e bëni Atë me partnerë, kurse Ai është Zot i botërave”

Kështu e filloi ajetin All-llahu, duke iu sygjerruar njëkohësisht, atyre të cilët do të kërkojnë debat me Të, dhe të cilët qëllimin për ta sulmuar rrugën e All-llahut, e kishin të bazuar në hamendjet e tyre.

## **DASHURIA DHE MIRËSIA**

Të shohim tani thënien e All-llahut të Lartësuar :

“Ti s’do të giesh popull, i cili e beson All-llahun dhe Ditën e Fundit, që t’i dojë ata, të cilët e kundërshtojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, po sikur ata të ishin edhe etërit e tyre, ose bijtë e tyre ...”<sup>29</sup>

---

<sup>28</sup> Kur’an, sure 22 el Haxh, ajeti 47

Pastaj, në një ajet tjetër thotë:

“Dhe nëse ata (prindërit e tu) grinden me ty që të më përshkruash Mua shok, për të cilën ti s’ke dije, atëherë mos i respekto ata, mirëpo sillu mirë me ta (prindërit) ndaj çështjeve të kësaj bote ...  
„<sup>30</sup>

Orientalistët edhe këtu mundohen të futin huti ndër muslimanët duke thënë, se Kur’ani diku kërkon që prindërit të respektohen e diku të mos respektohen, ashtu siç vërejtëm në ajetet e sipërshënuara.

Themi se nuk ka kurrëfarë kundërthënie në mes ajeteve. Ata nuk e kanë kuptuar precizitetin e fjalëve dhe përshkrimin e ajeteve Kur’anore.

Le të shpjegojmë këto më hollësisht. Njeriu i bën një të mirë si atij që ia do zemra, po ashtu dhe atij që nuk e do. Ndodhë që të takojë në rrugë një njeri të cilin nuk e njeh fare, dhe ngaqë gjendet në një pozitë tepër të vështirë e ndihmon atë, duke mos pritur asnjë kompensim prej tij, por e ndihmon sepse në saje të asaj ndihme ai mund të shkojë deri në shtëpi, ose mund të ushqehet në saje të të hollave që i jep. Ai e bën këtë të mirë duke shpresuar se All-llahu do t’a shpërblejë, megjithëse atë ndihmë që ia dha, atë nuk e lidh asgjë me atë njeri. Kësaj i thuhet mirësi kurse, dëshira e ka vendin e saj në zemër. Ti nuk dëshiron asgjë tjetër përveç atë që do. Nuk mendon të jetosh ose të qëndrosh përveçse me atë që e do. Mirësia nuk e dridhëron zemrën, kurse dëshira e dridhëron atë shumë thellë. Zemra dhe dëshira jetojnë me personin, kurse zemra me mirësinë

---

<sup>29</sup> Kur’an, sure 58 el Muxhadele, ajeti 22

<sup>30</sup> Kur’an, sure 31 Llukman, ajeti 15

nuk jetojnë së bashku. Nëse zemra është në njeriun pabesimtar dhe ai është pabesimtarë. Zoti nuk ti jep dy zemra në gjoks. Bazohemi në thënien e All-llahut:

„ All-llahu nuk ia ka dhënë ndonjë njeriu dy zemra në gjoksin e tij...”<sup>31</sup>

Bamirësia është një nga veprat e pëlqyera të All-llahut xh.sh.

T’i kthehemi ajetit të All-llahut:

“ Ti s’do të gjesh popull, të cilët besojnë All-llahun dhe Ditën e fundit, t’i duan ata, të cilët e kundërshtojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij ...”

All-llahu xh.sh këtu përdori fjalën dëshirë. Kjo fjalë e ngacmon zemrën. Nuk do të gjesh njeri besimtar i cili do njerinë të dëshiron t’a luftojë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, sikur ata të ishin prindërit ose fëmijët e tyre. Dashuria është brenda në zemër, ajo rjedh nga brendia e shpirtit njerëzor. Më pas All-llahu për sa i përket prindërve këshillon besimtarët që të qëndrojnë afër prindërve edhe pse prindërit nuk mundohen të bëhen besimtarë. Nuk duhet të qëndrojmë larg tyre në përfundimin e jetës së tyre. Këta janë të dobët në pleqërinë e tyre, ishin ata që u sollën me mirësjellje ndaj nesh dhe na edukuan. Na urdhëron All-llahu, që ne të jemi shumë të kujdeshëm me ta, si dhe ta shprehim dashurinë ndaj tyre nëse janë besimtarë. Po nëse ata tentojnë që të fusin politeizmin në zemrat tona, ose tentojnë që ne ta shoqërojmë All-llahun e Lartësuar, kërkohet nga ne që mos t’i respektojmë. Kjo nuk do të thotë të sillemi keq me ta, por përkundrazi na këshillon, që të jemi të shoqërueshëm me ta, dhe të vazhdojmë me mirësi. Kjo është nga edukata e Kur’anit.

---

<sup>31</sup> Kur’an, sure 33 el Ahzab, ajeti 4

Bëjmë atë që pëlqen All-llahu i Lartësuar. E bëjmë këtë nga pëlqimi i së bukurës, por, zemra nuk i dashuron. Mirësia vlen për të dashurit, si dhe për të pa dashurit. Dashuria i takon vetëm asaj që e do. Ti ju bën mirë, por ajo mirësi nuk rrjedh nga zemra jote, sepse ata gjithnjë tentojnë, që ti ta shoqërosh All-llahun, pra janë kundër parimeve tua. Mirësia jote vazhdon, ngase me këtë mirësi je i pëlqyer te All-llahu xh.sh. Ai gjithnjë është Mirëbërës edhe me ata që e mëkatojnë. Atë që na e ndalon ne, është që mirësinë e dikujt, mos t'ia kthejmë me të keqe. Mirësia dallon shumë nga dashuria.

Zemra është me All-llahun, këtu nuk hyn pabesimtari, si edhe ai i cili tenton që t'i bëhet shok Atij. Paraqitja ime me mirësjellje ndaj prindërve të mi, është nga urdhërat e All-llahut për ta, nga mëshira e tyre ashtu siç më edukuan dhe më rritën kur unë isha i vogël. Polemika rreth besimit nuk paraqitet në mes fëmijëve dhe prindërve përveçse në moshën e pas adoleshencës ose burrërisë. Kur vjen kjo kohë, ata do të jenë në kohën e pleqërisë dhe obligohem që ti respektoj, për t'ia kthyer mirësinë e tyre kur isha i vogël dhe për ta dëgjuar fjalën të cilën e pëlqen All-llahut xh.sh.

## VEÇOHET NËNA – PSE

Të shohim tani pikën e tretë. Ajetet të cilat përmenden në Kur'an, kanë të bëjnë me këshillën që All-llahu i bën për prindërit, më pastaj përmendin vetëm nënën:

“Dhe Ne, e këshilluam njeriun të sillet mirë ndaj prindërve të vet, ngase nëna e tij e barti atë me mundim, dhe e lindi me dhembje, dhe shtatëzania dhe gjidhënja e tij zgjatë tridhjetë muaj dhe kur arrinë moshën e burrërisë, dhe bëhet dyzet vjeçarë, thotë: O Zoti im, më mundëso të të Falendëroj Ty për të mirën Tënde që më dhurove mua dhe prindërve të mi”<sup>32</sup>

Kurse në kaptinën Llukman thotë i Lartësuar :

“Dhe Ne, e kemi porositur njeriun për prindërit e vet, të sillet mirë , -se nëna e tij e ka mbajtur në dëm të shëndetit të saj, periodë pas periode, kurse nga gjiri e ndan brenda dy vjetëve. Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe prindërve të tu. Tek Unë do të ktheheni .”<sup>33</sup>

Shohim se i Lartësuar, i këshilloi të sillen mirë me prindërit, më pas e veçoi nënën. Këtu disa nga orientalistët pyesin, pse All-llahu porosit vetëm për nënën, pse në ajetin e parë si në fillim ashtu edhe në fund të këtij ajeti përmendi nënën dhe babën, kurse në të dytin përmendi prindërit por porosinë në fund të ajetit e dha për nënën. Cilin po e porositë All-llahu xh.sh.? Po e porositë foshnjen i cili nuk kupton asgjë dhe nuk di të lexojë Kur’an, a mund të dijë foshnja për këtë periudhë, Atëherë kujt po i drejtohet Kur’ani? Nëse i drejtohet foshnjes,do të thotë, po i drejtohet njeriut i cili nuk kupton. Nëse i drejtohet njeriut i cili është rritur. Ai po i drejtohet njeriut i cili nuk mban mend dhe nuk e di atë periudhë.

Ju themi atyre, se ata nuk i kuptojnë këto ajete. All-llahu i Lartësuar e veçoi nënën për arsye se ishte një kohë e cila nuk ishte e njohur për të, dhe nuk e përceptoi atë. P.sh. Kur foshnja është e

---

<sup>32</sup> Kur’an, sure 46 el Ahkaf, ajeti 15

<sup>33</sup> Kur’an, sure 31 Lukman, ajeti 14

vogël nëna përkujdeset për të. Ajo zgjohej natën për ta ushqyer, ajo e bartë në bark, pastaj e lind, dhe kur ai të rritet, kush i gjindet pranë? Babai është ai i cili ia realizon dëshirat. Kur ka nevojë për lodra ose roba ose para, ai i drejtohet babait. Të mirat e babait i ka në kujtesë, kurse të mirat e nënës i ka të pa njohura. Prandaj, All-llahu e porosit më tepër për nënën, se sa babanë. Kjo ndodhë për atë, sepse fëmia mendon, se babai është më i mirë se nëna, për arsye, se babai ia plotëson dëshirat. Rallëherë ndodh që ta kuptojë lodhjen e nënës. Prandaj fëmia mundohet t'i jetë mirënjohës babait. Për këtë arsye porositë e All-llahut ishin për nënën. Muhammedi s.a.v.s. tha: tri herë Nëna, nëna, nëna, pastaj tha babai. Atëherë ç'kuptim ka kjo porosi e All-llahut, kur ai nuk e parakujton atë kohë. Ai kurrësesi nuk kujtohet. Qëllimi i kësaj porosie është, që njeriu të shoh me kujdes të veçantë, se si rriten të tjerët, si lodhen, nënat e tjera si kujdesen gjatë ditës dhe natës, si vuajnë, etj. Kur ai ta shohë këtë, do të kuptojë, se edhe ai ishte si këta fëmijë të tjerë. Duhet ta ndjej edhe ai këtë, pastaj të mundohet t'ia kthejë të mirat asaj. Qëllimi i All-llahut ishte, vetëm t'ia përkujtojë duke e porositur për lodhjet e nënës dhe pastaj babait për lodhjet e babait. E veçon nënën, ngase ajo është kujdesur në heshtje të thellë sa që ajo kujdesje për fëmijnë është e pa qartë.

## **ERDHI URDHËRI I ALL-LLAHUT DHE MOS NXITONI**

Si mund të thuhet, nga ana e All-llahut erdhi dhe mos shpejtoni. Erdhi është kohë e kaluar sepse ndodhi, kurse mos shpejtoni, është koha e ardhme. Si mund të ndërlihet njëra me tjetrën? Ju

themi atyre: Kur ju flisni për All-llahun duhet të kenë parasyshë se jeni duke biseduar me Atë që nuk i ngjanë askujt, është i vetëm dhe i pa shembullt. Ti ke fuqi, por edhe All-llahu ka fuqi. Por shtrohet pyetja, a barazohet fuqia jote me atë të All-llahut. Ti jeton në një vënd që numërohet koha, kurse për Atë koha nuk ekziston. Fjala *erdhi* të All-llahu, të dituria e All-llahut kuptohet se ka ardhur sepse kur Ai thotë bëhu, ajo bëhet. Nga dituria e të Lartësuarit reflektohet ose përfundon në diturinë e bindjes. Gjërat tani lëvizin nga dituria e All-llahut në diturinë e njeriut. E gjithë kjo realizohet me fjalën: Bëhu. Kur All-llahu i Lartësuar do që diturinë e Vet, ta kalojë në diturinë e njeriut, Ai vetëm thotë, „Bëhu” që d.t.th. se urdhëri Tij zbatohet aty për aty!

Tek All-llahu është dituria e kataklizmës. Ajo veç është paracaktuar, nuk ka kurrëfarë force që mund ta ndalojë atë ndodhi. Ajo do të vijë, për të nuk ka dyshim. Mos e kërkoni përshpejtimin e saj, dhe mos përshpejtimin e shprehjes bëhu duke qenë se ju po shpejtoni.

Pse përshpejton njeriu? Besimtari i vërtetë, nëse i frikësohet ndokujt, ajo është vetëm Dita e Ringjalles, Dita e Gjykimit, dhe më së shumti i frikohet Drejtësisë së All-llahut i Cili nuk le të vogël e të madhe pa e llogaritur:

“Dhe e gjejnë atë që kanë vepruar para vetes”<sup>34</sup>

E vogla është para të madhes. Nëse nuk ka lënë pa i shënuar të voglat, atëherë çka do të bëhet me të mëdhatë. Besimtari i vërtetë i frikohet kësaj dite, aq, sa do të jetë besimtar i fortë. Ai dridhet nga ajo ditë. Kurse mohuesit e All-llahut, nga injoranca e kësaj dite, nuk e ndiejnë dhe nuk e

---

<sup>34</sup> Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 49

kuptojnë fjalën Ahiret,<sup>35</sup> e as çka d.t.th. Dita e Llogarisë, e ky person nxiton, dëshiron që ajo ditë të vijë sa më parë, edhe pse nuk e di se ç'është ajo ditë dhe çka e pret. E dini pse All-llahu e tha Vetë, se Dita e fundit është caktuar dhe kjo është vendim i prerë: U vendos ky urdhër dhe ju mos nxitoni. Ju mos shpejtoni që kjo ditë të vijë. Ju nuk mund ta merrni me mend, se çfarë është ajo ditë. Kjo nga All-llahu është thënë, dhe u bë, këtu nuk kemi kundërthënie gjatë përdorimit të fjalive në kohën e kaluar dhe të ardhmen. Kur i Lartësuari thotë: Erdhi urdhëri i All-llahut, dmth. Kjo ka të bëjë me dijen e All-llahut, prandaj e kaluara dhe e ardhmja nuk kanë ndonjë domethënie të veçantë, kurse për dijen time, për mendjen time kjo është një kohë që do të vijë dhe kjo i përket të së ardhmes. Kur All-llahu thotë: bëhu dhe i fryn Surit, a do të mund njeri ta pengojë atë urdhër? Nuk ka forcë mbi forcën e Zotit. Cila forcë mund ta pengojë thënien e tij Erdhi urdhëri i All-llahut. Ti nuk siguron nevojat e së nesërme, dhe ti nuk mund ta pengosh Ate. Pra fjala erdhi është një gjë e kryer, por është e fshehur për ne dhe për këtë tha:

“ Dhe mos nxitoni “.

## **A E PA MUHAMEDI A.S.**

Të shohim pikën tjetër. All-llahu ia përshkruan kaptinën e elefantëve Muhammedit s.a.v.s.

---

<sup>35</sup> Ahiret, jeta e amshueshme (sipas islamit njeriu kalon tre jetë derisa të arrijë në ditën e Ahiretit).

“A nuk e sheh (aludohet në shikimin mendorë) se ç’bëri Zoti yt me Poseduesit (ushtrinë) e elefantëve”.

Disa nga orientalistët thonë, se këtu kemi të bëjmë më një të kaluar. Ajo ngjarje kishte ndodhur diku në kohën e lindjes së Muhammedit s.a.v.s., kurse në Kur’an thuhet, a nuk e sheh d.t.th. këtu kemi të bëjmë me një mashtrim, sepse ai nuk e ka parë ngjarjen. Sikur t’i thuhej, a nuk e ke ditur, do të ishte e mundur, sepse dikush i ka treguar për atë ndodhi.

Ajo çka u shpëtoi atyre është, se ata nuk e dijnë, se kjo është një nga çështjet e besimit. Atë që All-llahu i Lartësuar ia thotë një njeriu besimtar, është një e vërtetë e padyshimtë. Kur’ani është një libër me të cilin bëhet adhurim dhe ai nuk ndryshon dhe kur All-llahu thotë: A nuk e sheh d.t.th. se ky shikim vazhdon për secilin besimtar. Shikimi këtu ka të bëjë me një mrekulli të madhe. All-llahu dëshiron t’i bindë mendjet tona ashtu, siç u bindën ata kur e panë. Kjo ishte një prej mrekullive të mëdha, dhe këtu dëshira e All-llahut është të tregojë, se ka bërë që i dobëti të bëhet i fortë. Këtë nuk e bën dot kush përveç All-llahut.

Unë mund ta punësoj ndonjë njeri të dobët për të bartë pesha të randa, sepse mund ta ndihmojë atë, por, asesi nuk mundem ta shndërroj të dobëtin në të fortë. Të bëhet aq i fuqishëm, sa të mund ta bartë atë peshë. Por All-llahu e bën këtë, jep forcë të dobëtit, që ai pastaj të bëhet nga më të fuqishmit në botë, dhe t’i mundë të gjitha perandoritë. Kush do ta bënte këtë, me një njeri i cili ishte nga më të dobëtit? Kjo ishte njëra nga mrekullitë e All-llahut xh.sh. Ajo që ndodhi në luftën me elefantat ishte, se aty u mund një nga ushtritë më të forta të kohës, ajo u mund nga disa shpend të quajtur Ebabel, të cilët kishin me vete nga tre gurë, një në sqep, e dy në këmbë. Kështu e mposhtën këtë ushtri elefantash që ishte nga ushtritë më të fuqishme. Sikur unë t’i tregoj dikujt,

se një tufë shpendësh shkatërruan një ushtri më të fuqishme në botë, do të talleshin me mua, sepse kjo nuk është e logjikshme. Si mund të ndodhë kjo, All-llahu këtu përdori një nga krijesat më të dobëta, shkatërimin e ushtrisë më të fortë. Kjo ishte një mrekulli që nuk mund ta bëjë askush, përveç All-llahut. Disa musliman, kanë filluar të luhaten në këtë mrekulli nga thëniet, dhe analizat e shumta të orientalistëve, që janë bërë për këtë ndodhi. Disa supozojnë se ajo që e mundi ushtrinë e Ebrehesë (komandantit të kësaj ushtrie) ishin mikrobet që u dërguan nga Zoti, kësaj ushtrie. Unë nuk pajtohem me këtë mendim. Kjo ndodhi në vitin kur u lind Muhammedi s.a.v.s. Kjo ngjarje u tregua fill pas shpalljes së Muhammedit s.a.v.s. pra pas dyzet e sa vjetësh. Atëkohë kishte njerëz të cilët e kishin parë me sy atë ndodhi, e ata në atë kohë mund të ishin të moshës 55 vjeçare e më tepër. Atë kohë kur është treguar kjo ngjarje, shumë nga ata mezi kishin pritur që ta përgënjështonin Muhammedin s.a.v.s. dhe ta shpallnin intrigues, dhe do të thonin, se kjo nuk ishte e vërtetë, që aty të kenë ardhur shpendë. Se nuk është mundur një ushtri e tillë. Por asnjë nga ata që ishin gjallë dhe që e kishin parë, nuk e kundërshtoi thënien e All-llahut. Ajo ngjarje pra, kishte ndodhur ashtu, siç e përshkruajti All-llahu i Lartësuar. Kjo nuk ka nevojë për koment, sepse All-llahu është i Plotëfuqishëm dhe kjo për besimtarët nuk diskutohet. Kjo ndodhi kur lidhet me çështjen e besimit gjithmonë të jep të kuptosh, se ajo po ndodhë tani, është para nesh. Ne këtë e vërtetojmë edhe sot, sa e sa të dobtëve u ndihmon All-llahu dhe i mundin të fortit. Dhe sa të fortë i turpëron All-llahu dhe i bën të përfundojnë në duart e të dobëtit. Për besimtarin, Fjala e All-llahut është fjalë bindëse dhe e vërtetë, sikur atë e sheh duke ndodhur, dhe për këtë shkak All-llahu i Lartësuar tha: *A nuk e sheh*, e nuk i tha a e pe, ose a e dite, por i tha, *A nuk e sheh*, pra në kohën e tashme të vazhdueshme dhe do të ndodhin ngjarje të tilla gjatë shekujve deri në ditën e fundit. Ishte një ngjarje e vërtetë All-llahu i ndihmon të dobëtit kundrejt mizorëve. Kjo është një nga çështjet e mëdha të besimit, detyrimisht zemra duhet ta shohë nëse je besimtar.

Ta shohësh me bindje, *A nuk e sheh*, ky është besim. Kjo është një nga Urtësitë e fjalës *A nuk e sheh*. Kjo bën që besimtari ta ndiejë veten të fortë në forcën dhe mundësitë e All-llahut në të gjitha ato ngjarje që ndodhin rreth të vërtetës, dhe të pavërtetës, deri në ditën e fundit .

## KUSH JANË GËNJESHTARË

Të shohim se edhe çka tjetër thonë orientalistët për Kur'anin. Ata kanë vërejtur se në Kur'an ekzistojnë kundërthënie. Sa herë që ata i vërejnë këto kundërthënie neve na zbulohet një mrekulli e vërtetë. Tani fjalën e kanë në ajetin e All-llahut të kaptinës el Munafikun ku i Lartësuarit thotë: “Kur vijnë hipokritët te ti, thonë: Ne dëshmojmë, se vërtetë ti, je Pejgamber i All-llahut. Dhe All-llahu e di se ti, me të vërtetë, je pejgamber i Tij, po ashtu All-llahu dëshmon se hipokritët pa dyshim janë gënjeshtarë”<sup>36</sup>.

Orientalistët thonë: Hipokritët dëshmonin se Muhammedi është i dërguari i All-llahut. All-llahu e di se Muhammedi është i dërguari i Tij, dhe thotë se hipokritët gënjejnë. Nuk është e qartë se si gënjenin hipokritët kur ata dëshmonin atë që edhe vet All-llahu dëshmonte. Si ndodh që dy dëshmi të jenë të drejta. Të dëshmohet se Muhammedi është i dërguar i All-llahut dhe në të njëjtën kohë ata të jenë gënjeshtarë, kur dëshmia parapëlqehet me diturinë e All-llahut. Dihet se

---

<sup>36</sup> Kur'an, sure 63 el Munafikun, ajeti 1

gënjeshtër nuk ka bazë me realitetin. A nënkupton kjo se hipokritët nuk e thonë realitetin, këtu kemi të bëjmë me kundërtënie. Kështu supozojnë orientalistët.

Të shohim të komentojmë ajetin. Ata, pra hipokritët, thonë:

“Ne dëshmojmë, se vërtetë ti je Pejgamber i All-llahut. Dhe All-llahu e di se ti, me të vërtetë, je pejgamber i Tij “

Atëherë pse ata quhen gënjeshtarë, a mos gënjeshtër është në fjalën: Vërtetë, ti je i dërguar i All-llahut? Jo, asesi, Muhammedi vërtetë ishte i tillë. Gënjeshtër nuk ka të bëjë me thënien vërtetë, ti je i dërguar i All-llahut, por ka të bëjë me fjalën *ne dëshmojmë*, ata thonin ne dëshmojmë se Muhammedi është i dërguar i All-llahut. Gënjeshtër është e qartë, dhe ajo bie tek fjala dëshmojmë. Dëshmia për ne është e vlefshme, kur atë që ke në zemër e shpreh me gojë. All-llahu e dinte mirë se ç’kishte në zemrat e tyre, atë të cilën e thonin me gojë, nuk e shprehnin edhe me zemër. Thënja e tyre se: ne dëshmojmë, ishte gënjeshtër. Gënjenin sepse ata në realitet nuk dëshmonin, sepse nuk e besonin që Muhammedi ishte i dërguar i All-llahut. Ata kishin ardhur me hipokrizi, gënjeshtër qëndron pikërisht aty se ata thonin po dëshmojmë, jo se e pranonin të vërtetën, por sepse shtrëreshin si të tillë, e në fakt ishin hipokritë. Që Muhammedi s.a.v.s. është i dërguar nuk ka dyshim, por gënjeshtër është në fjalën dëshmojmë, prandaj All-llahu ju thotë: “Dhe All-llahu e di, se ti me të vërtetë je i dërguari i Tij“

Këtu ka një dallim në mes dëshmitarit dhe atij për të cilin dëshmohet. Ka dallim në mes dëshmisë së gënijer dhe dëshmisë së vërtetë reale. Për atë që dëshmohet, nuk ka dyshim, ajo është e vërtetë, por dëshmia e hipokritëve ishte e rreme. Kështu që shihet shumë qartë se sa preciz është Kur’ani.

## PYETJA E CILA NUK ËSHTË PËR T’U DITUR

Të shohim edhe një nga shumë mrekullitë e Kur’anit, i Lartësuari thotë:

“Atë ditë, nuk do të pyetet rreth mëkateve të tij, as një njeri e asnjë xhin”<sup>37</sup>

Dhe thotë në një kaptirë:

“Mandej, aty ndalni ata, sepse do të pyeten”<sup>38</sup>.

Në ajetin e parë, mohohet të pyeturit, në të dytin vërtetohet, se do të pyeten. Si mundet kjo? Këtu orientalistët shfrytëzojmë nga rasti, për të thënë se kemi të bëjmë me kundërthënie. Si mund All-llahu të thotë, “se atë ditë nuk do të pyetet rreth mëkateve të tij, as njeriu e as xhini”. Pastaj të thotë: “Mandej, aty ndalni ata, sepse do të pyeten”.

Kjo kundërthënie është rezultat i harresës nga Muhammedi a.s.i cili harron sikuse edhe të gjithë të tjerët.

Ata thonë ashtu, sepse nuk e kuptojnë mirë pyetjen. Kjo pyetje ka dy kuptime. Njëra është, ata nuk do të mirren në pyetje që të dëshmojnë për veten e tyre. Nxënësi kur e pyet arsimtarin, e pyet për të mësuar, ose për të ditur. Kur arsimtari e pyet nxënësin, e pyet atë, për të mësuar apo për ta

---

<sup>37</sup> Kur’an, sure 55 el Rahman, ajeti 39

<sup>38</sup> Kur’an, sure 37 el Safat, ajeti 24

mësuar. Me siguri arsimtari ia di të metat nxënësit, e pyet atë me qëllim, që nxënësi të jetë vetë dëshmitarë i mosdijes së pyetjes të parashtruar nga arsimtari. Ai nuk është në gjendje të debatojë, bile as të thotë u kujtova tani, sepse ai nuk ka lexuar asnjë fjali rreth asaj pyetje. Pyetjet e provimeve nuk i harton Ministria e Arsimit, sepse ata nuk e dijnë atë që nxënësit e dijnë. Testimi i nxënësit është dëshmi e rezultatit të tyre nëse është i shkëlqyer, i dobët ose nxënësi s'është përgjigjur fare.

Kështu pra Kur'ani thotë:

“... atë ditë nuk do të pyetet rreth mëkateve të tij as njeriu e as xhini”

Ndalohet pyetja për të ofruar njohuri, All-llahu e di mirë për mëkatet e tyre. Ai i di, prandaj ai nuk është i nevojshëm për pyetje që të dijë, nuk ka nevojë, sepse e di nga ata, sepse Ai është më i ditur se ata dhe për atë, nuk ka pse të pyet. Pyetësi është më i ditur se i pyeturi e nuk nevojitet pyetje për të ditur dhe për këtë arsye tha:

“atë ditë nuk do të pyetet rreth mëkateve të tij, as njeri e as xhini”

Kurse në ajetin e dytë: “Mandej, aty ndalni ata, sepse do të pyeten”. Ju do të pyeteni sepse do të vërtetoni realitetin e ndodhisë së dhënies së llogarisë. E jo të thoni, se këtë All-llahu nuk e ditka. Tani është koha e llogarisë, për të dëshmuar për veten tuaj! Ky është komenti i ajetit të parë dhe të dytë. Ku është ajo kundërthënie që supozojnë orientalistët në Kur'an. All-llahu i Lartësuar flet për mohuesit e Zotit dhe gënjeshtarët, dhe thotë:

“Dhe do të thonë: Vaj për ne, kjo qenka dita e gjykimit! (All-llahu do të thotë) Kjo është dita e ndarjes (Dita e Gjykimit) që ju e përgënjeshtrojnë. Ne do tu themi (engjujve) tuboni ata, të cilët

ishin mizorë, si dhe bashkëmendimtarët e tyre, edhe ata të cilët adhuroheshin prej tyre, përveç All-llahut, dhe shpini ata drejt Xhehennemit. Mandej, aty ndalni ata, sepse do të pyeten”<sup>39</sup>

Çështja këtu nuk është për të ditur, por çështja është për ata që do të mirren në pyetje, e që do të jenë dëshmitarë për veten e tyre. Kjo ishte ajo që ju e përgënjeshtrohet. Kjo ishte ajo që ju e adhuroni, me përjashtimin e All-llahut. Tani pra erdhi koha e dhënies llogari për të qenë dëshmitarë për vetëveten tuaj në Ditën e Gjykimit. Kudo që ishit, adhuroni gjithçka, me përjashtim të All-llahut. Do të pyeteni cilin e adhuroni tjetër përveç All-llahut. Pastaj do t’u thotë All-llahu:

“(Atë ditë do të pyeten) Ç’keni që nuk po ndihmoheni ndërmjet vetë. Pse nuk po ju ndihmon askush, pse tani nuk po ju ndihmojnë ata që ju i adhuroni”.

Këtu nuk pyeten për të mësuar, por, për të qenë dëshmitarë të vetes së tyre, sepse bartnin barrën e tjetërkujt. Të shohim tani ajetet tjera të cilat janë në shënjestër të supozimeve të orientalistëve. Thotë i Lartësuar

“ Askush nuk do ta barrtë barrën e askujt “<sup>40</sup>

Në një vend tjetër thotë:

“Askush nuk do ta barrtë barrën e askujt “<sup>41</sup>

---

<sup>39</sup> Kur’an, sure 37 el Saffat, ajeti 20-24

<sup>40</sup> Kur’an, sure 6 el En’an 164

<sup>41</sup> Kur’an, sure 35 Fatir 18

Në një vend tjetër thotë:

“Askush nuk do ta barrtë barrën e askujt “<sup>42</sup>

Pastaj në kaptirën el Ankebutë thotë:

“Por ata, me siguri do të bartin barrën e vet, e me atë, edhe barë të tjera “<sup>43</sup>

Si është e mundur kjo? Nga caktimet e Zotit ishte që “Askush nuk do ta bartë barrën e askujt “. Diku tjetër thotë: “Por ata, me siguri do të bartin barrën e vet, e me atë të veten barrë të tjera“. A nuk është kjo kundërthënie, kjo është një nga harresa dhe moskujtimet e thëna më parë të Muhammedit. Ata dëshirojnë që kështu të jetë, por, për fat të keq të tyre, ata harrojnë se Kur’ani është mrekulli dhe shumë preciz. Iu themi atyre: “Askush nuk do ta bartë barrën e askujt “. Kjo do të thotë se çdo njeri është përgjegjës për mëkatin e vet. Por kemi nga ata që do të bartin me barën e vet edhe barën e të tjerëve. Kush janë këta? Këta do të jenë ata persona të humbur, të cilët janë munduar t’i largojnë edhe të tjerët nga rruga e All-llahut. Bartës në ajetin e parë është ai bartës i të humburit. Nëse unë jam i humbur dhe tjetri i humbur, secili nga ne e bartë barën e vet për vete. Secili është bartës i humbjes së vet. Po kush është ai i cili bartë edhe barën e tjetrit. Ai person i cili është i humbur për vete por nuk kënaqet me atë që ka në vete dhe ndikon që edhe të tjerët të humbin. Ndikon tek njeriu besimtar dhe mundohet që t’ia prishë besimin dhe ndikimi i tij bëhet shkaktar që mund që ta bind atë që ai ta mohojë All-llahun, këta persona quhen të

---

<sup>42</sup> Kur’an, sure 53 el Nexhm, ajeti 38

<sup>43</sup> Kur’an sure 29 el Ankebutë, ajeti 13

humbur. Këta nuk kanë vetëm barrën e tyre por kanë pjesë edhe nga bara e atyre që ndikuan në humbjen e tyre. Kjo vërtetohet në ajetin e All-llahut në kaptirën *en Nahl*:

“Në mënyrë që ditën e gjykimit të bartin tërë barën e vet, por edhe një pjesë të barës së atyre, të cilët i kanë mashtruar pa dije...”<sup>44</sup>

Pra, ata që ndikojnë t'i mashtrojnë të tjerët dhe vazhdojnë të propagandojnë në jobesim dhe ateizëm do të bartin edhe një pjesë të dënimit të atyre që ndikuan në mashtrim. Supozojmë se unë, takoj një njeri i cili nuk pi pije alkoholike dhe mundohem në çdo mënyrë që ta bindi ate që ai të pi alkohol dhe ai bie në grackën time. Ai do të ketë dënim sepse gaboi që e theu urdhërin e All-llahut për ndalim të alkoholit, kështu që ajet i parë thotë: “Askush nuk do ta bartë barën e askujt” ka për qëllim të humburin. Kurse ajeti tjetër thotë: “Por ata, me siguri do të bartin barrën e vet, e me ate të veten barrë të tjera”. Kjo ka për qëllim, ata që ndikuan në mashtrim dhe dëshiruan t'i humbin edhe të tjerët. Këta do të bartin edhe një pjesë të dënimit të atyre që i mashtruan dhe u drejtuan drejt rrugës së mëkateve dhe gabimeve.

Këto ishin disa nga “kundërthëniet” e orientalistëve të cilët ia mveshin Kur'anit duke thënë se Ai është shkruar nga njeriu, kurse për ne, ata na shërbyen që të vërtetojmë se aty nuk ka kundërthënie, por aty është mrekullia e Kur'anit të Madhëruar. Kurrë nuk do të hasim në kundërthënie në Kur'an, por, gjithmonë do të shohim se aty është një precizitet dhe retorikë e pa imagjinuar. Vërejmë se fjalia dhe kuptimi janë në harmoni të plotë ato, nuk largohen njëra nga tjetra dhe në të njëjtën kohë nuk japin të njëjtin kuptim për të njëjtën gjendje. Disa të humburve

---

<sup>44</sup> Kur'an, sure 16 el Nahl, ajeti 25

dhe disa orientalistëve nuk u mjaftoi kjo. Ata nuk u kënaqen vetëm me kundërshtimin e kundërthënieve por thonë se kemi kundërthënie të ligjeve të natyrës nga ana e Kur'anit. Kjo është një shpifje e madhe e tyre dhe kjo do të jetë pjesa tjetër e asaj që do të flasim.

## **KUR'ANI DHE LIGJET E NATYRËS**

Mrekullitë e Kur'anit janë të shumta, e ato do të zbulohen. Ato nuk zbulohen pa e lexuar Kur'anin me vëmendje të madhe, dhe mrekullitë e tij do të zbulohen me kalimin e kohës. Këto mrekulli japin të kuptosh se kemi të bëjmë me një libër shumë preciz. Sulmeve të orientalistëve që i drejtohen Kur'anit Kerimit, kinse aty ka kundërthënie, jemi detyruar t'iu përgjigjemi, duke vërejtur se më pas, Kur'ani është kuptuar në masë edhe më mirë. Në një nga pjesët e këtij libri, folëm rreth retorikës së Kur'anit e pastaj sqaruam “kundërthëniet” në Kur'anin e Madhëruar. Tani do të flasim rreth disa shpifjeve që janë munduar t'a njollosin atë.

Pas humbjes drastike të orientalistëve në të ashtuquajtura kundërthënie, ata u munduan ta sulmojnë Kur'anin, në një formë tjetër me gjoja përplasjen e Kur'anit me realitet e natyrës. Pas hulumtimit të bërë, sipas tyre, konkluduan se në Kur'an ka disa përplasje me fenomenet e gjithësisë. Kjo ishte një shpifje e llojit të tyre. Kur'ani kurrë nuk mund të ndeshet me realitetin natyror.

Nuk ndodhë të ndeshet, sepse ai që e tha është vetë Krijuesi i natyrës. Duke u bazuar në këtë, themi se nuk është e mundur që njeriu të jetë më i ditur se Ai, i cili e krijoi këtë natyrë. Motivi i tyre është shumë i qartë. Ata mundohen ta njollosin Kur'anin dhe të fusin në të të pa qena, si edhe shpifje të ndryshme. Por, në këtë pjesë të librit, polemika jonë me ta, ka për qëllim që të sqarojë atë që pohojnë ata.

Para se të futemi në temë, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Kur'ani i Madhëruar është libër universal. Ai vazhdimisht jep risi për çdo gjeneratë dhe kjo e bën atë të Madhëruar. Sikur mos të ishte Kur'ani libër universal që sjell risi të vazhdueshme, atij për një kohë të shkurtër do ti humbej vlera. Shihet qartë se Kur'ani është i pa shterrur, ushqen çdo gjeneratë aq sa ajo gjeneratë është në gjendje të marrë prej tij. Kështu e ushqen çdo gjeneratë duke ia dhënë atë që nuk ia dha gjeneratës së më parme.

Tani po kuptojmë se pse Muhammedi s.a.v.s. nuk i shpjegoi të gjitha ajetet, por, vetëm ato që kishin të bëjnë me urdhëresat, “bëje këtë ose mos e bëj këtë”, pra ato gjërat të cilat kishin karakter të shpëtimit ose të ndëshkimit. Ndërkaq nuk u shpjeguan ajetet që kishin të bëjnë me zbulimet e kohës së ardhshme. Duket qartë, se ato nuk u shpjeguan, sepse në atë kohë, njerëzit nuk ishin në gjendje që shkencëtarisht të kuptonin ajetet Kur'anore dhe realitetin e universit. Kur'ani jep aq, sa mundet ta kuptojë ai që e lexon, dhe të kënaqet me kuptim e tij. Shkuan vite ose shekuj të tërë derisa u kuptuan disa të dhëna të Kur'anit.

## KUR'ANI DHE TEORITË SHKENCORE

Para se të flasim për të vërtetat e gjithësisë, ne duhet t'u përgjigjemi dy pyetjeve shumë të rëndësishme.

1. Mundësinë e lidhjes mes Kur'anit dhe teorive shkencore. Disa nga dijetarët gabojnë kur mundohen t'a shpjegojnë Kur'anin me zhvillimet shkencore. Fjalën e All-llahut xh.sh. e mbronin me teoritë shkencore që zbuloheshin. Mund të ndodhë që këto zbulime të jenë të gabuara dhe do të dalë se Zoti qenka gabim. Kur'ani, nuk është libër shkencor e të ketë nevojë për ta vërtetuar shkenca. Ai është libër adhurimi, me program dhe sistem jete. Ajo se ç'ka ka Kur'ani, e di vetë All-llahu, duke qenë se Ai e di se do të vijë një kohë kur Kur'ani do të kuptohet shumë më lehtë, pasi të kenë ardhur gjenerata tjera të cilat do të thonë se perëndoi koha e besimit. Tani jemi në kohën e shkencës. Këta do ta vërtetojnë mrekullinë e Kur'anit dhe do të flasin për të vërtetat e gjithësisë ashtu siç theksoi Kur'ani shumë shekuj më parë. Zbulimet e vërtetuara i japin kurajo njerëzimit, të thonë se njeriu e vërtetoi atë që thoshte Kur'ani. Kur'ani pra është dhurues i përhershëm, risitë e tija s'kanë të mbaruar. All-llahu në Kur'an thotë: “ Ne do t'u bëjmë të mundur që të shohin Shenjat Tona në të gjitha horizontet si dhe në vehten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se Ai (Kur'ani) është i vërtetë “. <sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> Kur'an, sure 32 el Sexhde, ajeti 53

Duhet të kemi kujdes në shkronjën (*S in*) në fjalën (Senurihim – do t’u bëjmë të mundur ). Ky sin jep kuptimin e një të ardhme. Sa herë të lexohet Kur’ani, e ardhmja është e pa definuar nga gjenerata në gjeneratë, deri në Ditën e Kijametit. Kjo të jep vizion të qartë, se shenjat e All-llahut, nuk kanë të mbaruar, ato do të zbulohen ndër gjenerata. Por kjo nuk do të thotë që ne ta marrim barrën të cilën nuk jemi në gjendje ta bartim. Ne duhet ta trajtojmë Kur’anin, si libër i cili na këshillon për njohuritë e botës. Kur’ani nuk na mëson sekretet se si të arrijmë deri te shkencat e përsosura teknike, ose astronomia, shkenca elektronike etj. Në Kur’an, pas sures së parë, pra Hapjes së Kur’anit, me rradhë vjen *suretul Bekare* e cila fillon me fjalët: Elif, Lam, Mim, Ky është një libër në të cilin nuk ka kurrëfarë dyshimi, është udhëzues për të devotshmit ...”

Pra, Kur’ani është libër udhëzimi. All-llahu na dhuroi ajete të shumta të cilat do të na shërbejnë për përgjigje ndaj sulmuesve të Kur’anit, deri në Ditën e Kijametit. Ajete të shumta që gjenden në Kur’an, janë zbuluar ose janë të njohura për ne. Ajetet të cilat nuk janë të zbuluara, dhe janë ende të pa qarta për ne, na shërbejnë për t’u thënë sulmuesve të Kur’anit, të cilët thonë se perëndoi koha e besimit, se tani jemi në kohën e shkencës. E këta sulmues do të krijojnë diçka që nesër do t’u thonë njerëzimit se ky është Zot. Ky është produkt i diturisë sonë dhe krijimtari e jona. Mos i adhuroni krijesat e ta largoni Krijuesin. Kjo na detyron që shkencën ta përdorim për ta vërtetuar Kur’anin, sepse Kur’ani është argument i padiskutueshëm për vërtetësinë ose jo vërtetësinë e shkencës. Një shkencë e cila është në kundërshtim me Kur’anin e Madhëruar është gënjeshtër dhe e pa pranuar.

Kur’ani është Fjala e All-llahut, përmes tij adhurohet deri në Ditën e Kijametit. Nuk ndryshon dhe nuk zëvendësohet. Është e rrezikshme lidhja e Kur’anit me teoritë shkencore, shpeshherë teoritë shkencore janë jo të sakta dhe të pavërteta. Ne jemi larg shpjegimeve të tyre, pasi që ato

mund edhe të vërtetohen se ishin teori të pa sakta. Prandaj këto nuk ndryshojnë ose nuk zëvendësojnë asgjë nga fjala e All-llahut xh.sh. Për këtë arsye sygjerohet të gjithë dijetarëve, të mos shpejtojnë në vërtetësinë e çfarëdo zbulimi shkencorë, dhe të krahasojë këtë zbulim shkencor me Kur'anin, përderisa të mos janë të bindur dhe të kenë bindje të plotë për vërtetësinë e tij. Do të jemi shkaktarë për një gabim të pafalshëm ndaj njollosjes së Kur'anit, kur të vërteohet pasaktësia e atij zbulimi.

## **PSE U LA PA SHPJEGIM**

Shtrohet pyetja, pse nuk u shpjeguan ajetet shkencore për bashkëkohësit e zbritjes së Kur'anit, ose të paktën të shërbente për gjeneratat e ardhshme. Dihet se të vërtetat e universit për të cilat është sinjalizuar në Kur'an nga ana e All-llahut xh.sh. kanë të bëjnë me proceset më të mëdha të kozmosit. Ato janë në shërbim të njeriut, qofshin ato në dijen e njeriut ose jo. Dielli, rrotullimi tokës, gravitacioni i tokës, nata dhe dita, si dhe procese të tjera natyrore, e në anën tjetër shkencë e embriologjisë si dhe gjithçka që është rreth njeriut, edhe këto kanë të bëjnë me rregullat e proceseve natyrore. Rregullat e krijimit janë në shfrytëzim të njeriut, i njohëm ato ose jo. Miliona njerëz nuk dinë asgjë për gravitacionin e tokës, mirëpo ata i shfrytëzojnë këto rregulla. Miliona njerëz nuk dinë asgjë për rregullat e natyrës, për precizitetin dhe balansin, mirëpo, ata i shfrytëzojnë këto rregulla. Miliona njerëz nuk dinë asgjë për jetën e fetusit në mitrën e nënës por, ajo nuk i pengon ata të mos lindin fëmijë.

Të gjitha këto, si dhe të tjera, nuk u shpjeguan nga All-llahu, sepse ato ishin në shfrytëzim të njeriut. Nuk kishte nevojë të shpjegoheshin, ishin ata në dijeni të plotë për to ose jo. Kjo është mrekulli e Kur'anit, ju jep njohuri aq sa do ta kuptojnë atë. Këto ajete u shpjeguan dhe do të shjegohen ndër gjenerata, do të shpjegohet aq sa do ta kuptojë njerëzimi në kohën në të cilën jeton.

Të kthehemi pak tek orientalistët. Këta supozojnë se rregullat e gjithësisë janë në kundërshtim me Kur'anin. Kurse ne u themi se asnjë zbulim shkencor, që është zbuluar deri sot, nuk është në kundërshtim me Kur'anin. Kur'ani nuk mund të përplasë me shkencën. Këto ndeshje të supozuara, nganjëherë mund të ndodhin për arsye të keqinterpretimit të Kur'anit, ose nga ndonjë zbulim shkencor i rrejtshëm, që bëhet vetëm e vetëm për ta njollosur Kur'anin. Ashtu siç thashë, po e përsëris edhe njëherë, ne nuk duam që ta provojmë vërtetësinë e Kur'anit përmes shkencës, por, e themi të kundërtën, e cila është e vlefshme, shkenca duhet të vërtetohet me Kur'an. Të shihet nëse zbulimi i supozuar është në kundërshtim me Kur'anin. Kur'ani është më i përsosur se çdo shkencë në botë. Shkenca është dituri e njeriut, kurse Kur'ani, është dituri e All-llahut të Lartësuar. Duhet të jetë e qartë se unë kurrë nuk mundohem ta vërtetoj Kur'anin me shkencën toksore, por, më duhet t'ju them atyre që njollosin Kur'anin, se nuk ka kundërshtim në mes Kur'anit dhe zbulimeve shkencore nëse ato janë të vërtetuara saktësisht.

## TOKËN . . . E SHTRUAM

Të shohim tani vërtetësitë dhe realitet e Kur'anit. Të shohim nëse kemi të bëjmë me keqinterpretime, apo përplasje në mes së vërtetës shkencore dhe asaj Kur'anore!? Disa nga dijetarët përmendin se All-llahu xh.sh. në Librin e Tij thotë:

“ Ndërsa tokën e kemi shtruar “<sup>46</sup>

Fjala med ka kuptimin, shtruarje, d.m.th e kemi shtruar. Tokën e shohim të shtruar para nesh. Nuk ka kurrfarë përplasje në mes Kur'anit dhe asaj që shohim para nesh. Por kur u zbulua se toka është e rrumbullakët, u ngritën disa dijetarë fetarë dhe kundërshtuan këtë zbulim ngase mendonin se është në përplasje me Kur'anin. U themi se ishte keqinterpretim nga disa komentatorë të Kur'anit. All-llahu i Lartëmadhëruar, në Kur'an na kishte dhënë argumentin se toka është e rrumbullakët. Ai na informoi se toka dhe krijimi i saj është në formë topthi. Të polemizojmë rreth kësaj.

Përmendëm se në Kur'an thuhet: “Ndërsa tokën e kemi shtruar”. All-llahu nuk tha se toka është e rrafshët, gjë që nënkupton se ngado që të sillesh, toka është e rrafshët. Nëse gjendesh në një pikënisje, sheh se toka para teje është e rrafshët. Po u ngjite më në veri, pra, në polin e veriut, sheh se toka është e rrafshët. Nëse shkon në Evropë, Amerikë, Azi, ose në Afrikë, toka para teje është e rrafshët. Toka është e rrafshët në çfarëdoqoftë këndi të rruzullit tokësor, e kjo nuk do të mund të ndodhte nëse toka nuk do të ishte e rrumbullakët. Sikur toka të ishte në formë cilindri,

---

<sup>46</sup> Kur'an, sure 15 el Hixhr, ajeti 19

katrori, trekëndëshi, gjashtëkëndëshi, ose në çfarëdo forme tjetër gjeometrike, do të arrinim vetëm në një skaj të saj. Përderisa nuk kemi arritur asnjëherë në një nga skajet e saj, nënkuptohet se toka nuk ka formë tjetër përpos formës së rrumbullaktë.

Mrekullinë e Kur'anit, unë e shoh në thënien: “Ndërsa tokën e kemi shtruar”. Edhe kjo është një nga vërtetimet e All-llahut për formën e rrumbullakët të tokës. Këtu është shfrytëzuar thënia që do të kuptohet nga të gjithë në kohën e zbritjes së Kur'anit, dhe në të njëjtën kohë, nuk bie ndesh me shkencën. E gjithë kjo, ndodhë në dy fjalë të vetme, jepet lajmi ose sekreti i tokës në këto dy fjalë të vetme. Pra, kjo nuk mund të bëhet nga dituria e njeriut. All-llahu na ka sinjalizuar për formën e tokës edhe në katër fjalë të cilat ishin në kohën e krijimit.

## PARAPRINË NATA APO DITA

Kur të shohim ajetet e Kur'anit: “...dhe as nata s’është para ditës ...”<sup>47</sup>

All-llahu xh.sh. në suren Ja-Sin thotë: “As dielli nuk duhet ta arrijë hënën, dhe as nata s’është para ditës ...”

Fjala këtu është për rregullat e gjithësisë. Dielli nuk mund ta arrijë hënën, sepse siç është thënë nga shkencëtarët, ato lundrojnë nëpër orbita të veçanta. Kjo e vërtetë shkencore është zbuluar

---

<sup>47</sup> Kur’an, sure 36 Ja Sinë, ajeti 40

tani pak para disa vitesh, kurse Kur'ani e ka sinjalizuar që para katërmbëdhjetë shekujsh. “...dhe as nata s’është para ditës...”. Këtu, All-llahu për qëllim kishte të eliminonte një realitet të gabuar. Arabët thonin se nata është para ditës. Tek arabët dita fillonte pasi të perëndoje dielli. Kështuqë, muaji Ramazan vërtetohej pasi të perëndoje dielli në fund të muajit Shaban, Bajrami vërtetohej në perendimin e ditës së fundit të muajit Ramazan. Nëse arabët thonin se nata është para ditës kjo nënkuptonte se dita nuk është para natës.

Këtu kemi të bëjmë me dy të vërteta. Nata është para ditës, si dhe dita nuk është para natës. All-llahu këtë e la pa e kundërshtuar, sepse ishte një e vërtetë. Ai ju tha atyre se thënja juaj është e vërtetë, por, këtu shtoi edhe thënien: “edhe nata s’është para ditës”.

Pra, dita s’është para natës dhe as nata s’është para ditës. Kjo jep të kuptohet, se nata dhe dita ishin prezente në të njëjtën kohë, e kjo nuk mund të ndodhë nëse toka nuk është e rrumbullakët. Ky nuk është kuptimi i fundit i këtij ajeti. All-llahu xh.sh. dëshiroi ta përmirësojë këtë realitet, dhe e bëri të qartë se nata dhe dita ekzistojnë në të njëjtën kohë në rruzullin tokësor. Me këtë na sinjalizoi për realitetin e krijimit të tokës. Sikur All-llahu ta krijonte tokën në formë të rrafshtë në momentin kur ajo u krijua, dielli do të ishte prezent, dhe atëherë do të thonim se dita është para natës, sepse nata erdhi më pastaj. Por, All-llahu na thotë se as dita dhe as nata, nuk e parakuptojnë njëra tjetrën sepse janë të krijuara në një kohë. Kjo është argument se toka është krijuar në formën e rrumbullakët. Forma e vetme është kjo e cila e vërteton se nata dhe dita janë krijuar (u gjendën) në të njëjtën kohë.

Kjo e vërtetë u vërtetua atëherë kur mendja e njeriut u angazhua dhe filloi të hulumtojë thellë në kuptimet e ajeteve Kur’anore. Kështuqë, shohim se All-llahu xh.sh. na ka sinjalizuar, edhe me

këtë shembull, që ne të kuptojmë se toka është në formë të rrumbullakët, edhe atë vetëm me pak fjalë.

## RROTULLIMI I TOKËS DHE KODRAT

Në Kur'an, rrotullimi i tokës, është theksuar si një nga realitetet e gjithësisë. Në suren el Neml (*Thnegla*), ajeti 88, i Lartëmadhëruari thotë :

“Dhe i sheh malet (kodrat), e mendon (llogaritë) se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin ashtu siç lëvizin retë. (kjo është) Vepër e All-llahut, i cili çdo gjë e përsosi ...”

Kodrat u rrënjosën thellë në tokë. Ishte e domosdoshme që këto të privohen nga lëvizjet. Të qenit të privuara nga lëvizjet, sigurojnë mosdridhjet e tokës dhe sigurojnë luhatjet e njeriut. Ato janë simbol i qendrueshmërisë. Kur ato vështrohen, e japin këtë mesazh. Nga pamja e madhësisë dhe rrënjosjes së tyre, beson se toka është stabile dhe nuk lëvizë as edhe një hap të vetëm. Duket shumë stabile dhe e pa lëvizshme, prandaj All-llahu në Kur'an e thotë fjalën: *mendon* (llogaritë). Këtë e ka thënë nga mëshira e Tij ndaj njeriut. Njeriu mendon se kodrat janë të pa lëvizshme. Por, ja që All-llahu dëshiron të na tregojë, se atë që ne i mendojmë se ato janë të pa lëvizshme, në realitet lëvizin nga një vend në një vend tjetër. Kodrat lëvizin ashtu siç lëvizin retë. Pse u tha si retë? Retë janë ato që nuk lëvizin vetvetiu, por lëvizin në sajë të erërave. Retë pa erërat qëndrojnë në vend. Erërat janë ato që i lëvizin retë nga një vend në një vend tjetër. Në Kur'an, përdorimi i

shprehjes - “*si retë*”, është sinonim i lëvizjes të kodrave me ndihmën e dikujt tjetër. Nëse kodrat janë të pa lëvizshme, atëherë kush i lëviz ato, nëse nuk lëvizën nga vetvetja? Kush është ai që i vë në lëvizje? Kjo është toka, e cila me lëvizjen (rrotullimin e saj), i lëviz edhe kodrat. Me siguri që edhe toka lëvizë dhe rrotullohet, sepse përndryshe, si do të lëviznin kodrat duke qenë ato të rrënjosura thellë në tokë. Pra kodrat e rrënjosura thellë, i përkasin një vendi që është në lëvizje. Ashtu sikur retë që janë të varura nga era, edhe kodrat janë të varura nga toka, ngase ato janë të rrënjosura në tokë. Në këtë mënyrë, All-llahu i Lartësuar na shpjegoi në formën më të përsosur, lëvizjen e tokës dhe rotacionin e saj. Ne kemi llogaritur se kodrat janë të palëvizshme por del se ato qenkan në lëvizje të vazhdueshme, përderisa toka lëviz. Fjala: *“Mendoni se janë të palëvizshme”*, ka nevojë për një shpjegim më të gjërë, sepse kjo na vërteton një tjetër realitet shkencor.

Nëse qëndron në një trup që është në lëvizje, por nuk ka kurrfarë dridhje në atë trup, nuk e ndjen atë lëvizje. Do ta ndiesh atë lëvizje, nëse e krahason atë trup me një trup tjetër, i cili nuk është në lëvizje. Nëse vështrojmë nga dritarja e aeroplanit me të cilin fluturojmë, atëherë e ndiejmë lëvizjen e aeroplanit dhe atyre që janë aty. Por, nëse mbyllim dritaret dhe koha të jetë e qetë, si dhe aeroplani të fluturojë pa dridhje, ne nuk do ta ndiejmë lëvizjen e aeroplanit. Pse nuk do ta ndiejmë? Kjo ndodhë për arsye se çdo gjë përreth nesh, është e pa lëvizshme dhe ne nuk e ndiejmë atë lëvizje. Karriket dhe çdo gjë përreth teje, është e palëvizshme. Kjo vlen edhe për qëndrimin tonë në veturë ose tren, nuk kemi tronditje dhe çdo gjë është e qetë dhe nëse i kemi mbyllur dritaret nuk do ta ndiejmë lëvizjen e mjetit dhe lëvizjen tonë. Por nëse e hapim dritaren dhe vështrojmë një objekt të palëvizshëm do të vërejmë lëvizjet tona me mjetin ku qëndrojmë vetë.

Me këtë All-llahu xh.sh. dëshiroi të na tregojë se ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë lëvizjen e kodrave, sepse toka është stabile dhe qëndrimi ynë është stabil, dhe qëndrimi përreth nesh është stabil, dhe ne llogarisim se çdo gjë është e palëvizshme, sepse nuk imagjinohet ajo lëvizje përderisa nuk kemi mjet tjetër të palëvizshëm para nesh që të krahasohet. Por ne ju themi, këto kodra lëvizin, dhe këto nuk lëvizin nga vetja e tyre që të shkojnë nga një vend në një vend tjetër mbi tokë, por, ato përcjellin tokën gjatë rotacionit të saj, e ti mos u habit sepse ajo është nga “*Veptra e All-llabut i Cili çdo gjë e përsosi*“, e po u bazove në këtë, atëherë do të bindesh.

Dikush thotë se ky cilësim i përket Ditës së Kijametit, por ne u themi atyre se kjo nuk ka të bëjë me ate, sepse atje nuk ka parallogaritje, por, atje është bindja.

All-llahu thotë:

“...prandaj T’a hoqëm mbulesën, e sot shikimi yt është i mprehtë”.<sup>48</sup>

Si dhe thënia e të Lartësuarit për kodrat në Ditën e Kijametit:

“Dhe do të pyesin ty për kodrat, dhe thuaju: Zoti im do t’i bëjë ato hi e pluhur”<sup>49</sup>

Si është e mundur që ato t’i bën hi e pluhur dhe ato të parallogariten se janë të rrënjosura, thotë i Lartësuari xh.sh.: “Ditën kur toka do të zëvendësohet me një tokë tjetër dhe qiellërat...”<sup>50</sup>

---

<sup>48</sup> Kur’an, sure 50 Kaf , ajeti 22

<sup>49</sup> Kur’an, sure 20 Ta Ha, ajeti 105

<sup>50</sup> Kur’an, sure 14 Ibrahim, ajeti 48

Në Ditën e Kijametit çdo gjë do të jetë e qartë dhe sheshazi, sepse nuk ka kodra, e gjitha do të jetë hi e pluhur. Do të shohim xhennetin dhe xhehennemin, si dhe do ta shohim All-llahun, pra llogaritja i përket kësaj bote kurse bindja në botës tjetër.

## **PSE DUHET TË FLASIM PËR EMBRIONIN**

Thamë se Kur'anî ka theksuar shumëçka. Sikur të ishte vepër e tjetërkujt nuk do të sillte edhe këto të dhëna. Fjala është për fetusin. Në Kur'anin e Madhëruar All-llahu xh.sh thotë:

“Vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun nga ekstrakti i baltës. Mandej, Ne e kemi vendosur atë si një pikë sperme në një vend të sigurt (mitër). Mandej, Ne e kemi trajtuar (spermën) në mpiksje gjaku; mandej atë mpiksje gjaku e kemi trajtuar në një copë mishi; mandej Ne e kemi shndërruar atë copë mishi në eshtra dhe mandej eshtrave ua veshëm mishin, mandej atë e trajtuam në një krijesë tjetër (u bë njeri), Pra i bekuar është All-llahu që është Krijuesi më i mirë”.<sup>51</sup>

A thua çka e shtyri Muhammedin a.s.v.s. të merret me sekretet. Dhe ato t'i prezantonte në Kur'an, gjë e cila do ta shkatërronte besimin që nga themeli. Kur'anî është fjalë e All-llahut, leximi i tij konsiderohet adhurim, nuk ka ndryshime në të dhe as që mund të zëvendësohet deri në Ditën e Kijametit. Çmund të ndodhë me përparimin e shkencës. Sikur të vërtetohet se këto thënje janë

---

<sup>51</sup> Kur'an, sure 23 Mu'minun, ajeti 13

të pa vërteta, atëherë si mund të vazhdojë besimi në Zot? Pse Muhammedi të merret më këto sekrete, të cilat do ta rrezikojnë fenë. Askush nuk kërkoi nga ai të na tregojë këto sekrete, dhe askush nuk e sfidoi atë. Jo, jo, kjo ndodhë ngase Krijues është All-llahu. Ai tregoi këto vërtetësi para se të zbulohen nga shkencëtarët, e më pas shkencë t'i vërtetoi saktësitë e këtyre thënieve të Kur'anit. Ishte kjo njëra nga sfidat e All-llahut xh.sh.

## **NË VETET TUAJA**

Një nga pikat shumë interesante të cilat i shqyrtoi Kur'ani, është edhe trupi i njeriut dhe shkencë organike. Shohim se All-llahu në Kur'an i përmend shqisat e të dëgjuarit, gjithnjë para shqisave të të pamurit.

Kur njeriu humb të pamurit, atëherë themi se ka humbur çdo gjë. Nuk sheh, është në terr të plotë, e nëse nuk sheh, ska dyshim se është humbur plotësisht. Por nëse i ndodh që të humb të ndëgjuarit, e jo edhe të pamurit, themi se kjo do të ishte më e lehtë. Kur All-llahu e përmend të dëgjuarit dhe të pamurit, gjithmonë i jep përparësi të dëgjuarit!

Këtu kemi të bëjmë më mrekulli të All-llahut. All-llahu e lartësoi shqisën e të dëgjuarit, para asaj të të pamurit, sepse shqisa e dëgjimit është ajo e para e cila e merr detyrën nga organet e njeriut në këtë botë. Këtë detyrë dhe përparësi do ta ketë edhe në ahiret. Një nga arsytet është se kjo shqisë nuk fle kurrë. Pra, ky organ është ai i cili i pari e merr detyrën në këtë botë. Foshnja e posalindur dëgjon por nuk sheh. Nga kjo themi se rëndësia e këtij organi është që nga dita e parë

e jetës së tij. Nëse në afërsi të një foshnje të sapolindur fjaloset, dhe përdoren fjalë bezdisëse, i sapolinduri do të reagojë duke qarë. Nëse të sapolindurve ia afrojmë duart afër syve, ata nuk e ndiejnë veten të rrezikuar. Kjo është e para. Në kohën kur njeriu është duke fjetur, duket të jetë çdo gjë në qetësi, me përjashtim të të dëgjuarit të tij. Nëse dëshirojmë që ta zgjojmë njeriun nga gjumi, edhe sikur t'ia afrojmë dorën afër syve, ai nuk do të reagojë. Por, nëse ai dëgjon ndonjë bubullimë, do të zgjohet shpejt dhe i trishtuar. Kjo ishte e dyta. Kurse e treta është ajo që të dëgjuarit është organ ndërmjetësues në mes njeriut dhe botës.

Në momentin kur dëshira e All-llahut ishte që personat e shpellës të flejnë me qindra vjet tha:

“Dhe iu mëshuam në veshët e tyre (duke qenë ata) në shpellë (ku ata qëndruan) vite të tëra”,<sup>52</sup>

Nëse priset organi i dëgjimit, qenka e mundur që të flihet me qindra vite pa ndonjë shqetësim. Meqenëse lëvizjet dhe bubullimat gjatë ditës pengojnë njeriun të flejë në gjumë të thellë, kjo nuk ndodh gjatë natës, ngase është qetësi. D.m.th se veshi e merr detyrën i pari dhe ai nuk fle, nuk hamendet, si dhe qenka ndërmjetësues ndërmjet njeriut dhe botës. Është organ i cili dëgjon ftesën për në ahiret. Këto do të ishin disa nga shkaqet, se pse All-llahu e lartësoi të dëgjuarit para organeve tjera.

Kemi edhe një gjë tjetër të cilën e vërejmë në Kur'an. All-llahu kur flet për dëgjimin, gjithmonë e thekson atë në njëjës, kurse të pamurit gjithmonë në shumës.

All-llahu thotë:

---

<sup>52</sup> Kur'an, sure 18 el Kehf ajeti

“Dhe ju nuk do të mund të fshihni (mëkatet e juaja) sepse për ju do të dëshmojë ndëgjimi juaj dhe të pamurat e juaja<sup>53</sup>

A thua pse fjala *-dëgjimi juaj*, është në njëjës, kurse fjala- *të pamurat*, është në shumës? Pse nuk u tha: dëgjimet dhe të pamurit tuaj? Shikuar logjikisht, do të ishte më në rregull, sikur të ishin që të dyja në njëjës ose shumës. I Lartësuarit me këtë deshi të na tregojë precizitetin e Kur’ani Kerimit. Të pamurit është shqisë e cila sundohet nga vetë dëshira e njeriut. Është në dëshirën time të shoh ose mos të shoh diçka. E kthej kokën, ose së paku shikimin e syve, nëse dua që të injoroj dikë, respektivisht të mos e shoh. Kurse të dëgjuarit është e kundërta e të pamurit. Nuk mund ta injorosh ose të mos dëgjosh, këtu nuk ka dua ose nuk dua. Nëse je në një dhomë ku ka dhjetë persona, sikur të flasin të gjithë, tek veshi yt do të arrijnë të gjitha zërat, deshe apo nuk deshe të dëgjosh. Pra do të mund të largosh shikimin tënd nga dikush që nuk do ta shohësh, por, nuk mundesh që të mos e dëgjosh atë që nuk dëshiron ta dëgjosh, dhe të sillesh sikur nuk e ke dëgjuar. Me dëshirë apo pa dëshirë, ti nuk ia ndalon vetes mosndëgjimin. Pra, të pamurit përfshin shumësin. Unë shoh një gjë, ti sheh atë, si dhe i treti e sheh atë. Njeriu edhe mund të mbyllë sytë e mos të shohe asgjë, por, kjo nuk vlenë për shqisën e të dëgjuarit. Të gjithë, përderisa jemi në një dhomë, do të dëgjojmë fjalimin. Të pamurit është i ndryshëm, kurse të dëgjuarit është unik. Secili ka sy dhe sheh aty ku ai dëshiron, por, secili nga ne ka veshë dhe që të gjithë jemi unik në atë çka dëshirojmë dhe çka nuk dëshirojmë të dëgjojmë. Këtu nuk përdoret thënia - *dëgjimet*. Veshët janë më të preferuar tek All-llahu, për dallim nga sytë, sepse ato nuk flejnë. Ato të cilët nuk flejnë, janë më të privileguara në krijim, se sa ato që flejnë. Veshët që nga krijimi i tyre nuk

---

<sup>53</sup> Kur’an, sure 41 el Fusilet, ajeti 22

flejnë, ato veprojnë që nga sekonda e parë e jetës së tyre. Kurse organet e tjera të trupit, do të fillojnë së funksionuari pas disa ditësh, e ka prej tyre që fillojnë edhe pas disa vitesh.

Veshi nuk flet. Gjatë gjumit pushojnë të gjitha organet e trupit me përjashtim të të dëgjuarit. Me të dëgjuar një zë zgjohesh, por, sikur të kesh probleme me shqisat e të dëgjuarit, ose të mos dëgjosh fare, atëherë çfarëdo zhurme nuk të zgjon nga gjumi, sepse organi i thirrjes është i prishur. Po e njëjta vegël, pra veshi, do të jetë ai që do ta merr ftesën atëherë kur të fryjë Suri.<sup>55</sup>

Për të funksionuar syri, ka nevojë për dritë e cila do të bën përthyerjen e objektit derisa të hyjë në sy e të shihet. Nëse është terr, atëherë nuk mund të shikohet. Kurse veshi e kryen funksionin e vet ditën dhe natën, në dritë dhe në terr, në gjumë ose zgjuar. Ai nuk fle kurrë dhe nuk ndalon. Për këtë arsye All-llahu i dha prioritet të të dëgjuarit, para të të pamurit.

## **NDIESHMËRIA DHE LËKURA**

Gjë interesante është edhe përsosmëria e ndjenjave, këtë na e mësoi i Lartësuarit. Kur'ani ka prekur një realitet shumë interesant në natyrë. Ai na mësoi se si të njihemi me përsosmërinë e ndjenjave, angazhimet e ndjenjave. Ai na mëson për këtë duke qenë se është një realitet natyror e

---

<sup>55</sup> Suri, mjet me të cilën do të fryjë një erë e cila do të shkatërron gjithëçka që është krijuar (fillimi i kataklizmës)

jo si një zbulim shkencor në lëminë e mjeksisë. Ai vetëm e tregon një realitet. Kur ai flet për mënyrën e dënimeve të pabesimtarëve me zjarr i Lartësuarit thotë:

“...Sa herë që tu piqen lëkurat e tyre do t’ua ndërrojmë me lëkurë tjetër me qëllim që ta shijojnë vuajtjen...”<sup>56</sup>

Urtësia e këtij ajeti është mu tek ndërimi i lëkurës e ajo bëhet për ta shijuar dënimin. Sipas Kur’anit vendi i ndijimit të dënimit qenka lëkura. Tani të shohim se ç’na thotë shkenca.

Është vërtetuar se të gjithë nervat e ndjeshmërisë janë të vendosura menjëherë pas shtresës së lëkurës. Këto nerva pasi ta ndiejnë rrezikun dhe dhimbjen e sinjalizojnë trurin. Ato janë poshtë lëkurës pikërisht ashtu si tha All-llahu në Kur’an “do t’ua ndërrojmë me lëkurë tjetër me qëllim që ta shijojnë vuajtjen”

Nga All-llahu është dhënë informacioni për një realitet natyrorë për, ndjeshmërinë dhe vendosjen e nervave të njeriut menjëherë pas lëkurës. Për ta ndier vazhdimisht njeriu dhembjen e zjarrit All-llahu do t’ia ndërrojë lëkurën sepse, kur lëkura të digjet e humb ndjenjën e dhembjeve ose vuajtjeve dhe kështu lëkura e re do të ndiejë dhembje. Tani kur shkencëtarët na thonë se nervat arrinë deri te lëkura u themi atyre se ato që janë të rëndësisë së veçantë na i ka treguar All-llahu para shumë shekujve.

Shihet qartë se llojet e mrekullisë në Kur’an janë të ndryshme dhe se ato sinjalizohen me shembuj shumë të thjeshtë. Në temat tjera thamë se All-llahu na thotë: “...Ecnë nëpër tokë...” e nuk tha

---

<sup>56</sup> Kur’an, sure 4 el Nisa’, ajeti 56

ecni **mbi** tokë, kështu vërtetua mrekullinë se njeriu vërtetë ecën tokë në mes mbështjellësit atmosferik dhe sipërfaqes toksore. Ashtu siç u sqarua preciziteti i ajetit "... Zoti i shumë lindjeve dhe shumë perendimeve..." Që të gjitha këto konsiderohen mrekulli të Kur'anit. Mrekullitë e Kur'anit nuk mbarojnë me kaq. Ato vazhdojnë dhe do të vazhdojnë...Tani të shohim disa të tjera.

## FOSHINJA E EPRUVETËS

Para se të përfundojmë me këtë diskutim, e shoh të arsyeshme të flas rreth të vërtetës shkencore, por kjo nuk është realitet shkencorë. Disa njerëz thonë se tani shkencëtarët kanë arritur të përcaktojnë llojin e embrionit e të thonë se fetusit është mashull ose femër. Disa shkojnë aq larg saqë thonë se shkenca do ta krijojë foshnjën në epruvetë. Kjo është në kundërshtim me ato pesë sekretet. "...dhe Ai e di se ç'ka në mitra ..."»<sup>57</sup>

Ne u themi atyre që mbështeten në këto pohime. Kush ju ka thënë se fjala ç'ka ka në mitër nënkupton vetëm të qenurit mashull ose femër. Fjala ç'ka ka kuptimin e karakterit të njeriut të ardhshëm, nëse do të jet fatlum ose fatkeq, i gjatë ose i shkurtër, i bardhë ose i zi, jeta ,furnizimi, exheli, emri çdo gjë për krijesën që do të vijë në këtë botë. All-llahu e informoi Zekerijanë për fëmiun e tij para mbarsimit. E lajmëroi për emrin e foshjes së tij, ishte një emër që nuk i emronin

---

<sup>57</sup> Kur'an, sure 31 Lukman, ajeti 34

fëmijët më parë dhe e lajmëroi për ardhmërinë e tij të më vonshme i cili do të jetë zotni, i ndershëm, lajmëtar dhe prej të mirëve. Çdo gjë ndodhi para se ky fëmijë të jetë në mitër të gruas së Zekirjasë. Kjo ndodhi derisa ai ishte në mihrab të faltores ku ai po lutej për fëmij.

i Lartëmadhëruari thotë:

“Aty e luti Zekerijahu Zotin e tij, i tha: O Zoti im, falmë prej Vetes Tënde pasardhës të mirë, vërtetë Ti dëgjon lutjet (e lutësit)! E thirrën melaiket, përderisa ai lutej në këmbë në mihrab, vërtetë All-llahu të përgëzon me Jahjanë i cili do të verifikohet me fjalën prej All-llahut dhe do të jetë zotëri i dëlirë dhe një profet prej të drejtëve. Ai tha: O Zot im, si do të kem unë fëmijë kur jamë i shtyrë në moshë madje edhe gruaja ime është shterpe? Ai (All-llahu) tha, ashtu All-llahu bën çfarë të do”.<sup>58</sup>

Sihariqi i erdhi për pasardhësin e tij duke mos qenë gjallë ai fare, as edhe në mitër të nënës së tij. Por çka është edhe më e çuditshme, Zekirjahu nuk besonte edhe vetë sepse ishte i moshuar dhe gruan e kishte shterpe. Pas të gjitha atyre pengesave për të patur fëmijë më pare, ai përgëzohet me fëmij bile, iu përcaktua edhe emri. Ai është Jahja, do të jetë i dëlirë, i dërguar e bamirës. Ky ishte një shpjegim rreth fjalës ç’ka e si munden që disa ta shpjegojnë dhe zëvendësojnë këtë fjalë vetëm me të qenurit mashkull ose femër.

Fjala “ç’ka”, përmban çdo gjë para se fëmija të lind, ku do të vdesë, ardhmërinë e tij, me cilën do të martohet, me çka do të furnizohet, do të jetë fatlum ose fatzi, i gjatë ose i shkurtër dhe çdo gjë që do t’i ndodhë atij. Fjala “ç’ka”, përmban çdo shkronjë të jetës së tij të cilën do ta përjetojë. Si

---

<sup>58</sup> Kur’an, sure 3 Ali Umran, ajeti 38- 40

do të jetojë dhe ku do të migrojë. Pra dituria e All-llahut të Lartësuar rreth fjalës “ç’ka”, është dituri e pa kufi e si mund që dikush ta përkufizojë në të qenurit e foshjes mashull ose femër, përderisa All-llahu nuk e ka përcaktuar, por tha: ç’ka në mitra .

Vërtetësia rreth mashkullores dhe femrores nuk është vërtetësi shkencore ngaqë gruaja nuk e di çka do të lindë, mashkull ose femër. Ndodhë nganjëherë të thotë do të lindi mashkull ose nganjëherë thotë do të lindi femër, kjo nuk do të thotë se e gjeti fshehtësinë. Nganjëherë thotë se do të lindi mashkull dhe ashtu ndodhë, ndodhë të thotë do të lindi femër dhe ashtu ndodhë. Kjo nuk do të thotë se e dinte dhe e kishe parashikuar. Çdo parashikim përmban në vehte 50 % të realitetit. Aty shanset janë 50% mashkull dhe 50%femër. Sikur të kishte mbi 20 lloje të gjinive njerzore atëherë do të thonim se vërtetë po e qëllonjë ate që e parashikojnë në mënyrë shkencore. Parashikimi ose përdallimi shpeshherë ndodh të dihet edhe nga njerëz të pa shkollë fare. Grave shtatëzana shpeshherë u thonë se do të lindni mashkull dhe vërtetë ashtu ndodhë. Kjo a nënkupton se vërtetë e ka ditur ç’ka në mitër. Është një çështje që qëllohet nga shumë por, disa të tjerë pas analizave të tyre shkencore thonë se u zbulua një nga pesë fshehtësirat e Zotit, kjo nuk është aspak e vërtetë. Fjala ç’ka në mitër ka përmbajtje shumë më kuptimgjërë se dituria njerëzore që prej ditëve të sotme e deri në Ditën e Gjykimit.

Tani të shkoqisim ate të foshjes së epruvetës. Është një pikë shumë e diskutuar kohëve të fundit. Kur dëshiron të krijosh diçka e në veçanti njeriun së pari duhet të grumbullosh materialin e pataj ta konstrukosh ate. Nëse e mer materialin ose organin e gatshëm të cilë ne dhuroi All-llahu atëherë këtij nuk i thuhet fëmijë i epruvetës. More prej krijimit të All-llahut nga mashkulli pastaj sajove një rrugë tjetër për ta plotësuar dëshirën e All-llahut në ate të cilën e ka krijuar All-llahu tek femra. Kështu nuk është bërë asnjë e veçantë sepse është ndaluar vetëm procesi i shtatzanisë. U

zgjodh një rrugë tjetër me materien e gjallë dhe mitrën e femrës dhe foshnja u zhvillua po me të krijuarat e All-llahut të Lartësuar. Si mund të thuhet se kjo është foshje artificiale ose e epruvtës?! Nuk ke krijuar asgjë, All-llahu të ka mundësuar të shërosh sterilët me ate që Ai ka krijuar për të vazhduar jeta njerzore, ti kështu nuk ke krijuar asgjë. Nëse vërtetë ke mudësi të krijosh njeriun artificial atëherë së pari formo materien ose spermën e gjallë. E unë them se kjo nuk mund të bëhet dhe çdo tentim për këtë do të jetë dështim.

Kemi theksuar shumë herë se Kur'ani nuk është Libër shkencorë i cili zbulon disa nga krijesat e tija në gjithësi por, Kur'ani ka zbritur si sfidues. Ai përderisa është mrekulli në vete përban sfida. Kur'ani sfidoi arabët në lëminë e retorikës por, islami është fe universale. Ai edhe pse sfidoi popujt e kohës së zbritjes ai vazhdon t'i sfidojë të gjitha gjeneratat që pasuan dhe do të pasojnë, përndryshe nuk do të quhej mrekulli e vazhdueshme.

Kur'ani është në gjendje të zbulojë enigmat e sekreteve botërore. Ai zbuloi enigmat në të kaluarën dhe, tani po zbulon enigmat. Ky do të shpalosë sekretet në të ardhmen si dhe zbulojë enigmat e vet qenies njerzore. Ai zbuloi enigmat e gjërave të cilat nuk ishin të njohura gjer në ditët tona. Kur'ani vazhdon të sfidojë dhe askush nuk i përballet kësaj sfide dhe për këto sfida do të flasim në pjesën tjetër.

## KUR'ANI SHPALUES I SEKRETEVE

Kur'ani sfidoi shumëçka. Ai foli për shumë gjëra dhe zbuloi enigmën e vendit dhe kohës, sfida tij rreth kësaj shpalosje së perdes së vendit dhe kohës. Është shpalosja e këtyre tre sekreteve:

Perdja e vendit (regionit), ka të bëjë me një ndodhi e cila ka ndodhur për një moment dhe në një vend për të cilën unë nuk di asgjë. Ajo ngjarje ka ndodhur kur unë isha në një vend tjetër.

Kemi misterin e kohës së shkuar, faktori kohë ka bërë që unë të mos di për ngjarjen sepse nuk kam qenë dëshmitarë i asaj kohe.

Misteri i së ardhmes, ka të bëjë me ate se çfarë do të ndodhë. Kjo është një perde për mua ngase unë nuk do të jem dëshmitarë i asaj kohe të ardhme.

Pra, pengesat për ta njohur një sekret qenkan tre. Ajo e vendit, ajo e kohës së kaluar dhe ajo e kohës së ardhme. Këtu kemi edhe një perde tjetër e cila i përket vet qenies njerëzore, Ajo çka fshehet në brendësinë e vet njeriut.

Kur ne lexojmë Kur'anin shohim se ai shpalos të dhëna të kohës së kaluar. Ai na informon se ç'ka ndodhur me popujt e mëhershëm. Na transmetohen të dhëna nga peygamberët e mëhershëm si dhe na tregon gjëra të cilat nuk i kemi ditur më parë e as që ishin folur ose shkruar nga ndokush. E gjithë kjo del nga një analphabet që nuk dinte shkrim e lexim. Ai na tregon edhe sekretet e kohës së kaluar bile i sfidon ata të cilët e përgënjeshtrojnë ate. All-llahu shpalosi për ne perden e kohës së kaluar, na mjafton të lexojmë thënjet e shumë ajeteve ku thotë *dbe nuk ishe, dbe*

*s'ke qenë* ...të na mësojë se All-llahu e ka informuar të dërguarin e Tij rreth sekreteve të së kaluarës.

All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe ti nuk ke qenë në anën e perëndimorëve të malit Tur, kur e ngarkuam Musaun me detyrën e të dërguarit...”<sup>59</sup>

“...Dhe ti s'ke qenë me ata kur ata i gjuanin shigjetat e tyre (për short) se cili prej tyre do të jetë kujdestari i Merjemës...”<sup>60</sup>

Dmth. Ti o Muhammed nuk ishe aty por All-llahu është ai që po të informon dhe të shpalos perden e kohës së kaluar.

All-llahu xh.sh. në suren 28 el Kasas ajeti 44-46 thotë:

“ Dhe ti nuk ke qenë në anën e perëndimorëve të malit Tur, kur e ngarkuam Musaun me detyrën e të dërguarit ... “

“... dhe ti nuk banoje midis njerëzve të Medjenit, që tu recitoje ajetet Tona...”

“Dhe ti nuk ke qenë (me Musaun) pranë malit Tur, kur Ne e kemi thirur ate, por këto (tregimet tona) janë mëshirë e Zotit tënd...”

---

<sup>59</sup> Kur'an, sure 28 el Kssas, ajeti 44

<sup>60</sup> Kur'an, sure 3 Ali Umran, ajeti 44

Kështu shohim se Kur'ani i shpalosi Muhammedit s.a.v.s. perden e kohës së kaluar në të shumtën e rasteve. Kjo ndodhi për të na informuar neve me lajme të vërteta nga ndodhitë e pejgamberëve të mëparshëm dhe për t'i përmirësuar ndryshimet dhe devijimet rreth ngjarjeve në librat e shenjta të futura nga priftërinjë a prijësit e tyre fetarë.

Vet përmirësimi i ndodhive të cilat ishin shtrembëruar nga librat e shenjta të mëhershme, konsiderohen mrekulli. Gjithë ato ndodhi kishin të bënë me një kohë shumë më të hershme nga zbritja e Kur'anit. Me këtë pra Muhammedi s.a.v.s. i sfidoi të gjithë prijësit e çifutëve dhe krishterëve. Ai apelon duke ju thënë atyre, kjo është nga All-llahu qoftë ajo në Tevrat ose Ingjil, këtë e keni ndryshuar në Tevratë dhe këtë e keni devijuar në Inxhilë. Ata nuk qenë në gjendje t'i përgjigjen kësaj sfide të tij. Kjo është një nga llojet dhe mënyrat e sfidave të Kur'anit nga periudha kohore e së kaluarës. Ai tregoi sekretet më precize të feve qiellore dhe i përmirësoi ato. Sqaroi se cila është devijuar e cila është fshehur dhe njëkohësisht kërkoi nga ata që nëse mundën le ta përgënjeshtrojnë ate, nëse kanë fakte. Kështu ju tha All-llahu

“Ai ishte Isau i biri Merjemes, Thënje e vërtetë për të cilën manipulojnë”<sup>61</sup>.

All-llahu shpalosi edhe *perden e kohës* për Muhammedin s.a.v.s. Ai i shpalosi atij një nga gjërat më delikate dhe shumë precize të vet qenies njerzore.

Para se të filloj të flas rreth kësaj teme ju vë në dijeni se Kur'ani është fjalë e All-llahut dhe leximi i tij është adhurim, ai është i pa zëvendësuar dhe i pa ndryshuar dhe askush nuk do t'ia dalë ta ndryshojë apo devijojë ate. Ky është argumenti i vetëm i gjallë që dëshmon vërtetësinë e

---

<sup>61</sup> Kur'an, sure 19 Merjem, ajeti 34

Muhammedit s.a.v.s. Sikur që edhe një thënje e vetme e cila është thënë në Kur'an të jetë e pasaktë, kjo do të nënkuptonte shkatrimin e fesë islame.

Pasi u sqarua rreziku rreth Kur'anit themi se, po ky Kur'an thotë:

“...dhe në vetëvete thonë: përse All-llahu nuk na ndëshkon neve...”<sup>62</sup>

Ç'kuptojmë nga kjo? Kjo nënkupton dëshirë për sfidë. Kur'ani nuk ju thotë atyre se e hapa perden e kohës së kaluar, Unë ju kisha parainformuar për ngjarjet e të parëve. Asesi nuk iu thotë se do ta hapë perden e vendit. Ju ka paralajmëruar për sa u ndodhi atyre në një nga fshatrat e ju nuk i kishit parë. Por ju thotë: Do ta hapi perden e vet qenies njerëzore dhe do t'ju paralajmëroj për ç'ka keni në qeniet tuaja dhe ç'keni në zemrat tuaja dhe çka përshpërisni në vete duke i përpëlitur buzët. Ju mjaftonte atyre që ta përgënjeshtrojnë Muhammedin duke i thënë se kjo që ju thoni nuk është e vërtetë, kjo nuk ka ndodhur me ne. Sikur mos të thonin nga mbrendia e tyre kjo do të ishte argumenti më i fortë i tyre për ta përgënjeshtruar Muhammedin s.a.v.s. dhe të thonin se kjo s'është e vërtetë. Me shpalimin e perdes së vendit Kur'ani depërtoi në brendinë e vet qenies njerëzore. Në brendi të cila qenieve? Në brenditë e atyre që mohojnë Zotin, ateistëve të cilëve ju konvenon shkatrimi i Islamit i cili nuk zëvendësohet dhe as nuk ndryshohet. Ai iu drejtohet atyre duke thënë:

Sure 58 el Muxhadele, ajeti 8

---

<sup>62</sup> Kur'an, sure 58 el Muxhadele, ajeti 8

“ A nuk i sheh ata, të cilët u ndaluan të bëjnë biseda të fshehta, se si, përsëri, kthehen kah ajo ndalesë, dhe bisedojnë rreth asaj që është mëkat, urrejtje dhe mosbindje ndaj Pejgamberit? Dhe kur vijnë tek ti, të përshëndesin me ato fjalë të cilat All-llahu nuk të përshëndet ty, dhe në vete thonë: Përse All-llahu nuk na ndëshkon neve për këtë që po flasim? Mjaft është për ta xhehennemi të cilët do të hidhen, dhe (ai, xhehennemi) sa vend i shëmtuar që është”.

Kjo është ajo që do të ndodhë me ateistat, a mund të paramendohet ndonjë sfidë më e madhe se kjo rreth shpalosjes së perdes së vendit (regjionit). Kjo është një sfidë e cila i tejkalon të gjitha mundësitë e çdo zbulimi njerëzor, që është arritur nëpërmjet shkencës deri më ditët e sotme, në mposhtjen e perdes së vendit, gjegjësisht regjionit.

## **BETOHEN RREJSHËM**

Sfida doli sheshazi ngase pabesimtarët kishin sekretet e tyre dhe ishin shumë të kujdesshëm. Njeriu i cili është i fshehur dhe ka sekretet e veta duke qenë se është pabesimtar, vjen dhe betohet para teje duke pohuar vërtetësinë e diçkaje. Ndërkaq në mbrendinë e tij konsiderohet si e pa vërtetë. Duke qenë se është i kujdesshëm para masës ai mundohet të jetë bindës në atë që pohon dhe përdor betimin.

Këtu All-llahu i Lartësuar me anë të Kur’anit e shpalos të qenurit e këtij lloji njeriu, dhe nxjerr në pah ate dëshirë të sfidës së tyre duke ju thënë:

“...dhe ata do të përbetohen në All-llahun (duke thënë):sikur të kishim mundësi do të dilnim me ju, ata shkatrojnë vetet e tyre kurse All-llahu e din se ata janë gënjeshtarë”.<sup>63</sup>

“Përbetohen para jush që ju të jeni të kënaqur me ta. Por sado që ju të pëlqeni me ta, vërtetë All-llahu nuk parapëlqen popullin ngatrrëstarë”.<sup>64</sup>

Gjithashtu thotë:

“...dhe betohen rrejtshëm duke qenë të vetëdëshëm”.<sup>65</sup>

All-llahu xh.sh. duke dashur të zbulojë të qenurit e gënjeshtreve të tyre ndaj fesë thotë:

“Dhe sikur të dëshirojmë Ne, do të tregonim ty për ata si dhe do t’i njihje ata nga (shenjat) fytyrat e tyre. Dhe ti do t’i njihje ata me anë të mënyrës së të folurit të tyre...”<sup>66</sup>

Kështu All-llahu i thotë peygamberit të Tij për hipokritët, ti do ti njohësh ata nga mënyra e të folurit. Ishte i dukshëm cinizmi tyre gjate shqiptimit të Kur’anit. Kjo mënyrë ishte alternative. Ata kishin kompetenca të vepronin ose të pengonin veprimet e tyre të mëtutjeshme. All-llahu kur i zbriti këto ajete veprimet e tyre ishin të pa përfunduara. Ata habiteshin me mënyrën e ajeteve para se të vendosnin të vepronin për ta kryer atë. Ata kishin kohë për zgjidhje, alternativa ishte e hapur për ta, ata kishin kohë për ta ndaluar veten. Por ata vazhdonin të vepronin ashtu siç kishte

---

<sup>63</sup> Kur’an, sure 9 el Toube, ajeti 42

<sup>64</sup> Kur’an, sure 9 el Toube, ajeti 96

<sup>65</sup> Kur’an, sure 58 el Muxhadele, ajeti 14

<sup>66</sup> Kur’an, sure 47 Muhammed, ajeti 30

paralajmëruar All-llahu në Kur'anin e madhëruar, duke mos qenë në gjendje të ndryshonin kursin e tyre, bile, All-llahu na tregon brendësinë e të menduarit të tyre edhe pse ata nuk kishin folur asgjë nga të menduarit e tyre. Sekretet është dy llojesh:

Sekreti në mes meje dhe teje dhe të cilën sekretet nuk e di askush përveç unë dhe ti, si shokë ose si aleat.

Sekreti në zemrën time të cilën nuk e di askush tjetër përveç meje në botë.

All-llahu këtë lloj sekretit të dytë të tyre e përhapi dhe parainformoi. Në këtë gjendje unë si i akuzuar kisha mundësi ta përgënjeshtroj atë thënjë. Askush nuk e dinte këtë sekret përveç meje. Por çndodhi? Unë stepem i hutuar nga thënjet e Kur'anit se si paralajmëroi ate ç'ka kisha në brendi. Atë nuk ia kisha treguar askujt, pra si mos të jam në gjendje ta përgënjeshtroj ate edhe pse disponoja argumente të them se është gënjeshtër e kulluar. Hipokritët e cilësuar nga Kur'ani kishin ardhur për të përgënjeshtroar por kur All-llahu zbuloi sekretet e tyre u stepen dhe nuk qenë në gjendje ta përgënjeshtrojnë ate. Për çudi, All-llahu thotë se ata do të thonë dhe do të veprojnë kështu. Do të, janë bashkim shenjash të cilat tregojnë kohën e ardhme, tregojnë për një vepër që do të vijë. Pas gjithë kësaj ata nuk qenë në gjendje ta ndalojnë veten nga ajo që e paralajmëroi All-llahu i Lartësuar se ata do të thonë një gjë të tillë. Sikur ta ndalonin veten, të heshtnin, sikur të veprojnë kundër thënies së paralajmëruar nga All-llahu do të ishte shkatërruar feja, nuk do të kishim fe të vërtetë të All-llahut.

Shihet se Kur'ani foli për pabesimtarët, e hapi perden e qenies së tyre, nxori ç'kishin në zemër dhe i turpëroi para njerëzimit. Paralajmëroi gënjeshtret e tyre e përhapi botërisht hipokrizinë e tyre. Sikur të mos ishte ashtu ata do të thonin: ne nuk jemi gënjeshtarë por, ne jemi të drejtë,

kurse për atë se ç'thotë Muhammedi se i shpallet nga All-llahu është e pa saktë. Por ja, ajo që ndodhi ishte pikërisht ashtu siç tha All-llahu, ata u magjepsën kur ndëgjuan atë sekret të tyre dhe nuk qenë në gjendje të përgjigjen. Ata u stepen nga ato thënie të All-llahut sepse u turpëruan para masës mbarë. Ata nuk kishin se çka të thonin, përpos t'i ulnin kokat pas asaj që u shpall. Sikur Kur'ani mos t'ishte nga All-llahu, nuk do të dihej brendia e të menduarit të tyre, që është një nga sekretet më të mëdha të botës, gjë që deri sot as shkenca nuk ka arritur ta zbulojë. Por ja pra, Kur'ani i sfidon edhe në këtë mënyre duke ju thënë, se Kur'ani është libër, e leximi tij është adhurim deri në ditën e Gjykimit. Është libër që nuk mund të zëvendësohet, madje të ndysohet një shkronjë e vetme. Është libër i cili e zbulon brendinë e njeriut, i turpëron ata pabesimtarë ç'kanë nga sekretet e tyre. Ai nuk frikësohet nga sekretet e tyre, edhe pse ata betohen rrejtshëm, në emër të All-llahut që t'u besojë njerëzimi. Kur'ani i zhveshi të gjithë këta. Vallë pretendoni në një mrekulli më të madhe se kjo?!

## ZHVESHJA E NJË TË ARDHMEJE

Kur'ani shpalosi perden e ardhmërisë. Duhet që kjo temë të shpjegohet në disa etapa.

Në etapën: koha koherente, qëllimi ishte që bashkohanikët e shpalljes, qofshin besimtarë ose pabesimtarë të njiheshin me vërtetësinë e Kur'anit.

Në etapën: koha e ardhme e largët, qëllimi ishte të provohej vërtetësia e Kur'anit në të gjitha kohërat që do të pasojnë pas shpalljes.

Ky pra, është libri i vërtetë i All-llahut. Sfida këtu ishte dy llojesh për një të ardhme të afërt, si dhe për gjeneratat e më vona. Dëshiroj t'ju paralajmëroj për një gjë shumë të nevojshme, për përdorimin e shkronjës Sin që ka kuptim(do të) në Kur'an. Siç dihet nga gramatika arabe, SIN nuk shfrytëzohet ndryshe por veçse kur tregon ngjarjet e kohës së ardhme. Kur'ani është i mbrojtur nga çdo shtrembërim dhe leximi tij është adhurim. Ai do të vazhdojë të jetë i mbrojtur deri në Ditën e Gjykimit. Kjo nënkupton se ai nuk pranon ndryshime, zëvendësime ose mohime nga kushdo qoftë. Ai lexohet ashtu si ka zbritur. Paralajmërimet e ngjarjeve në Kur'an janë pjesë e besimit. Kjo edhe mund ta dëmtojë fenë, që në brendësi të saj, atëherë kur vërtetohet se ajo që është paralajmëruar me Kur'an, nuk është e vërtetë. Autori i Kur'anit është i padyshimtë dhe i bindur, se një paralajmërim i tillë do të ndodhë në një të ardhme. Cili nga njerëzit mund të na bindë se ç'mund të ndodhë pas një ore, ose ç'mund të thuhet për paralajmërimet e disa ditëve, ose viteve. Pa dyshim përgjigja do të ishte askush.

Forca e njeriut për ndërtimin e ngjarjeve është e kufizuar. Pengues për të është koha, është vendi. Nëse pohoj, se do ta ndërtoj pas një viti një ndërtesë në këtë vend, unë nuk mund t'ju siguroj, se do të jetoj vetë pas një ore. Nuk mund të gjykoj nëse do të ekzistoj atje ose jo. Ndodh që urbanistika ka planifikuar të ndërtojë një spital, treg, ose autostradë. Unë pra, nuk mund të garantoj ato çka mund të ndodhin pas një të ardhme të kufizuar. Ai i cili mund të jetë bindës për këtë, është ai i cili e disponon atë forcë. Vetëm ai është i cili do të jetë bindës, se kjo mund të ndodhë pas një kohe të paracaktuar. Ai i cili do të mund ta bëjë këtë, është vetëm All-llahu i Lartësuar, sikur ato ngjarje t'i përkasin edhe pas mijëra vitesh. Ajo është mbi forcën e mbarë njerëzimit. Nëse Kur'ani ka paralajmëruar, se një gjë do të ndodhë pas disa vitesh, e ajo nuk ndodhi siç tha, por ndodhi pas mijëra vitesh, nuk llogaritet i shenjtë. Por, atë që pohon i

Lartësuari, Ai është plotbindës, dhe ajo domosdo do të ndodhë ashtu siç Ai pohon. Të shohim thënien e të Lartësuarit :

“ Grupi do të pësojë disfatë duke u kthyer pas”.<sup>67</sup>

Kjo sure ka zbritur në Mekë, kur muslimanët ishin fare pak, dhe të dobët. Omeri i biri Khatabit tha: cili është ai grup i cili do të mundet, kur ne mezi mbajmë vetveten. Kështu paralajmëroi Kur’ani, se islami do të ngadhënjejë në Mekë. Këto grupe, të cilët do të bashkohen në luftimin e islamit në Mekë, do të pësojnë disfatë, dhe do të ikin mbrapa. Paralajmërimi ndodhi pikërisht atëherë, kur muslimanët ishin pakicë dhe të dobët. Nuk ishin në gjendje të mbrojnë as veten e tyre. Atyre u paraqitet një ngjarje e cila ishte bindëse, sepse ai që e thoshte, e do ta realizonte atë, ishte All-llahu. Më vonë shohim çudinë.

Velid ibn Mugire, armiku i përbetuar i islamit, ishte i njohur për arrogancën dhe urrejtjet e tij. Kur’ani thotë, ky njeri është megaloman dhe egoist.

“Ne do ta dëmkosim në turinin e tij”<sup>68</sup>

Ai do të vritet nga goditjet në hundë. Kur’ani përcakton vendin e goditjeve. Dhe vërtetë, në luftën e Bedrit, u gjet i vrarë dhe përcudi, goditjet i kishte marrë në hundë (turinj). Cili është, ai që mund të tregojë goditjet dhe përcaktimet e tyre. Cili është ai, që mund të garantojë, se çfarë do të ndodhë pas edhe një ore të vetme.

---

<sup>67</sup> Kur’an, sure 54 el Kamer, ajeti 45

<sup>68</sup> Kur’an, sure 68 el Kalem, ajeti 16

## SFIDOI ARMIQTË E ALL-LLAHUT

Tani të shohim ajetin tjetër i cili u lexua nga Muhammedi s.a.v.s.

“Në emër të All-llahut Mëshiruesit Mëshirëplotit

Ju thafshin duart Ebu Lehebit, dhe atij iu thane. Nuk e ndihmoi atë pasuria e tij që e kishte fituar. Do të hidhet në zjarr flakërues. Kurse gruaja e tij, një bartëse e krandeve që në qafë ka litarin (e fortë) të përdredhur”.<sup>69</sup>

Ja ky është Kur’ani, për cilin flet kështu? Ky ishte xhaxhai i Pejgamberit s.a.v.s. dhe armiku i islamit. A nuk kishte mundësi që Ebu Lehebi ta sulmonte ilsamin në këtë ajet! Ajeti e ka paralajmëruar se do të vdes si qafir<sup>70</sup>, politeist, do të dënohet dhembshëm. I mjaftonte ebu Lehebit, t’i bashkohej një grupi muslimanësh dhe të shprehej se nuk është i tillë, bile, edhe të dëshmojë së është musliman, së paku të deklarohet qoftë edhe për hipokrizi sa për sy e faqe, që me këtë ta njolloste, bile, ta shkatrronte islamin fare. Pas kësaj të qëndronte para shoqërisë kryelartë duke thënë, se Muhammedi më ka cilësuar si qafir, dhe më ka dënuar me xhehennem, por ja, unë u deklarova se jamë musliman, kurse Muhammedi është renegat. Sikur të kishte zgjuarsia Ebu Lehebi, do ta kishte bërë këtë. Por ja që nuk e bëri, mbeti dhe vdiq qafir, politeist. Ishte e mundur që ebu Lehebi të bëhej musliman sikur edhe të tjerët, si Khalid, ebu Velid, Amër ibn As, Umer ibn Khatib etj. Pse pikërisht u paralajmërua, se ebu Lehebi do të vdes si qafir. Ai së

---

<sup>69</sup> Kur’an, sure 111 el Leheb

<sup>70</sup> Qafir- mohues i monotoizmit të pastërt (ateist).

paku mundej të deklarohej si hipokrit, por u paralajmërua si qafir. Mrekullia e Kur'anit pikërisht këtu qëndron, paralajmëron për atë që do të ndodhë. Sfidoi njeriun i cili kishte mundësi alternative, mjaftonte të deklarohej. Por, ai që tha ishte i bindur se ajo do të ndodhë, ashtu siç ka thënë Ai. Kjo tani po kuptohet pse ndodhi? Sepse ai është Kur'an i cili di se koka e ebu Lehebit nuk e pranon një gjë të tillë dhe nuk është në gjendje ta përgënjështrojë Kur'anin. A kërkohet një mrekulli më e madhe se kjo.

## SFIDOI JO ARABËT

Tani të shohim se ç'kemi në Kur'an, për arabët dhe jo arabët në atë gjeneratë dhe të gjitha gjeneratat tjera pas tyre.

Të shohim se ç'thotë Kur'ani për rregullat e All-llahut dhe proceset e tij në kohë të cilat ishin inekzistente për njerëzimin në atë kohë si dhe pas tyre. Kemi shumë shembuj por në pamundësi t'i theksojmë të tërat, do të përqëndrohemi në mrekullitë e Kur'anit për jo arabët. Romakët dhe Persët ishin dy popuj që sundonin botën, ishin dy superfuqitë e kohës. Romakët besonin në Zot, kurse persët ishin politeistë dhe ateistë. Më afër zemrës së besimtarëve kuptohet, se cilët ishin në atë kohë. Persët ishin të pa fe dhe këta ishin më afër zemrës së ateistëve. U ndez një luftë në mes këtyre dy superfuqive. U shkatërruan romakët dhe fituan persët. Ishte gëzim i madh, sepse ngadhnyen ateistët kundrejt teistëve. Ishte dëshpruese humbja e një grupi të teistëve. All-llahu ua lehtësoi humbjen atyre, duke ju thënë nëpërmjet Librit të Vet, i cili është i mbrojtur nga çdo

shtrembërim, nuk mund të zëvendësohet dhe të ndryshohet Fjala e Tij, leximi i tij konsiderohet adhurim, e Ai thotë:

“Në emër të All-llahut Mëshiruesit të përgjithshëm dhe Mëshirëplotit. Elif, Lam, Mim. U mposhtën romakët. Në tokën më të afërt, dhe ata, pas disfatës së tyre do të triumfojnë përsëri. Brenda disa vitesh. Ç’ështëja është në All-llahun që nga para ashtu edhe nga prapa, dhe atëherë besimtarët do të gëzohen. Me ndihmën e All-llahut do të ndihmohen ata që dëshiron, sepse Ai është i Plotëfuqishëm dhe Mëshirëplotë.”<sup>71</sup>

Kur’ani shkon edhe më tutje duke sfiduar :

“All-llahu premtoi e All-llahu nuk e thyen premtimin por, shumica e njerëzve nuk e dinë”<sup>72</sup>.

Ç’është ky premtim. A mundet që Muhammedi s.a.v.s. të paralajmërojë për rezultatin e një beteje, e cila do të ndodhë në mes romakëve dhe persianëve, dhe atë pas disa vitesh. A është në gjendje një komandant të paralajmërojë rezultatin e një beteje luftarake, qoftë edhe pas një ore të vetme. E ç’mendon ti kur të jepet rezultati i betejës, e cila do të ndodhë pas disa vitesh dhe atë në mes dy superfuqive të kohës dhe përcakton fitoren e romakëve. A ishte në gjendje Muhammedi s.a.v.s. të sigurojë ekzistencën e tij, si dhe të dëshmojë këtë beteje pas disa vitesh. Kjo iu komunikua Ebu Bekrit r.a. ai vuri bast për vërtetësinë e kësaj beteje se do të ndodh, meqenëse Kur’ani është parainformues. Kjo u bë një ç’ështëje besimi, bile shumë madhore. Ja pra ky është Kur’ani, fjalë e All-llahut, bazë e gjithë imanit. Informon për një vërtetësi që do të ndodhë dhe atë, për jo arabët,

---

<sup>71</sup> Kur’an, sure 30 el Rum, ajeti 1 - 5

<sup>72</sup> Kur’an, sure 30 el Rum, ajeti 6

dhe për brenda një kohe të shkurtër. Mohuesit e fesë deklaroheshin, se ajo që thotë Kur'ani, është gënjeshtër, kurse besimtarët ishin stoik në vërtetësinë e saj. Kështu vunë bast dy persona. A mund të mendohet se çka kishte për të ngjarë sikur mos të ndodhte ajo betejë në mes romakëve dhe persëve, ose sikur të ndodhte beteja dhe prap të shkatroheshin romakët. A do të kishte njeri që të besonte edhe më tutje Kur'anin, ose fenë e re. Sikur të ishte Muhammedi autori i Kur'anit, pse i duhej të rrezikonte veten dhe rrugën e tij. Askush nuk kërkonte shpjegime dhe gjëra të tilla, a është normale të rrezikohet feja e re e tij, për gjëra që nuk kërkoheshin. Askush nuk e sfidoi atë për gjëra të tilla. Por jo, thënësi është All-llahu dhe zbatuesi është All-llahu xh.sh. Ja pra, ishte e sigurt, se kjo ngjarje do të ndodhë, të bindur në këtë, sepse Ai qëndron mbi kohën dhe vendin. Ai nuk ka kurrëfarë pengese, dhe Ai është arkitekti dhe zbatuesi i projektit. Kështu që vërtetë ndodhi lufta dhe fituan romakët ashtu si paralajmëroi Kur'ani.

Kështu sfidoi Kur'ani pabesimtarët dhe jo muslimanët në kohën e revelatës<sup>73</sup> së tij. Ai nuk i sfidoi vetëm arabët, por ai sfidoi të gjithë si pabesimtarët ashtu edhe besimtarët arab dhe jo arab. Ju paralajmëroi, se kjo ngjarje do të ndodhë pas shtatë ose tetë vjitesh. Sfidoi ata mbase do të mbushen mend dhe do të besojnë!

Nëse konsiderojmë, se kemi mbaruar me këtë, atëherë themi se Kur'ani i sfidoi arabët dhe jo arabët gjatë kohës së revelimit të tij. Por ne thamë, se Kur'ani është transcendental dhe nuk përkufizohet me kohën dhe vendin. Ai do të vazhdojë të egzistojë gjer në ditën e kiametit. Si është e mundur të sfidojë gjeneratat e mëtejme? Me siguri që Kur'ani, do të ketë mrekullinë në vazhdimësi. I ofron të dhëna një gjenerate çka nuk ia ka dhënë gjeneratës së më parshme.

---

<sup>73</sup> Revelatë – shpallje, zbritja e vargjeve (të Kur'anit)

Kur'ani kishte dhe ka gjëra, të cilat sikur të interpretoheshin në atë kohë, do të ishin të pakapshme. Këto të dhëna, janë interpretuar në kohën e duhur. Ai ka sfiduar dhe sfidon gjeneratat edhe në ditët e sotme dhe ditët e ardhshme deri në ditën e Gjykimit.

## **KUR'ANI TREGON PËR TË HUMBURIT**

Dalja në pah e ligjit, koincidencës<sup>74</sup>, dhe teorisë së Darvinit, si dhe krijimi i materies para shpirtit, dhe të gjitha ato të cilat të shpijnë deri në luhatje të besimit, dhe dyshim në ekzistencën e All-llahut të Lartësuar, të gjitha këto janë të theksuar në Kur'an, dhe është paralajmëruar për të humburit, të cilët do të vijnë e të interpretojnë gënjeshtër rreth krijimit të qiejve dhe tokës, si dhe rreth krijimit të njeriut.

Kur'ani sikur të mos fliste me pecizitet të plotë rreth embrionit, ai do t'iu ofronte shërbim armiqëve të vet që ta shkatërronin atë. Ky libër do të vazhdojë kështu gjer në fund. Sikur, pas disa shekujsh, shkenca të vërtetojë pasaktësinë e Kur'anit, do të zhdukej në tërësi. Këtu kemi të bëjmë me thëniet e All-llahut dhe arkitekturën e Tij, prandaj s'ka dyshim në të.

Mrekullia e Kur'anit nuk shterrohet, dhe nuk mbaron. Nëse ky libër i sfidoi pabesimtarët gjatë kohës së revelatës dhe paralajmëroi ç'mbajnë zemrat e tyre, ky libër i sfidon edhe mohuesit e tij,

---

<sup>74</sup> Rastësisë

qofshin edhe të gjeneratave tona, bile ai ju ofron shërbim. Rreth vërtetësisë së imanit, (besimit) kohërat thujase nuk ndryshojnë, nga koha e zbritjes ose shpalljes. Qëllimi i mohuesve dhe i të humburve është, që ata të vazhdojnë ta shpallin inekzistimin e All-llahut dhe këtë fe. Por ja që Kur'an i edhe pas 14 shekujsh shërben në vërtetësimin e ekzistencës së All-llahut. Që edhe sot besohet, se ky Kur'an është fjalë e All-llahut, i reveluar në Muhammedin s.a.v.s. dhe kjo do të jetë tema jonë.

All-llahu thotë: "... Porse shumica e njerëzve nuk e dinë "

Si dhe thënia:

"Ata kanë dije sipërfaqësore nga jeta e (përditshme) kësaj bote, por ata për ahiretin janë injorant fare".<sup>75</sup>

Mësuesi mund të më jep njohuri të përcipta nga jeta jonë e përditshme, por ai gjithsesi është injorant ndaj ahiretit. Sado të jetë i ditur, ai di vetëm për këtë botë. Dituria është dy llojesh:

Lloji i cili jep mundësi hulumtimi, sipas dëshirës tënde, pa kufi dhe pa rregulla dhe,

Nuk të jepet mundësia e hulumtimit, sepse nuk di fare për të.

Lloji i dytë është forma urdhërore, ku të thuhet; bëje këtë dhe mos e bëj këtë, afrohu tek unë për kaq dhe largohu për kaq. Këto nuk janë rezultat i yti, sepse i Adhuruari i ofron robit për sa ta Lartësojnë Ate. Polemika rreth një problemi, duhet të jetë në mes të barabartëve ose të afërt në

---

<sup>75</sup> Kur'an, sure 30 el Rum, ajeti 7

pamje. Kush nga ne posedon mendje të afërt me All-llahun e Lartësuar? Kuptohet askush. Prandaj ne e marrim si shenjë të urdhërimit, bëje ose mos e bëj atë.

Lloji i parë ishte mundësia e hulumtimit në mrekullitë e All-llahut në kozmos. Nga unë kërkohet që të hulumtoj dhe të shpresoj derisa të arrij në rezultate, me të cilat do të kemi dobi. Për ta përkufizuar këtë temë shohim se Kur’ani na thotë:

“A nuk e shikon se All-llahu lëshon ujë prej qielli (resë) dhe Ne nga ai nxjerrim frute me ngjyra të llojlojshme, dhe ka male me rrugë të bardha, të kuqe dhe korb të zeza, si dhe ngjyra të ndryshme. Si dhe nga njerëzit dhe gjallesa e kafshë gjithashtu të ngjyrave të ndryshme...”<sup>76</sup>

Kështu vërejmë, se All-llahu na ka treguar edhe për materiet organike dhe inorganike, për florën dhe faunën, si dhe për njerëzit. Pas gjithë kësaj, po në të njëjtin ajet thotë:

“vërtetë All-llahut, nga robërit e Tij, ia kanë frikën dijetarët”

Cilët dijetarët ia kanë frikën? Ata të cilët mirren me studimin e krijesave të All-llahut siç janë: krijimet organike dhe inorganike apo florën dhe faunën. Për këtë arsye, All-llahu i Lartësuar bëri llojlojshmëri nga një lloj i vetëm, sepse sikur të ishte një lloj i vetëm nuk do të kishte kundërshtime.

Thënja e All-llahut, “...fruta me ngjyra të llojloshme ...”, ishte e domosdoshme që të vështrojmë dhe të pyesim pse ngjyra të llojlojshme, cilat janë marrëdhëniet ndërmjet ngjyrave dhe natyrës, psh. kur ushqehet bima ekziston. Nga studimet që janë bërë bima ushqehet nga rrënjët

---

<sup>76</sup> Kur’an, sure 35 el fatir, ajeti 27,28

adventive<sup>77</sup>. Të ndalemi vetëm pak. Këto rrënjë adventive a dallohen? Por a mund kush ti dallojë ato? Marrim një enë dhe fusim në të lëng të dendur, ashtuqë ky lëng të ketë elemente të ndryshme, e më pas t'i sjellim këto rrënjë dhe t'i fusim në këtë enë. Pas pak kohe do të shohim se niveli ujit është ngritur më lartë se vetë ena. Shtrohet pyetja, a mund të dallohet se çfarë lloi të lëngut ka thithur secila rrënjë. Apo secila rrënjë ka thithur të gjitha llojet e lëngut ashtu të dendur. Por bimët nuk janë kështu, nëse mbjellim kungullin afër pishës, rezultati do të jetë njëra e ëmbël kurse tjetra e idhët, edhe pse që të dy ushqehen nga i njëjti ushqim, burim i të njëjtit lloj në tokë, dhe që të dyja ishin pranë njëri tjetrit. Nënkuptomë se këtu kemi të bëjmë me parapëlqim të shijes së ushqimit, kështu konstatojmë se kemi të bëjmë më një veçori të zgjedhjes. Zgjedhje, që do të thotë, të parapëlqesh mes alternativave të cilat të ofrohen, çka do të thotë se e merr një nga ato që të pëlqejnë dhe e le tjetrën. Për këtë arsye All-llahu i Lartësuar thotë:

“...ujiten nga uji i njëjtë, mirëpo, (frutin e disave)e parapëlqejnë për ta ngrënë më shumë nga disa të tjerat. Edhe në këtë ka shumë shenja për njerëzit e ditur”.<sup>78</sup>

Por, cilësia e rrënjëve të holla vepron me të gjitha lëngjet pa dallim. Nga kjo nënkuptomë se cilësia është tjetër gjë, kurse zgjedhja e bimës për të thithur llojin për ushqim të tyre, është diçka krejtësisht tjetër. Rrënja thithë atë për të cilën ka nevojë dhe të cilën ajo e dëshiron.

Tani të shohim për materiet inorganike.

---

<sup>77</sup> Degëza shumë të imta të rrënjëve,

<sup>78</sup> Kur'an, sure 13 el Rad, ajeti 4

“...ka male me rrugë të bardha e të kuqe si dhe ngjyra të ndryshme që janë të korbit dhe të zeza”<sup>79</sup>.

Me këtë merret shkenca e inorganikës dhe organikës. Kjo shkencë tani përmbanë libra të shumta, ajo mirret edhe me njeriun si dhe të gjitha llojet ekzistuese dhe pas të gjitha këtyre më në fund Kur’ani ju thotë:

“...vërtetë nga robërit e Tij, All-llahut, ia kanë frikën vetëm dijetarët...”

Cilët dijetarë? Ja pra në të gjitha këto shkenca. Fjala dijetarë nënkupton të gjithë ata të cilët hulumtojnë në krijesat e All-llahut. Qofshin ata të organikës, inorganikës, të florës ose faunës. Mendja e mprehtë mund të arrijë në këto njohuri duke përdorur vërejtjet dhe analizat. Argument për këtë është ajo se, gjatë historisë, është paraqitur gjithnjë mundësia për zbulim, dhe ajo që është zbuluar i ka shërbyer njeriut. E pra ky është rezultat i njeriut i cili ka qenë studiues i mirë dhe preciz, e jo si ata të cilët kanë kaluar nëpër të sikur shumica e njerëzve. Dituria e ka vendin në laborator, në vrojtime, studime dhe në eksperimente.

---

<sup>79</sup> Kur’an, sure 35 el Fatir, ajeti 27

## KUR CENOJMË PA ARGUMENTE

Nganjëherë e teprojmë me tema eksperimentuese dhe laboratore. Nëse themi se shpirti është para materies ose materia para shpirtit, atëherë kemi të bëjmë me një temë e cila duhet të studiohet që në formimin e elementeve të para të njeriut. Dhe këtë kohë nuk e ka dëshmuar askush, si dhe nuk mund të vërtetohet eksperimentalisht. Kjo i përket diturisë së All-llahut, Ai është krijuesi dhe vetëm Ai është kompetent të na tregojë mënyrën e krijimit. Për këtë arsye All-llahu thotë:

“Unë nuk i kam marrë ata për dëshmitarë në rastin e krijimit të qiejve dhe tokës, e as në rastin e krijimit të tyre...”<sup>80</sup>

Kësaj pyetjeje, nuk mund t’i përgjigjet asnjë shkencë njerëzore. Nuk kemi prezentuar dhe nuk e kemi parë, si dhe s’jemi në gjendje të bëjmë eksperimente në të. Por argumenti i vetëm është se ne kemi dëgjuar atë nga All-llahu. Kjo është një e pa njohur, e meqë është një e pa njohur për ne, atëherë All-llahu na tregoi se si u krijuam. Kurse, sa i përket vetes sime, unë nuk di se si u krijova. Unë nuk mund të shpjegoj shkencërisht, dy elementet prej të cilave është krijuar njeriu. Kështuqë, nuk mund të di se cili është i pari. Nëse dikush është i vendosur të studiojë rreth kësaj, do ti themi se vetëm do të humb kohë më kot, sepse kjo nuk i shërben aspak dhe as nuk i bën dëm ngase ai nuk është në gjendje të vërtetojë shkencëtarisht. Me anë të eksperimentit do të mund të futem në laborator me elementin e materies, por, nuk mundem që ta sjell shpirtin në këtë laborator.

---

<sup>80</sup> Kur’an, sure 18 el Kehf ajeti 51

Shkenca do të detyrohet të sjellë materien në tërësi, pastaj atë materie ta fusë në një laborator më masiv, dhe të sjellë realitetin e këtij masiviteti. A nuk është kjo e vërtetë. Kjo argumentohet me atë se krahas asaj se kemi qendra rivale për eksperimente, ato nuk ndryshojnë në teoritë shkencore, ato ndryshojnë në drejtim, frymëzim dhe teori. Nuk mund të thuhet se ekziston elektricitet amerikan dhe elektricitet rus, si dhe nuk mund të thuhet se ekziston kimi gjermane e as kimi angleze. Shkenca e kimisë, në çdo shtet të botës i nënshtrohet eksperimentit masiv, i cili nuk ka frymëzim në të. Pas gjithë kësaj, në fund do të kemi vetëm një rezultat qoftë ai i laboratoreve amerikane, angleze, ruse ose çfarëdo laboratorit tjetër në botë.

Polemika fillon pikërisht aty se kemi ndërhyrje të rrymave dhe teorive të ndryshme. Nëse shohim rrymat, frymëzimet vetjake dhe teoritë e ndryshme, do të shohim se janë të kundërta, nuk janë të ndryshme. Frymëzimet personale ndërhyjnë këtu dhe shkatërrojnë çdo mundësi shkencore dhe e humbin realitetin.

## **FEMOHUESIT VËRTETOJNË KUR'ANIN**

Nëse njeriun e marrim si shembull, ne e marrim si kreaturë e All-llahut. Çfarë tha All-llahu për njeriun? E kam krijuar nga dheu, pastaj nga balta, pastaj nga balta e fortë dhe e zezë, dhe në fund nga balta e pjekur. Të gjitha këto thënie nuk janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Nuk janë në kundërshtim edhe me vet materien e krijuar – dheun. All-llahu na i bën me dije etapat e zhvillimit

të materies së dheut në baltë, baltë e fortë e zezë dhe baltë e pjekur. Këto ishin etapat të cilat janë zhvilluar gjatë procesit të krijimit të trupit të njeriut nga dheu deri para dhënies së shpirtit.

“Unë nuk i kam marrë ata për dëshmitarë me rastin e krijimit të qiejve dhe tokës, e as me rastin e krijimit të tyre dhe nuk kisha nevojë për mbështetje nga të paudhët..”(Sure 18 el kehf, ajeti 51)

Ç’kuptim ka fjala të paudhët ose të humburit? Ajo që na është afruar nga All-llahu është e vërtetë, kurse njeriu është ai i cili dëshiron të më humbë dhe është ai i cili më ofron paudhësinë.

Fjala e All-llahut : “dhe nuk kisha nevojë për mbështetje nga të paudhët...”

Nga kjo kuptojmë, se në momentin e krijimit të njeriut, nuk ka kërkuar ndihmë, këshillim ose sqarim nga këta të paudhë. Sikur kjo të kishte ndodhur, ato do të mund t’u tregonin mënyrën e krijimit të tokës dhe qiellit, dhe mënyrën se si jemi krijuar, atëherë do të kishit arësye për të besuar, por kjo nuk ka ndodhur, dhe gjithë çka ata ju shpjegojnë mbi këtë, janë gjepura, të pavërteta, e kjo të shpie në errësirë dhe paudhësi. Kjo është një mrekulli prej mrekullirave të All-llahut, kurse këta të paudhë do të mundohen gjithnjë t’ju hipnotizojnë me iracionalitete për mënyrën e krijimit. Ju mos u besoni, sepse ata nuk janë dëshmitarë të kohës, ata në atë kohë, as që kanë ekzistuar. Sikur të ndodhte që këta të paudhë, mos të orvateshin në paudhësitë e tyre, do të thonim se Kur’ani s’është libër i All-llahut, sepse do të pyetnin, ku janë ata të paudhë. Sikur ata të paudhë të orvateshin në teori të tjera, me prejashtim të krijimit të kozmosit dhe njeriut, prap kishim për të thënë, se Kur’ani është i pasaktë, sepse do të arsyetoheshim me thënien, vërtetë të paudhë, por ata nuk kundërshtojnë me paudhësinë e tyre, krijimin e kozmosit dhe njeriut. Përderisa këta të paudhë japin teoritë e tyre mbi krijimin e kozmosit, si dhe pyetjen, se a është materia para shpirtit ose shpirti para materies, ose ligji i koincidencës, ose teoria e Darvinit e tjera,

nga këto fjalë vëretojnë thëniet e Kur'anit për ta. Thujase këta persona të cilët teorizuan i shërbyen thirrjes islamike me vetëdashje, sepse këta me mohimin e tyre vërtetuan saktësinë e Kur'anit dhe ajetet e t'ia. A ka mrekulli më të madhe se kjo. Duke u orvatur ta kundërshtojnë Kur'anin e madhëruar, ata i bënë shërbim Kur'anit duke qenë në vetëdije të plotë ata, se All-llahu ekziston dhe Kur'ani është libër i Tij. Ata mohojnë Kur'anin duke pohuar se ky qenka një libër i thjeshtë, i vjetëruar, dhe tani nuk i shërben kohës por në realitet ky libër para shumë shekujsh i tregoi njerëzimit, se do të vijnë persona të humbur, dhe ata do të shkruajnë gjeputa, duke ju udhëzuar në errësirë. Kurse unë i mohoj thëniet e tyre, edhe pas një ose shumë shekujsh tjerë, ata janë të paudhë. dhe se thëniet e tyre janë jo të vërteta. Duke qenë se këta dolën me teoritë e tyre për ta shkatërruar programin e All-llahut, këta persona vetëm vërtetuan ajetet e All-llahut të shpallura para 14 shekujsh. Ai na paralajmëroi për kohën dhe orvatjet tuaja për ta ç'orientuar njerëzimin dhe për ta shpërbërë Kur'anin. A vëreni se mohuesit e fesë na shërbejnë në vërtetësinë e besimit tonë të jemi edhe më të përpiktë.

## **KRIJIMI I NJERIUT**

Pa dyshim se krijuesi i njeriut dhe kozmosit është All-llahu xh.sh. Vërtetë, kjo është një nga të panjohurat tona për mënyrën e krijimit. Përderisa All-llahu na ekspozoi këtë sekret, Ai edhe na ndriçoi rrugën e mendjes sonë në atë mënyrë siç e ndiejmë dhe e dëshmojmë. Kjo mënyrë është e përafërt me këtë sekret për të cilën flitet. All-llahu na krijoi nga dheu, pastaj nga balta, pastaj nga balta e kalbëzuar, pastaj nga balta e fortë e pjekur dhe në fund na dhuroi shpirtin.

Nëse marrim dheun dhe i shtojmë ujin, kjo bëhet baltë. E nëse e lëmë të vëshken elementet e baltës, atëherë kjo do të bëhet baltë e kalbëzuar. Nëse e lëmë të thahet, kjo do të bëhet baltë e pjekur. Këto pra ishin etapat e krijimit të trupit të njeriut, njeriut të baltës dhe tokës.

Shtrohet pyetja, cilat janë elementet e jetesës së njeriut? Përgjigja është, dheu dhe balta, nga shtresa pjellore e tokës, e cila jep të gjitha elementet e jetës të cilën ne e përjetojmë. Ajo që e zhvillon materien nga e cila u krijuam, është nga i njëjti lloj i materies. Ajo është balta. Nga analizat e eksperimentuesve, del në pah se trupi i njeriut përbëhet nga 16 elemente. Këto elemente janë oksigjeni dhe të tjerat nga cofinat, të njëjtat elemente të cilat gjenden në tokën humusore (pjellore) të tokës. Elementet e baltës pjellore, qenkan të njëjtat elemente të trupit të njeriut, nga i cili u krijua. Kjo ishte mrekullia e parë dhe kjo del nga vetë eksperimenti i cili nuk kishte përqëllim vëretësinë e Kur'anit ose goditjen e tij, por, ishte një hulumtim shkencorë për tokën.

Argument për mënyrën e krijimit tonë nga All-llahu për ne është vdekja. Vdekja është e kundërta e jetës, nga kjo jetë që e jetojmë. E kundërta e çdo gjëje është ajo që vjen nga formulimi i fundit. Nëse duam të ndërtojmë një pallat, fillojmë nga kati i parë, e nëse duam ta prishim atë, fillojmë nga kati i fundit. Nëse arrij në një vend dhe dua që të kthehem nga ai vend, atëherë do të kthehesha nga pika e fundit ku kam arritur. Hapi i kthimit do të më jep shenjë të kthimit. Ne nuk dinim asgjë nga krijimi i jetës, ngase nuk ishim prezent në atë moment. Por ne e dëshmojmë jetën çdo ditë, kurse vdekja është e kundërta e jetës. Pra, edhe kjo duhet të jetë ajo e kundërta e ndërtimit të fundit. E para që ndodh në vdekje është dalja e shpirtit, pra, ajo e fundit që ka hyrë në trup. Pastaj fillojnë radhazi ato që janë theksuar në ndërtimin e trupit. Shtangia e trupit ose ajo që thamë baltë e forte si e pjekur, pastaj ky trup kalbet dhe bëhet mbeturinë, kjo ishte balta e

kalbëzuar, më pas avullohet uji nga trupi dhe në fund shndërrohet balta në dhe. Pra, etapat e zhdukjes të cilat i shohim çdo ditë, na tregojnë të kundërtën e mënyrës së krijimit. Këtu kemi saktësi në krijim dhe saktësi në mënyrën e krijimit, ashtu siç është e qartë e kundërta e jetës për ne e cila quhet vdekje.

All-llahu i Madhëruar thotë:

“...dhe i kam fry atij nga shpirti Im...”<sup>81</sup>

Fjala nefkh kuptohet si frymëmarrje, që nënkupton një qenie e cila ka dalë nga fryma e atij që ka fryer në të, kështu edhe filloi jeta. Si përfundon jeta? Përgjigja është, nga dalja e kësaj qenie (frumëmarrjeje). Nëse dyshon për një njeri, se a është ndarë nga kjo botë përfundimisht, mjafton që dikush të thotë se nuk merr frymë dhe kjo do të jetë bindëse për ty. Futja e jetës në trup, është hyrja e kësaj fryme (shpirti), ashtu siç tha All-llahu: “... dhe i kam fry atij nga shpirti Im...”, dhe dalja nga kjo, është dalja e kësaj fryme që në fund të përmbillet ashtu siç e paralajmëroi All-llahu xh.sh.

---

<sup>81</sup> Kur’an, sure 15 el Hixhr, ajeti 29

## NJERIU NË BARK TË NËNËS

Të thellohemi më tepër në atë se ç'na thotë Kur'ani mbi zhvillimin e foshnjes në bark të nënës, si dhe ç'na thotë shkencë për zhvillimin e embrionit. Rreth kësaj theksuam diçka nga pjesa tjetër e librit, por, tani do të kthehemi edhe njëherë. Shtrohet pyetja, vallë është orvatur ose jo, që para Kur'anit ose gjatë revelimit të Kur'anit, dikush të shkruajë rreth kësaj teme. Përgjigjeja do të ishte - askush. I pari që foli ishte Kur'ani dhe ky na dha një të pa njohur, sepse krijimi është i panjohur. Përderisa All-llahu i Lartësuar na dha këto etapat e embrionit, është argument që e madhëron dhe tregon forcën dhe diturinë e Tij.

I Lartësuar thotë:

“Pas kësaj Ne e bëmë atë (njeriun, pasardhësin e Ademit) në nutfe (lëngu i ngjizur pas bashkimit të spermës mashkullore me atë femërore), duke e siguruar atë në vend të sigurt (mitër). Mandej, Ne e bëmë Nutfete në Alakaten (shushunjë, copë gjaku të mpiksuar, gjë të varur); mandej atë alakate e bëmë Mudgaten (xhungë mishi, si gjë për të përtypur);mandej Ne atë el Mudgate e bëmë asht pastaj mbështollëm ashtin me mish...”<sup>82</sup>

Shkencë e embriologjisë, këtë nuk e ka njohur më parë, ajo u njoftua tani me këtë. Ashtu siç thamë më herët, Kur'ani është libër, leximi i tij konsiderohet adhurim, ai nuk ndryshon e as nuk

---

<sup>82</sup> Kur'an, sure 23 el Mu'minun, ajeti 13,14 (përkthimi i këtij ajeti është marrë nga libri Udhërfyesi i shkurtër i islamit botim i Gjurma me përkthys Tomor Kastrati.

zëvendësohet. Ajo që është theksuar në Kur'an, do të mbetet deri në ditën e fundit. Kur Kur'ani na tregon diçka, ai sikur kërkon t'i sfidojë shkencat dhe shkencëtarët, deri në ditën e kataklizmës. Atyre sikur dëshiron t'u thotë: “Ja, tani para jush është zhvillimi i embrionit në barkun e nënës, kurse Unë ju kam përmendur etapat në hollësi, këtë nuk e ka shkruar askush më parë, para revelatës së Kur'anit”. Por, kjo nuk u njoh ndër njerëzit edhe pas disa shekujsh. Unë e regjistrova këtë, për arsye, se kur të vijë koha që t'u mundësoj që t'i njihni këto etapa, do të vërtetoheni se autori i Kur'anit është All-llahu xh.sh., ngase askush nga njerëzit nuk mund t'i thotë këto fjalë, kurse All-llahu e garanton vërtetësinë e kësaj ndër gjenerata dhe më vonë. Ai e heq perden e zbulimit, për ta parë njerëzit atë të cilën nuk e kanë ditur. A nuk është ky All-llahu, Ai i cili garanton atë, që njeriu nuk mund të garantojë për të, asnjë njeri sado i ditur të jetë ai? Si mund të garantojë njeriu, se pas një viti, ose dhjetë e qindra vite, nuk do të pësojë ndryshime dhe do të kundërshtohet. Kush e vërteton mos saktësinë e tij.

Sikur fjala mos t'ishte për All-llahun dhe sikur mos t'ishte fjala për një bindje të plotë, të thellë, Kur'ani thujase iu ka dhënë armët për shkatrimin e vet. Mjaftonte që njeriu të thoshte, u vërtetua shkencëtarisht, se etapat e theksuara në Kur'an, nuk janë të vërteta. Do të mjaftonte kjo ta shkatërronte fenë që nga themeli, sepse Kur'ani ju kishte dhënë mohuesve të fesë armën më të fortë. Ai që e ka zbuluar embriologjinë është i bindur në vërtetësinë e Kur'anit, ashtu siç është i bindur, se sado që të zbulojnë gjëra të reja shkencëtarët, ata nuk do të mundën ta përgënjështronjë këtë ajet. Pas hulumtimeve të gjata në këtë shkencë, është vërtetuar për vërtetësinë e Kur'anit që e ka thënë para 14 shekujsh, dhe kjo nuk kundërshtohet për asnjë imtësirë, edhe pse kjo ka qenë një e panjohur, çështje për të cilën nuk ka folur asnjë njeri më parë. Kur'ani këtu na tregoi imtësisht dhe përcaktoi etapat e zhvillimit embrional, dhe më vonë,

shkenca vërtetoi thënjet e Tij. Konstatohet se ai që tregoi këtë është All-llahu, dhe vetëm Ai është bindësi i vetëm, i plotë.

## **MREKULLIA - VAZHDON**

Koha e revelimit të Kur'anit ishte diçka më shumë se mrekulli, sfidoi arabët në retorikën e tyre. Kur'ani shpaloi tre sekretet:

Shpaloj domethënien e kohës së kaluar, pastaj na tregoi hollësitat e historisë së pejgamberëve, na tregoi ngjarjet e disa popujve të mëparshëm dhe i sfidoi të gjithë këta.

Shpaloj domethëniet e regjionit, na transmetoi rreth mendimeve të tyre të brendshme, të pa thëna nga ata, dhe nuk qenë në gjendje ta përgënjështrojnë atë për të cilën kishin planifikuar.

Ai shpaloj edhe perdet e kohës së ardhshme të afërt, e cila do të ndodhë pas disa muajve, pas disa vitesh duke i sfiduar ata. Ai ka treguar edhe paralajmërimet e Kur'anit.

Kur'ani shpaloj edhe perdet e ardhmërisë së largët për t'ju dhënë gjeneratave të tjera mrekullitë e tija, për ta besuar atë, për ti rënë në sexhde paralajmëruesit të këtij libri, e ai është All-llahu xh.sh. Kur'ani për ne konsiderohet se ka zbritur dikur, dhe sikur ai mos t'i kishte këto mrekulli, do të dilnin nga feja edhe këta besimtarë që janë, e lere më ta pranojnë të tjerë. Për këtë arsye them se Kur'ani në kohën e revelimit të tij, ishte më shumë se mrekulli, kurse për ne është kurajues i vazhdueshëm, për të mos e humbur besimin. Kështu edhe vazhdon mrekullia. Kur'ani në

përgjithësi sjell përfundimin e teorive dhe atë në pedestalin e proceseve të universit. Besimtarët në atë kohë e kanë lexuar, por nuk kanë vërejtur se ku synonin këto ajete, dhe nuk kanë qenë në gjendje ta vërtetojnë atë shkencërisht. Por, gjeneratat e tjera duke e lexuar atë, i kanë kuptuar mrekullitë e tij. Këto gjenerata vërtetojnë këto fjalë, nuk ishte e mundur të gjitha këto parathënie të shkruheshin para mijëra vjetësh. Nuk shpjegohet ndryshe, por përveçse të thuhet se autori i Kur'anit është All-llahu xh.sh. dhe Ai është krijuesi universit.

Për atë se a paralajmëroi Kur'ani ndryshime në ligjshmëri, përgjigja është decide. Ligji i fesë, respektivisht pjesa ku thuhet, vepro ose mos vepro, ka zbritur i plotë dhe nuk plotësohet. Në të nuk ka zëvendësim e as paqartësira. Programi i All-llahut është i përkryer. Është komentuar në hadithet *Kudsije*<sup>83</sup> dhe hadithet tjera të pejgamberit.<sup>84</sup> Ky program është shpjeguar në tërësi në kohën e vet Muhammedit s.a.v.s., ashtu që u bë e qartë për të gjithë njerëzit që dëshironin ta adhuronin All-llahun dhe ata të cilët jetonin në përputhshmëri të plotë me ligjet e All-llahut xh.sh.. Vepro dhe mos vepro, janë shumë të qarta dhe ato u shpjeguan në atë kohë, gjithashtu hallalli dhe harami, u bënë të qarta sa që nuk mbeti asnjë dyshim në to. Kurse ajetet e kozmosit vërejmë se nuk janë shpjeguar plotësisht në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., ngase nuk ishte e domosdoshme. Shtrohet pyetja pse? Sepse kjo është dhuntia e risive të ardhmërisë për çdo gjeneratë. Këto janë ajetet të cilat i shpjeguam. All-llahu xh.sh.i sfidoi arabët në letërsinë e gjuhës, kërkoi nga ata që të bëjnë një Kur'an të tillë, ose së paku një kaptinë të vetmen. Jo, arabët nuk i

---

<sup>83</sup> Hadithe kudsije janë fjalë të All'llahut xh.sh.të transmetuara nga Muhammedi a.s.v.s.,ato nuk janë Kur'an e as fjalë të Pejgamberit por shpjegojnë më hollësisht fenë.

<sup>84</sup> Hadithe të pejgamberit janë të gjitha thënie, veprimet, pëlqimet dhe tradita e Muhammedit s.a.v.s.

sfidoi në gjuhë, por atyre ju kërkoi që ta mposhtin atë në dituri nëse munden. Kjo sfidë është e vlefshme absolutisht deri në përfundimin e kësaj bote. Kur’ani ju ka thënë, ju të gjithë nuk jeni në gjendje të krijoni deri në ditën e fundit asnjë gjë. Ai mos vallë kërkoi nga ata të krijojnë megagalaktika apo planete të veçanta, ose të paktën një tokë si tokën tone? Të krijojnë njeriun? Jo, nuk kërkoi asnjë nga këto, por All-llahu xh.sh. e sfidon mbarë njerëzimin të krijojnë së paku një mizë.

All-llahu i Madhërishtëm thotë:

“O ju njerëz, Po ju jap një shembull dhe dëgjojeni atë (vëmendshëm). Ata, të cilët ju i adhuroni në vend të All-llahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë edhe sikur të mblidhen që të gjithë për të. Dhe nëse miza ju rrëmben diçka ata s’mund ta shpëtojnë atë. Është dobësuar lutësi dhe i luturi”.<sup>85</sup>

Në këtë mënyrë All-llahu e sfidoi mbarë njerëzimin deri në Ditën e Kijametit që ata të krijojnë qoftë edhe një mizë. Diturinë që do ta adhuroni ju pa njohjen e All-llahut, dhe atë që do të besoni prej kësaj diturie, dhe të gjithë ata që janë mbrapa saj, nuk janë në gjendje të krijojnë një mizë edhe sikur të tubohen të gjithë. All-llahu ju tha: “...Ata, të cilët ju i adhuroni në vend të All-llahut nuk mund të krijojnë as edhe një mizë edhe sikur të mblidhen që të gjithë për të...”, pastaj ju tha: ” Është dobësuar lutësi dhe i luturi”.

---

<sup>85</sup> Kur’an, sure 22 el Haxh, ajeti 73

Pastaj shtoi edhe : “Ata s’kanë mundësitë (konceptin e vërtetë të attributeve) të All-llahut në mundësitë e vërteta të Tij...”<sup>86</sup>,

Është për tu çuditur se njeriu tani ka arritur në hënë, në mars, dhe do të zbulohen edhe planete të tjera, por, nuk është në gjendje të krijojë një mizë. Për këtë arsye, All-llahu tha: ”Është dobësuar lutësi dhe i luturi”, si edhe: “Ata s’kanë mundësitë (konceptin e vërtetë të attributeve) të All-llahut në mundësitë e vërteta të Tij...”

Nuk krahasohet mundësia e All-llahut, ajo është mbi të gjitha kufizimet dhe perceptimet tona që mund të lindin në psikikën tonë. Ju nuk jeni në gjendje asesi ta njihni atë mundësi, Ai ju sfidoi edhe me jetën tuaj në vazhdimësi. Çdo gjë që u krijua nga uji është e gjallë.

All-llahu xh.sh. thotë:

“A e shihni ujin të cilin e pini. Mos vallë, ju e zbritni atë nga retë apo Ne jemi ata që e zbresim”.<sup>87</sup>

Në një vend tjetër thotë : “ Lëshojmë shiun “

Pra, All-llahu është Ai i cili i lëshon shirat të cilat vazhdimisht i heqin etjen tërë botës. Njerëzit, shpezët, kafshët, bujqësia dhe çdo gjë që është e gjallë. Pra, është ky ujë i cili vazhdimisht i mungon njeriut dhe gjallesave tjera. Njeriu edhe pse e di fare mirë prej cilave elemente është përbërja e ujit, ai është i pa aftë të bëjë një lumë. Tani kemi një numër shumë të madh dijetarësh

---

<sup>86</sup> Kur’an, sure 22 el Haxh, ajeti 74

<sup>87</sup> Kur’an, sure 56 el Vakia, ajeti 69,70

të cilët shohin se bota ka disa shkretëtira të cilat janë të etura për pika uji. All-llahu e sfidoi njerëzimin që të shpëtojë nga vdekja.

All-llahu thotë:

“ Kudo që të jeni do t’ju gjejë vdekja, edhe sikur të jeni edhe në kështjella të fortifikuara”<sup>88</sup>

Këtu kemi një sfidë nga All-llahu. Sadoqë të përparojë shkenca, ajo nuk mund të na shpëtojë nga vdekja. Shumë nga fiziologët thonë se shkaktari kryesor i vdekjes janë bakteriet, sëmundjet etj. Mirë, ne atyre mund t’ju themi: ndërtoni pra një kështjellë të fortifikuar mirë dhe vendosni një njeri aty, pastaj largojani të gjitha rreziqet të cilat mund t’a shpiejnë deri te vdekja. Njeriu i vendosur aty të mos të luftojë, të mos shkojë në vende ku mund t’i ligësohet shëndeti. Të mos thithë ajër të ndytë, ushqimi të jetë shumë i pastër, të pijë ujë në të cilin nuk ka as edhe një bakterie të vetme, t’i mundësohet një klimë shumë e pastër. Me fjalë tjera, t’ja mundësojmë që të jetë sa më larg atyre shkaqeve të parapara, të cilat e shkaktojnë vdekjen. Pas të gjitha këtyre që thamë, a mund të garantojë njeriu pavdekshmërinë?! Përgjigja me siguri do t’ishte negative. I vetmi që jep jetë dhe merr jetë, është All-llahu. Shkaqet këtu nuk veprojnë, por, është dëshira e All-llahut ajo që vepron.

All-llahu sfidoi njerëzimin në Kur’an me pesë sekrete.

---

<sup>88</sup> Kur’an, sure 4 el Nisa, ajeti 78

“Vërtetë, vetëm tek All-llahu është dija e Kijametit, dhe Ai lëshon shiun, dhe Ai e di çka ka në mitër, dhe asnjë njeri nuk e di se çka do të fitojë (bëjë) nesër, dhe askush nuk e di se në cilin vend do të vdesë...”<sup>89</sup>

All-llahu xh.sh. sfidoi në këto sekrete. E sfidoi mbarë njerëzimin, ashtu si i sfidoi arabët në letërsi, i sfidoi njerëzit mbarë në shumë gjëra. Ai ju tha: nuk mund të arrini këtu dhe nuk mund ta bëni këtë, nuk mund të veproni këtë dhe nuk mund të krijoni këtë. Këto janë sfida të All-llahut për mbarë njerëzimin dhe për secilën gjeneratë, pra, janë të vlefshme edhe për ditët tona dhe ditët që pasojnë. Përderisa ende vazhdon dhe përderisa jemi të bindur se jemi të pa aftë para mundësisë së All-llahut xh.sh., pse atëherë të mos përfillen dy fjalët:

“Subhane All-llah, (i Lartësuar është All-llahu). Askush nuk i gjason Atij”. Kjo është edhe tema e pjesës tjetër.

## **SUBHANE ALL-LLAH**

Marrëdhëniet e njeriut me Zotin janë të shumënumërta. Ato ndryshojnë në vetë natyrën e lidhshmërisë, ngase ka gjëra që janë sekrete për të. Njeriu kur është zgjuar p.sh. në jetën e tij të përditshme sheh aq sa ia jep ajo kohë të shohë gjëra të përditshmërisë, ose aq sa ia mundësojnë kornizat materialiste kundrejt gjërave që nuk i njeh fare. Njeriu duke qenë zgjuar, i nënshtrohet

---

<sup>89</sup> Kur'an, sure 31 Lukman, ajeti 34

plotësisht mendjes. Kur është në gjumë atij i ndryshon situata. Duke qenë në gjumë, ai mund të shohë gjëra të cilat nuk i ka parë duke qenë zgjuar. Shikon gjëra që nuk merren me mend. Ndosht të shikojë veten duke fluturuar, ose nëpër vende të cilat nuk i ka parë kurrë në jetën e tij të përditshme. Mund të shikojë veten duke biseduar me njerëz të ndryshëm, të cilët kanë ndëruar jetë më herët, të flasë me ta për ndonjë problem shkencor, ose shikon gjëra të çuditshme të cilat mendja nuk i pranon në logjikën e tij, ose nuk janë të zanatit të tij. Por, fakti që të habit, është se ajo ëndërr edhe mund të përfundojë e përmbyllur. Nuk është syri ai që shikon, por këtë e bën shpirti.

Shpirti ka shqisë të veçantë të të pamurit. Ai mund t'i shikojë ata që janë ndarë nga kjo botë, të bisedojë me ata. Njeriu duke qenë në gjumë, është në një botë tjetër që nuk i përket botës së cilës e jeton duke qenë i zgjuar. Shpirti i tij takohet me nënën, babain ose të tjerë të cilët janë ndarë prej vitesh. Pra, ai sheh njerëz dhe gjëra të cilat nuk i ka njohur me logjikën e kësaj bote.

Shtrohet pyetja: kush e tërheq atë të shohë gjëra, kur ai është sy mbyllur, gjëra të cilat nuk i sheh duke qenë zgjuar, dhe kush e bën ate të shohë gjëra të cilat asnjëherë në jetë nuk i ka parë, e në momentin kur të zgjohet t'i humbasin të gjitha ato? Si ta shpjegojmë këtë dukuri!? Themi, këtu jemi në një gjendje në të cilin mendja ndalet, sepse ato ndryshojnë nga logjika, jemi të pa përgjigje, prandaj këto i fusim në adresën “*Subhane All-llab – Çoftë i lartësuar All-llahu, Atij nuk i gjason askush*”. Ne nuk i njohim ligjet dhe rregullat e shpirtit pa prezencën e trupit, po ne gjithashtu nuk i njohim rregullat e shpirtit pasi të ndahemi (vdesim). Këto të gjitha për ne janë sekrete, mendja është e cektë për këto. Për këtë arsye këto i adresojmë në “*Subhane All-llab, Atij nuk i gjason askush*”.

Ta shpjegojmë këtë term. Nëse them se filani e grushtoi filanin, me tërë fuqinë që e kishte, a ndjej unë gjë? Përgjigja do të ishte, jo. Nuk do të më interesonte aq shumë ajo, dhe unë nuk do ta ndjeja dhembjen. Do të më interesonte nëse kjo do të ndodhë tek unë, atëherë do ta ndjeja dhembjen dhe forcën e tij, nëse ishte i fortë ose jo. Nëse them se një foshnje më grushtoi me gjithë forcën që kishte, nuk do të ishte interesante, krahasuar me një boksier botëror, i cili do të më grushtonte me gjithë forcën. Këtu ka dallim të dukshëm. I pari më qëllloi dhe nuk ndjeja grushtimin e tij, kurse i dyti për pak më mbyti. Shikuar për nga veprimi, që të dy e përdorën gjithë forcën që kishin për të më grushtuar. Pra, vepra këtu bazohet në vepruesin. Grushtin e foshnjës as që e ndieva kurse boksieri mundej edhe të mi thyente brinjë.

## **UNË KAM FUQI POR EDHE AI KA FUQI**

Nëse e marrim këtë shembull të All-llahut xh.sh. e fusim në përmbajtjen e fjalës “*Subhane All-llab*” *Atij nuk i ngjason askush, me këtë shembull do të mundohemi ta afrojmë kuptimin e atyre të cilët shfrytëzojnë nga rasti për ta ngatëruar njerëzimin. All-llahu xh.sh. është fuqi, por edhe unë kam fuqi. Por, a është fuqia ime si ajo e All-llahut xh.sh. All-llahu xh.sh. është i ditur, edhe unë jam i ditur. Por, a mund të krahasohet dituria ime me atë të All-llahut xh.sh. All-llahu jeton por edhe ti ke cilësinë e të jetuarit, por asnjëherë mos thuaj se jeta ime është si e All-llahut xh.sh. Ekzistenca e All-llahut nuk është si ekzistenca jote. Dituria e Tij nuk është si dituria jote. Mundësia e Tij nuk*

është si mundësia jote. Këtu fillon edhe forma e krahasimit edhe pse në realitet nuk duhet të ketë kurrfarë krahasimi. All-llahu me mundësitë, forcën, etj cilësohet me *“Subhane All-llab, Atij nuk i ngjason askush”*. Kështu që unë nuk duhet t’ia mvësh vetes sime dhe të kuptuarit njerëzor, ato që i thotë All-llahu xh.sh. për veten e Vet. Kur ta parafytyroj forcën e All-llahut, nuk duhet ta krahasoj me forcën time. Por unë them *“Subhane All-llab. Atij nuk i gjason askush”*. Kur parafytyroj hakmarrjen e All-llahut, unë Atë nuk e krahasoj me format e hakmarrjeve të mia. Por unë e fus në shprehjen *“Subhane All-llab, Atij nuk i ngjason askush”*.

Brenda kësaj shprehje *“Subhane All-llab, Atij nuk i ngjason askush”* do të gjejmë dhe do të mundemi të arrijmë në gjurmët e shumë gjërave. Ti nuk mund të paramendosh se çka mund të shohësh kur të lajmëron All-llahu për gjërat të cilat ti nuk i shikon. Atëherë kur të lajmëron All-llahu për ato gjësende të cilat nuk i shikon, do t’i fusësh ato në shprehjen *“Subhane All-llab, Atij nuk i ngjason askush”*. Për arsye se je magjepsur ndërmjet shikimit tënd dhe shikimit të All-llahut xh.sh. All-llahu thotë: I Lartësuar është Ai i Cili e çoi (*sbetiti*) robin e tij...<sup>90</sup> Kush e kaloi atë? All-llahu xh.sh. e çoi atë në xhaminë e Aksasë<sup>91</sup>. Nuk mund të them se kjo situatë shpjegohet me rregullat tona të kohës dhe vendit, të cilat ne i njohim dhe të cilat jemi mësuar t’i shohim ose t’i paramendojmë. Ato nuk krahasohen sepse All-llahut nuk i ngjason askush sepse këto rregulla nuk i përkasin veprës së njeriut. Rregulla tona nuk kanë të bëjnë me All-llahun xh.sh. Këto rregulla vlejné për ne kurse për All-llahun janë të pa vlerë. Vendi dhe koha që të dyja nuk ekzistojné për All-llahun xh.sh.. Ai nuk është si ne. Ai i cili udhëtoi me Muhammedin s.a.v.s. në këtë rast është All-llahu i

---

<sup>90</sup> Kur’an, sure 17 el Isra, ajeti 1

<sup>91</sup> Kjo xhami gjendet në Jerusalem, është xhamia ose faltorja e dytë në ruzullin toksorë.

Lartësuar. Kështu që, disa nga shokët e Muhammedit pyetnin se si mundet të shkojë Muhammedi në xhaminë e Aksasë dhe të ngjitet në qiell e pastaj të kthehet mbrenda natës? Ju themi se Muhammedi s.a.v.s nuk tha kështu por ai udhëtoi me Të, pra me All-llahun xh.sh. All-llahu nuk është si ne, e as nuk është si ndonjë krijesë tjetër. Ai është i Vetëm dhe i pashoq. Të gjitha regullat dhe ligjet tona që i njohim ne, nuk vlejné dhe nuk përputhen me All-llahun. Nuk krahasohet koha, vendi, dhe mundësia jonë, me të Tijën. Këtu kemi të bëjmë me veprën e All-llahut, e Ai nuk është i krahasueshëm me askend. Edhe pse kemi nevojë t'i përngajmë, dhe të orvatemi t'i shpjegojmë disi veprimet e Tij, ne e bëjmë këtë duke patur parasysh se Ai nuk përngjan me askend. Kur themi “*Subhane All-llab*”, ne e lartësojmë Atë në superlativ, duke e dalluar nga të gjitha ngjasimet e mundshme. Pra, gjithmonë kur ne shqiptojmë shprehjen “*Subhane All-llab*”, duhet ta marrim se ajo është vetëm vepër e Tij. Mënyra se si mundi Ai ta bëjë, askush nuk është në gjendje të arrijë ta shpjegojë, sepse Ai është i Vetëm dhe nuk është i krahasueshëm me askend.

## MUNDËSIA DHE DITURIA

Kur All-llahu flet për mrekullinë, për mrekullitë me të cilat i përkrahë peygamberët, ose për botën e melaqeve dhe xhindëve të cilat nuk i shohim, ne e dimë se ato janë realitete, ngase All-llahu ka mundësi ta bëjë këtë. Mundësia e Tij nuk krahasohet me asgjë në botë. Bota dhe dituria njerëzore, nuk është as sa një grimcë atomi në krahasim me diturinë e Tij. Ai mund të krijojë gjëra që i shohim dhe të cilat sot nuk mund t'i shohim, por që do t'i shohim në një të ardhme.

Ashtu siç kemi theksuar më herët, All-llahu është i butë me robërit e tij. Ai na dha shenja të cilat e afrojnë mendjen e njeriut për ato gjëra që nuk i njeh kjo mendje. Bën që ato t'i afrohen shumë afër parafytyrimit të tij. Kështuqë Ai bëri që të hyjë qetë në zemrat tona dhe të na japë imanin dhe të jemi në gjendje t'ju përgjigjemi të humburve. Bile edhe t'i kundërshtojmë këta të humbur. Besimtari gjithmonë është i butë, dhe zemra e tij është plot shpresë, sepse ai beson në mundësitë e All-llahut që janë të pa kufi. Ai beson se All-llahu e ka caktuar fitoren për besimtarët ashtu si e ka caktuar edhe shpëtimin për ta. Ai beson se All-llahu i ndihmon besimtarët. Kjo është një fuqi e hatashme, është në gjendje të të mbrojë, qoftë edhe sikur tërë bota të jetë kundëra teje.

Kemi njerëz të cilët mundohen të tregojnë diçka dhe polemizojnë rreth shpirtit. Dikush edhe kundërshton rreptë duke thënë se unë nuk i besoj ato gjëra që nuk i shoh. Ai vazhdon të polemizojë në këtë mënyrë derisa kur i thuhet nëse është ai vetë dëshmitar i krijimit, ose a je dëshmitarë i melaqeve dhe xhineve, ai do të përgjigjet: as t'i nuk je dëshmitar. Këtu do të përgjigjemi: All-llahu na ka dhënë mjaft argumente në këtë botë mbi mundësitë e mendjes sonë, mbi mundësitë e të pamurit, mbi mundësitë e të dëgjuarit tonë, që nga krijimi i kësaj toke, si dhe çka ka në të. Ai nxori nga dituria e Vet e përkryer, dhe i dha diturisë të pa përkryer të njeriut. Të gjithë këtë e bëri për t'i treguar njeriut se ka gjëra të cilat janë mbi mundësitë e të menduarit të tij, mbi mundësitë e pamurit dhe të dëgjuarit.

Le të diskutojmë për këto tre tema tani. Ajo që është mbi mundësitë e mendjes ekziston që nga ezeli<sup>92</sup>, kjo i është mundësuar mendjes sonë, brenda këtyre viteve të fundit. Psh fluturimi i njeriut me aeroplan. Kjo ishte mbi mundësitë e mendjes së njeriut në të kaluarën. Sikur dikush t'i thoshte

---

<sup>92</sup> Ezel, fjalë e cila nënkupton diturinë e përjetësisë, të infinitit.

në atë kohë njerëzimit, se ka fluturuar me aeroplan nëpër qiell të hapur, me siguri do ta llogarsinin për të çmendur, ose se është qafir, ose edhe do ta mbytnin. Para njëqind vjetësh, po t'ju thojë njerëzve se ke biseduar me miliona njerëz në të njejtën kohë, nuk do të besonte askush, sepse kjo ishte mbi mundësitë e njeriut. Mirëpo, sot mund të shkosh në aeroport, të fluturosh me aeroplan ku të duash, të flasësh në TV dhe të të dëgjojë e tërë bota. Si ndodhi kjo? A mos vallë njeriu zbuloi një mbështjellës atmosferik të ri të tokës dhe iu mundësua fluturimi. A mos vallë ai fluturoi rreth botës dhe vëndosi valët fluturuese. Kuptohet se nuk ndodhi as njëra e as tjetra, por, ky mbështjellës ishte që kur e krijoi All-llahu xh.sh. këtë planet dhe ç'ka ka në te. Kur ta parafytyroj forcën e All-llahut, nuk duhet ta krahasoj me forcën time.

Këto valë janë që prej krijimit të kozmosit, por, ajo që ndodhi është se All-llahu xh.sh. mundësoi që gjërat të kalojnë nga irealja e dikurshme e trurit i njeriut, në reale pra, në mendje të njeriut. Bile, thënë më saktë, këto njohuri dolën nga dituria e pakufizuar në diturinë e kufizuar, me thënien bëhu. Pastaj u bë e mundur që, njeriu të fluturojë në hapsirë, ta dëgjojë e tërë bota kur flet, si dhe të tjera që do t'i realizojë njeriu me mundësitë e All-llahut. Ky është një argument i cili vërteton mundësinë mbi njerëzore që është prezent dhe ekziston. Mendja e njeriut nuk është kufiri më i lartë i diturisë dhe njohjes në këtë planet. Sado të përparojmë gjatë kohës All-llahu do të na japë dituri, të cilat janë mbi njerëzore e do t'i vëndosë në mendjen njerëzore, derisa të mundohet njeriu të arrijë tek Ai, dhe derisa të besojë se ajo që është mbi mundësinë e njeriut ekziston. Çdo gjë është relative dhe ekziston, edhe pse është e panjohur për ne.

## **MBI SHQISAT E NDËGJIMIT DHE TË PAMURIT**

Kjo ishte sa i përket mendjes. Kurse ajo që konsiderohet mbi mundësinë e dëgjimit është ajo që dëshmohet çdo ditë. Nëse në një dhomë je i vetmuar dhe mbretëron qetësi absolute, mund të shtrosh pyetjen se a ka ndonjë zë në këtë dhomë? Do të më thuash unë nuk dëgjoj asgjë. Përderisa thua nuk dëgjoj asgjë, nënkuptohet se në dhomë nuk ka zë. Nëse e hap radion do të dëgjosh zëra nga qindra kanale nga mbarë bota. Nga erdhën të gjitha këto zëra? Këto zëra notojnë nëpër ajrin e dhomës, por, thjesht nuk je në gjendje t'i dëgjosh me veshët e tu. Ato janë mbi mundësinë e veshit. Nëse sjellim një aparat, do t'i mundësojë veshit t'i dëgjojë këto zëra. Pra, është e mundur që ato të dëgjoen dhe dallohen. Këto zëra ekzistojnë, por nuk ishe në gjendje t'i dëgjosh pa aparat. Mbase edhe mund të zbulohen gjëra të tjera më të sofistikuar që ekzistojnë në dijen e All-llahut. Ato ende nuk kanë arritur në mendjen e njeriut, që t'i mundësojnë të dëgjojë ato që nuk e dëgjon sot, dhe që nuk di asgjë për to. Bile, këtë dua t'a ilustroj edhe me një shembull. Nëse marr një radioaparat të vogël dhe vendosi kufjet e vogla në veshë, kurse pranë meje është një person tjetër të cilin e pyes nëse dëgjon diçka? Do të përgjigjet, jo, nuk dëgjoj, edhe pse është afër meje dhe unë me anë të kufjeve në vesh e dëgjoj botën, kurse ai nuk është në gjendje të dëgjojë asgjë. Çfarë kuptojmë nga kjo? Kjo na jep të kuptojmë se aparatura që përdoret, absorvon zërat të cilat notojnë në dhomë dhe i mbledh në një vend, por, megjithatë kjo është mbi mundësinë e dëgjimit. A do të thotë kjo se zërat të cilat i dëgjoj në radio, janë inekzistuese për arsye se ti vetë nuk i dëgjon. Jo kurrsesi, kjo jep të kuptohet se zërat të cilat i dëgjoj unë janë mbi mundësinë e veshit tënd por ato ekzistojnë.

Kështu arritëm të kuptojmë se kemi gjëra të cilat janë mbi mundësitë e mendjes dhe ekzistojnë si dhe ato që janë mbi mundësinë e të dëgjuarit.

## **MBI MUNDËSINË E TË PAMURIT**

Ti do të thuash se nuk i njoh ato gjëra për të cilat flet All-llahu, të cilat janë inekzistente. Unë të sjell ty një pikë ujë nga kënetat, dhe të pyes. A sheh gjë në këtë pikë uji? Do të më thuash: jo. Tani kur ta vemë atë pikë uji në mikroskop, do të shohim se aty jetojnë qindra mikrobe të gjalla të cilat lëvizin në mënyrë të çuditshme. Pastaj të them, shiko!?! Atëherë do të shohësh mikrobet. Ashtu si dhe njeriut të sëmurë kur ja merr një pikë gjaku, aty për aty nuk sheh gjë, por, kur atë e futë në mikroskop ose në një lëng të epruvetave, atëherë do të shohim mikrobe dhe, gjëra të çuditshme. Vallë, ku ishin të gjitha këto që nuk kishe mundësi t'i shohim me anë të syrit. Kur prodhove një aparat zmadhimi, fillove të shikosh gjëra të cilat ishin mbi mundësinë tënde të shikimit. A do të thotë kjo, se për shkak të pamundësisë së pamjes të gjërave, të thuash se ato nuk ekzistojnë. Ose të thuhet, se këto mikrobe nuk kanë ekzistuar para se të zbulohet mikroskopi. Ato gjithsesi kanë ekzistuar, por ato ishin atëherë mbi mundësinë e shikimit për ne. Kështu që u desh të zbulohet një mikroskop që të na mundësojë ta bëjmë të mundur atë që ishte mbi mundësinë tone. Por ato gjithsesi ekzistonin edhe pse ne nuk i shihnim.

Sikur të jesh në një dhomë ku është televizori, edhe pse në mure nuk ka fotografi, kur e ndez televizorin, dhoma bëhet me fotografi. Bile, ndodh ta shikosh para teje njeriun që ec në satelitin natyror të hënës. A mundet syri i rëndomtë të shohë njeriun duke ecur në hënë. Përgjigja do të ishte po, nëse i përdor mundësitë e All-llahut në univers. Shkenca po i përdor mundësitë e All-llahut në gjithësi të cilët po transmetojnë fotografi nga një vend në një vend tjetër. Nuk krijoi shkenca shtresa të atmosferës për të tranmetuar fotografitë. Ato nuk mund t'i krijojë kurrë, por, ato i zbulojmë me fjalën bëhu. All-llahu është i Gjithfuqishëm, sepse e gjithë kjo ishte në diturinë e Tij, dhe këto vetëm sa i nxorri për diturinë e kufizuar, për njeriun. Pse u bë e gjithë kjo? Me siguri për t'u njohur me diturinë bindëse dhe të vërtetohet, se edhe ajo që s'është në logjikën e tij ekziston, dhe ajo që është mbi mundësinë e të pamurit të tij ekziston. Që kur All-llahu xh.sh. tregon sekretet, ajo është mbi mundësinë e logjikës, ndëgjimit dhe të pamurit, të jetë i bindur, se ajo ekziston dhe atë që e thotë All-llahu, është realitet dhe e vërtetë. Pra, ajo që është mbi mundësinë e njeriut po ekzistoka me një diferencë shumë të madhe. Ky është një dallim mes të krijuarit dhe krijuesit. Dëshira e All-llahut ishte që kjo çështje t'i përket imanit. Ç'ështëjet si ato sekretet, janë tema për të humburit, të cilët orvaten t'i humbin të tjerët derisa të largohen nga rruga e All-llahut. Bëri që logjika njerzore të transferohet nga mundësia e All-llahut prej gjenerate në gjenerate, ajo që ishte e pamundur logjikisht, të bëhet e mundur, për t'i bindur se ajo që është mbi logjikën ekziston. Bëri që veshi, me mundësitë e All-llahut, të transmetojë ato që ishin mbi mundësinë e tij të thjeshta. Bëri që syri të mund të shohë ato çka nuk kishte ëndërruar t'i shihte më parë. Ishte me mundësitë e All-llahut, t'ia jep njeriut të gjitha këto dituri që në momentin e krijimit, por ja që, atë nuk e dëshiroi. All-llahu xh.sh. çdo gjë që i jepte njeriut ia jepte për ta vërtetuar njeriu forcën e All-llahut, për t'u bindur se në gjithësi ka sekrete, si dhe ka diçka që është mbi mundësinë njerzore.

## DITURIA NJERËZORE

Dituria njerëzore sfidohet me dy gjëra:

Dituria materialiste e cila i nënshtrohet plotësisht eksperimenteve. Këtu nuk futet dhuntia e njeriut. Kjo është një shkencë e cila mbështetet vetëm në materie. Kjo dituri mund të kontrollohet me analiza dhe bazohet në eksperimente, dhe në të nuk ka dhunti të njeriut. Edhe kjo është një dije të cilën ia shpalli All-llahu logjikës njerzore. Dhe kërkoi nga ai që të mundohet në të. All-llahu ju premtoi atyre të cilët hulumtojnë dhe bëjnë eksperimente, se do tu mundësojë zbulimin e ajeteve<sup>93</sup> të All-llahut.

Dituria tjetër, është ajo dituri që futen idetë. E kundërta e të parës, këtu nuk ka laboratorë. Këtu nuk mund të kemi eksperimente. Kjo dituri bazohet në teoritë filozofike dhe politike. Çdo gjë nuk mund të hyj në laboratorë. Në këtë dituri hyjnë mendime të ndryshme, dhe ka gërshetime, dhe këto gërshetime do të vazhdojnë deri në ditën e kataklizmës, ngase kjo dituri nuk bazohet në materializëm të plotë por në të, futen idetë njerëzore.

Të parët vazhdojnë të arrijnë qëllimet e tyre. Nëse arrijnë në një qëllim të caktuar, prej këtyre ka dobi mbarë njerëzimi. Dijetari i cili vazhdon të veprojë në laboratorin e tij, për të zbuluar ndonjë risi, ai punon ditë e natë derisa të arrijë në atë zbulim. Kur ai zbulon, ka dobi mbarë njerëzimi. P.sh. Zbulimi i elektricitetit, zbulimi i radios, i televizionit, telefonit e të tjera. Këto janë vepra të

---

<sup>93</sup> Ajete, shenja, vargje ose fjalitw e All'llahut tw shkruara nw Kur'an.

cilat janë hulumtuar dhe studijuar nga shumë njerëz, dhe kur ata arritën në rezultate, përfitoi mbarë njerëzimi.

Të dytët janë ata të cilët mbështeten në ide. Këtu përfiton vetëm ai i cili merret me to, kurse të tjerët e ndiejnë atë. Ai e fut shkencën sipas idesë së tij, dhe e bazon në, atë të cilën e parapëlqen vetë. Pra, ideologët e teorive filozofike ose politike nuk ndiejnë ashtu siç e ndien nënshtruesi, pasuesi ose zbatuesi i atyre ideve.

## ÇKA NA OFROI SHKENCA

Çka i ofroi shkenca njerëzimit. Të debatojmë rreth këtij realiteti të eksperimenteve shkencore. Parimet bazë të jetesës njerëzore nuk ndryshojnë. Ato nuk zëvendësohen por, ato mbeten ashtu siç i krijoi All-llahu. Shkenca nuk mund të ndërhyjë dhe të zëvendësojë gjë në këto. Atë që mund ta bëjë shkenca, është të ngrejë standartin jetësor të njerëzimit, të ndikojë në lehtësimin dhe zbutjen e jetesës. Ajo nuk na jep bazën jetike të njeriut. Duke qenë në dijen e All-llahut, se njeriu terorizon njeriun, ai këtë mundësi nuk ia dha njeriut, atë e mbajti për Vete. Njeriut i dha mundësi aq, sa të mos jetë në gjendje të shkatërojë atë duke i përdorur proceset natyrore të jetesës.

Ta spjegojmë këtë pikë edhe më. Elementet kryesore të jetesës janë: planeti i tokës dhe yjet. Në sistemin kozmik, njeriu nuk mund të ndërhyjë. Me diturinë që ka njeriu nuk mund të ndërtojë një planet tjetër, një diell, një yll, një qiell etj. Këto janë kreaturë e All-llahut. Shkenca nëse arrinë të zbulojë ajetet (krijesat) në të, do të konsiderojë për të arritura drastike. Por shkenca, nuk mund të

krijojë asgjë, ose të zëvendësojë në të. Ne tani jemi në kohën e shkencës, dhe kjo është një realitet shumë i rëndësishëm dhe askush nuk e mohon këtë.

Tani të shohim elementet bazë të jetës në tokë. Qielli, uji, ushqimi. Tre elementet kryesore të jetës së njeriut në tokë. Nga natyra e tij, njeriu nuk mund të jetojë pa ajër më tepër se pak minuta. Kjo është një nga ato gjëra që All-llahu nuk ia dha njeriut të zotërojë dhe të ketë kompetenca në të. Dëshira e All-llahut ishte që ajri të jetë në liri të plotë për njerëzimin. Askush nuk mundet t'ia ndalojë një grup njerëzish këtë liri.

## AJRI

Ajri është i nënshtuar drejtësisë së All-llahu xh.sh. Ajri mbetet i barabartë për të gjithë. Si për të pasurit ashtu edhe për të varfërit. Si për të bukurit, ashtu edhe për të shëmtuarit. Këtu nuk sundon askush në botë. Që të gjithë marrin frymë, dhe atë lirshëm, dhe në të njejtën mënyrë. Ju arrin ajri me lehtësi, kudo që të ndodhen, në dhoma të mbyllura, në rrugë, në veturë, ose në çfarëdo vendi të botës, i lejuar për të gjithë njësoj. Kjo është drejtësia e All-llahut të Lartësuar dhe këtu nuk ka ndërhyrje të njeriut në të.

## UJI

Edhe uji është një faktor jetik i përditshëm për njeriun. Njeriu nuk mund të jetojë pa të, përveç disa ditë. Shohim se mundësitë për deponimin e ujit janë të vogla. Mundësitë për ta ndaluar ujin gjithashtu janë të pakta dhe të kufizuara, edhe pse aty është mundësia. Këtu mund të hyn terrorizmi njerëzor, por me një përkufizim të vogël duke e marrë parasysh rëndësinë e ujit për jetesën e njeriut.

## USHQIMI

Dihet se mundësia për deponimin dhe ndalimin e ushqimit është më e madhe. Por, mundësia e arritjes së ushqimit është më e vogël. Njeriu mund të jetojë vetëm disa ditë pa ushqim, por në të njëjtën kohë ai mund të gjejë atë aq sa ta mbajë shpirtin. Kështu që mbetet së jetuari me lehtësi. Përqindja e ushqimit të kërkuar për mbajtjen e shpirtit është e vogël, ashtu siç thotë Muhammedi s.a.v.s. me disa kafshata mbahet shpirti, ose me një sasi të kufizuar të ushqimit. Sado që t'i shtohet oreksi njeriut për ushqim, aq më tepër prish trupin dhe bëhet shëndetlig.

Këto ishin tre elementet e jetesës së njeriut. Gjëja pa të cilin nuk mund të jetojë njeriu është ajri, për këtë është mbikqyrës i drejtë All-llahu. Ai bëri që ajri të arrijë tek njerëzimi pa ndonjë enë ose aparaturë. Elementi tjetër jetik për njeriun ishte edhe uji, pa të njeriu nuk mund të jetojë, përveç disa ditë. Uji është i bollshëm për njerëzimin. E treta ishte ushqimi në të cilin njeriu ka një

zotërim më të madh, por mundësitë e njeriut të jetojë pa të janë më të mëdha. Këtu shihet drejtësia qiellore në shpërndarjen e elementeve bazë të jetesës.

El Hamdulil'lah

Lus All-llahun të jetë i kënaqur me drejtimin tonë dhe kërkoj udhëzim për rrugën e vërtetë.

Së shpejti pranë duarve tuaja  
edhe libri i dytë nga gjithsej nëntë libra  
për ta përbyllur këtë libër të mrekullueshëm